



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 23 korrik 2024
Nr. ref.: AGJ 2486/24

AKTGJYKIM

në

rastet nr. KO232/23 dhe KO233/23

Parashtrues të kërkesës

KO232/23, Abelard Tahiri dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
KO233/23, Besian Mustafa dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 08/L-180 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesave

1. Kërkesa KO232/23 është dorëzuar nga Abelard Tahiri, Memli Krasniqi, Isak Shabani, Eliza Hoxha, Xhavit Haliti, Ferat Shala, Rashit Qalaj, Ariana Shoshi, Ganimete Musliu, Mërgim Lushtaku dhe Hisen Berisha, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), të grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: PDK), të cilët i përfaqëson Faton Fetahu.

2. Kërkesa KO233/23 është dorëzuar nga Besian Mustafa, Agim Veliu, Avdullah Hoti, Driton Selmanaj, Armend Zemaj, Rrezarta Krasniqi, Arben Gashi, Vlora Dumoshi, Valentina Bunjaku, Anton Quni dhe Kujtim Shala, deputetë të Kuvendit, të grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: LDK), të cilët i përfaqëson Arben Gashi (në tekstin mëtejme të referuar bashkërisht si: parashtruesit e kërkesave).

Ligji i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës KO232/23 kontestojnë: i) kushtetutshmërinë e procedurës së ndjekur për miratimin e Ligjit Nr. 08/L-180 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar); si dhe ii) kushtetutshmërinë e përmbajtjes së Ligjit të kontestuar në tërësi.
4. Ndërsa, parashtruesit e kërkesës KO233/23 kontestojnë kushtetutshmërinë e neneve 2, 3, 6, 7, 8, 9 dhe 10 të Ligjit të kontestuar.

Objekti i çështjes

5. Objekt i çështjes së kërkesës KO232/23 është (i) vlerësimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar, për të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se është nxjerrë në kundërshtim me nenin 77 (Shqyrtimi i projektligjit të qeverisë, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit) të Rregullores së Kuvendit; si dhe (ii) vlerësimi i kushtetutshmërisë së përmbajtjes së Ligjit të kontestuar, për të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nuk është në përputhshmëri me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 101 [Shërbimi Civil] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura], të Kushtetutës. Objekt i çështjes së kërkesës KO233/23 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së dispozitave të saktësuara më lart të Ligjit të kontestuar, për të cilat parashtruesit e kërkesave pretendojnë se nuk janë në përputhshmëri me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] dhe 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.
6. Përveç kësaj, (i) parashtruesit e kërkesës KO232/23 kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që Ligji i kontestuar të pezullohet *ex-lege* dhe të mos dërgohet për zbatim deri në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar; ndërsa (ii) parashtruesit e kërkesës KO233/23 kërkojnë vendosjen e masës së përkohshme në lidhje me kërkesën e tyre pasi që do të mbrohej interesi publik, duke theksuar, mes të tjerave, se “*mosvënia e masës së përkohshme do të kishte pasoja të pariparueshme për të gjithë nëpunësit civil të Kosovës [...]*”.

Baza juridike

7. Kërkesat bazohen në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afatet) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullat 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 72 [Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe neneve 42 dhe 43 të Ligjit] të Rregullores së punës së Gjykatës, Nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

8. Më 20 tetor 2023, parashtruesit e kërkesave i dorëzuan kërkesat në Gjykatë.
9. Më 30 tetor 2023, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [Nr. GJR. KSH. KO232/23], për rastin KO232/23, caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga: Remzije Istrefi-Peci (kryesuese), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë). Po të njëjtën ditë, Kryetarja, në pajtim me paragrafin 1 të rregullit 32 [Bashkimi dhe ndarja e kërkesave] të Rregullores së punës, përmes Urdhrit [KO232/23 dhe KO233/23], urdhëroi bashkimin e kërkesës KO233/23 me kërkesën KO232/23. Bazuar në paragrafin 2 të rregullit të lartcekur, për kërkesat e bashkuara, gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues mbetet në përbërje të njëjtë, siç është përcaktuar për kërkesën e parë, përkatësisht atë KO232/23.
10. Më 31 tetor 2023, Gjykata njoftoi për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave KO232/23 dhe KO233/23: (i) Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidentja); (ii) Kryetarin e Kuvendit, të cilit iu kërkua që të njoftojë deputetët e Kuvendit lidhur me kërkesën; dhe (iii) Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit. Këtyre të fundit iu kërkua që të marrin parasysh kërkesat e paragrafit 2 të nenit 43 të Ligjit, që përcaktojnë: *“Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendimi i tillë mund t’i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”*. Presidentja dhe Kryetari i Kuvendit po ashtu u njoftuan se mund të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesën e parashtruesve, nëse kanë, deri më 15 nëntor 2023; ndërsa Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit iu kërkua që deri më 15 nëntor 2023 të dorëzojë të gjitha dokumentet relevante në lidhje me objektin e kërkesës. Po ashtu, në të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave edhe: (i) parashtruesit e kërkesës; (ii) Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri); (iii) Institucionin e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Avokati i Popullit); dhe (iv) Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMSHCK), të cilëve iu kërkua që të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesën e parashtruesit, nëse kanë, deri më 15 nëntor 2023. Të njëjtën ditë Gjykata, lidhur me kërkesën KO232/23, kërkoi nga deputeti Arben Gashi, që në përputhje me paragrafin 4 të nenit 72 të Rregullores së Punës, të dorëzojë në Gjykatë autorizimin për përfaqësim të nënshkruar nga të gjithë deputetët parashtrues të kërkesës.
11. Më 2 nëntor 2023, deputeti Arben Gashi dorëzoi në Gjykatë autorizimin për përfaqësim.
12. Më 8 nëntor 2023, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dorëzoi në Gjykatë dokumentet relevante lidhur me rastin, si në vijim:
 - i) Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit bazik për KPMSHCK), të 3 tetorit 2022;
 - ii) Raportin e Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal për shqyrtimin në parim të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit bazik për KPMSHCK, të 18 tetorit 2022;
 - iii) Procesverbalin nga mbledhja e Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal për shqyrtimin në parim të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit bazik për KPMSHCK, të 17 tetorit 2022;

- iv) Vendimin [Nr. 08-V-485] të Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin në parim të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit bazik për KPMSHCK, të 23 shkurtit 2023;
- v) Procesverbalet e seancave plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me 10 nëntor 2022 dhe me 23 shkurt 2023;
- vi) Pjesë nga transkriptet e seancave plenare për shqyrtimin e parë të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit bazik për KPMSHCK, të 10 nëntorit 2022 dhe 23 shkurtit 2023;
- vii) Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal për komisionet e përhershme lidhur me shqyrtimin e dytë të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit bazik për KPMSHCK, të 18 korrikut 2023;
- viii) Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit bazik për KPMSHCK, së bashku me raportet e komisioneve të përhershme, të 15 shtatorit 2023;
- ix) Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, të 26 korrikut 2023;
- x) Vendimin [Nr. 08-V-615] të Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit bazik për KPMSHCK, të 12 tetorit 2023;
- xi) Pjesë nga transkripti i seancës plenare për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit bazik për KPMSHCK, të 12 tetorit 2023;
- xii) Ligjin Nr. 08/L-180 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të 12 tetorit 2023.
13. Më 14 nëntor 2023, KPMSHCK dorëzoi në Gjykatë komentet e tij lidhur me kërkesat.
14. Më 15 nëntor 2023, Kryeministri dorëzoi në Gjykatë komentet e tij lidhur me rastin.
15. Më 15 nëntor 2023, deputeti i grupit parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, (në tekstin e mëtejme: grupi parlamentar i LVV-së), Valon Ramadani dorëzoi në Gjykatë komentet e tij lidhur me rastin.
16. Më 21 nëntor 2023, Gjykata njoftoi për pranimin e komenteve lidhur me kërkesat KO232/23 dhe KO233/23: (i) parashtruesit e kërkesave; (ii) Presidenten; (iii) Kryetarin e Kuvendit; (iv) Kryeministrin; (v) Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit; (vi) Avokatin e Popullit; si dhe (vii) KPMSHCK-në.
17. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
18. Më 17 maj 2024, Gjykata pasi shqyrtoi Raportin e gjyqtarit raportues, vendosi që shqyrtimin e tij ta shtyjë për një seancë të radhës pas plotësimeve shtesë.
19. Më 21 qershor 2024, Gjykata, vendosi që (i) njëzëri, të deklarojë kërkesën e pranueshme; dhe të konstatojë (ii) njëzëri, se nenet 2, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 08/L-180 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] në ndërlidhje me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të njëjtat shpallen të pavlefshme; (iii) me shtatë (7) vota për dhe dy (2) kundër, se neni 6 i Ligjit Nr. 08/L-180 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe i njëjti shpallet i pavlefshëm; (iv) njëzëri, se nenet 9, 10 dhe

11 të Ligjit Nr. 08/L-180 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të njëjtit shpallën të pavlefshëm; (v) njëzëri, që në bazë të nenit 43 (Afati) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-180 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i dërgohet për shpallje Presidentit të Republikës së Kosovës, pa nenet 2, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11; si dhe (vi) njëzëri, ta refuzojë kërkesën për masën e përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

20. Më 30 shtator 2022, Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria), në mbledhjen e saj të 99-të, përmes Vendimit [Nr. 30/99], miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KPMSHCK.
21. Më 3 tetor 2022, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KPMSHCK iu është shpërndarë për shqyrtim deputetëve të Kuvendit.
22. Më 23 shkurt 2023, pas leximit të parë, në prezencë të 88 (tetëdhjetë e tetë) deputetëve, me 61 (gjashtëdhjetë e një) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KPMSHCK dhe, përmes Vendimit [Nr. 08-V485], ngarkoi i) Komisionin funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, si komision funksional raportues (në tekstin e mëtejme: Komisioni funksional); ii) Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere; iii) Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit; iv) Komisionin për Integritet Evropian si dhe i) Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, që të shqyrtojnë projektligjin në fjalë dhe të paraqesin raportet e tyre me rekomandime.
23. Më 17 korrik 2023, Komisioni funksional shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KPMSHCK, dhe vendosi që Kuvendit dhe komisioneve të përhershme t'ua paraqesë raportin me 3 (tri) amendamente. Amendamentet e propozuara përfshijnë ndryshimet si në vijim:
 - (i) **Amendamenti 1 (një)** parasheh shtimin e nenit 3 në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KPMSHCK-në, përmes të cilit ndryshohet në tërësi neni 8 (Përbërja e Këshillit) i Ligjit Nr. 06/L-048 për KPMSHCK-në (në tekstin e mëtejme: Ligji bazik për KPMSHCK-në), ashtu që nga shtatë (7) anëtarë të KPSHCK-së, rritet numri i tyre në pesëmbëdhjetë (15), si dhe ndryshohet raporti i pasqyrimin etnik dhe gjinor i anëtarëve;
 - (ii) **Amendamenti 2 (dy)** parasheh shtimin e një neni para nenit 3 të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KPMSHCK-në, përmes të cilit ndryshohet përmbajtja e nenit 9 të Ligjit bazik ashtu që ndryshohen kriteret e emërimit të anëtarit të KPMSHCK-së; dhe
 - (iii) **Amendamenti 3 (tre)** parasheh shtimin e një neni para nenit 3 të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KPMSHCK-në, përmes të cilit ndryshohen paragrafët 4 dhe 5 të nenit 10 të Ligjit bazik për KPMSHCK-në, respektivisht ndryshohen kompetencat e Komisionit funksional përkatës, i cili është përgjegjës për zhvillimin e procedurave për emërimin e anëtarëve të KPMSHCK-së.

24. Më 20 korrik 2023, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, vlerësoi se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KPMSHCK është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm. Të njëjtën ditë, Komisioni për Integritet Evropian shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KPMSHCK, dhe vlerësoi se i njëjti nuk është në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
25. Gjithashtu më 20 korrik 2023, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe kthim shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KPMSHCK dhe vlerësoi se përmes të njëjtit nuk cenohen dhe nuk preken të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
26. Më 26 korrik 2023, Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere shqyrtoi Projektligjin, për plotësim ndryshimin e ligjit bazik të KPMSHCK dhe vlerësoi se i njëjti nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
27. Më 15 shtator 2023, Komisioni funksional, miratoi raportin e tij përkitazi me Projektligji për plotësim ndryshimin e ligjit bazik të KPMSHCK, duke i propozuar Kuvendit miratimin e tij.
28. Më 12 tetor 2023, Kuvendi, pas leximit të dytë, në prezencë të 63 (gjashtëdhjetë e tre) deputetëve, me 59 (pesëdhjetë e nëntë) vota për, asnjë kundër dhe 4 (katër) abstenime, e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KPMSHCK.

Dispozitat e kontestuara të Ligjit Nr.08/L-180 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

**Neni 1
(pa titull)**

“Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.”

**Neni 2
(pa titull)**

“Te neni 6 i ligjit bazik, shtohet paragrafi 2. si në vijim:

2. Pavarësisht paragrafit 1. nën-paragrafit 1.1. të këtij neni, KPMSHCK nuk ka kompetencë të vendosë për ankesat kundër vendimit të Qeverisë për nëpunësit civile në pozitat e larta drejtuese. Kundër këtyre vendimeve, pala ka të drejtë të hap konflikt administrativ në gjykatën kompetente në pajtim me ligjin përkatës për konfliktet administrative.”

**Neni 3
(pa titull)**

“Neni 8 i Ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

Neni 8
(Përbërja e Këshillit)

1. Këshilli përbëhet prej pesëmbëdhjete (15) anëtareve që emërohen nga Kuvendi Republikës së Kosovës.
2. Përbërja e Këshillit pasqyron karakterin shumëetnik dhe gjinor të Kosovës. Së paku tre (3) anëtarë emërohen nga komunitetet joshqiptare, dhe se paku katër (4) anëtarë duhet të jenë të gjinisë femërore.”

Neni 4
(pa titull)

“Neni 9 i Ligjit bazik, ndryshohet si ne vijim:

Neni 9
(Kriteret për emërimin e anëtarit të Këshillit)

1. Kandidati që aplikon për t'u emëruar anëtar i Këshillit duhet të ketë kualifikimet dhe të plotësojë kriteret në vijim:
 - 1.1. të jete shtetas i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. të ketë diplomë të fakultetit juridik të vlefshme sipas ligjit në fuqi;
 - 1.3. të ketë së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave se paku katër (4) vite përvojë pune në shërbimin civil apo zyrtar publik;
 - 1.4. të jetë njohës i mirë i legjislacionit në fuqi;
 - 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje;
 - 1.6. ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil me vendim përfundimtar.”

Neni 5
(pa titull)

“Neni 10 i Ligjit bazik, paragrafët 4. dhe 5. ndryshohen si në vijim:

4. Për zhvillimin e procedurave për emërimin e anëtareve të Këshillit, Komisioni funksional përkatës ka kompetenca si ne vijim:
 - 4.1. shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve;
 - 4.2. përgatitjen e listës së shkurtër të kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara ligjore;
 - 4.3. intervistimin dhe vlerësimin e kandidateve, si dhe
 - 4.4. përgatitjen e rekomandimit për kandidatët e suksesshëm.
5. Brenda periudhës kohore prej njëzetënjë (21) ditësh pas mbylljes së shpalljes publike, Komisioni funksional përkatës, përfundon procedurën e përzgjedhjes dhe i rekomandon Kuvendit të Kosovës dy (2) kandidate të cilët janë vlerësuar me më së shumti pikë, për çdo vend të lirë të punës në Këshill.”

Neni 6
(pa titull)

“Nenin 11 i ligjit bazik, paragrafi 3. fshihet nga teksti i ligjit.

**Neni 7
(pa titull)**

1. Tek neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 1., në fjalinë e parë, pas togfjalëshit: "apo kandidati për pranim në shërbim civil", shtohen fjalët: "në përjashtim të kandidatëve të suksesshëm të propozuar për pozita të larta drejtuese".
2. Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 6. fshihen fjalët "të nivelit të lartë drejtues" nga teksti i ligjit bazik.

**Neni 8
(pa titull)**

"Tek neni 19 i ligjit bazik, në secilin paragraf apo nën-paragraf të këtij neni, fshihen fjalët "të nivelit të lartë drejtues"."

**Neni 9
(pa titull)**

"Neni 21 i ligjit bazik riformulohet në tërësi si në vijim:

1. Vendimi i Këshillit është vendim administrativ dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës.
2. Zbatimi i vendimit duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditësh pas përfundimit të afatit për ankesë në gjykatën kompetente të përcaktuar me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ, përveç kur vendimi kontestohet në gjykatën kompetente.
3. Moszbatimi i vendimit të Këshillit në afatin e përcaktuar në rastet kur asnjëra palë nuk e ka kontestuar në gjykatën kompetente, apo pas vendimit përfundimtar të gjykatës kompetente, paraqet shkelje të dispozitave të këtij ligji."

**Neni 10
(pa titull)**

"Paragrafi 2. i nenit 22 i ligjit bazik riformulohet si në vijim:

2. Në rastet kur inicohet konflikt administrativ ndaj vendimit të Këshillit në gjykatë kompetente, ekzekutimi i vendimit për rastin bëhet vetëm kur ka vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente."

**Neni 11
(pa titull)**

"Paragrafi 1 i neni 23 të ligjit bazik riformulohet si në vijim, kurse paragrafët 5. dhe 6. fshihen:

1. Nëse personi përgjegjës i institucionit nuk e zbaton vendimin e Këshillit brenda afati të paraparë me nenin 21 të këtij Ligji, në rastet kur asnjëra palë nuk e ka kontestuar vendimin e Këshillit në gjykatën kompetente, Kryetari i Këshillit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur ka kaluar afati për zbatim, në të gjitha rastet duhet të njoftojë me shkrim Kryetarin e Kuvendit, Komisionin përkatës për administratë publike dhe eprorin e drejtpërdrejtë të personit përgjegjës për zbatim."

Neni 12 (Hyrja në fuqi)

“Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.”

Dispozitat relevante të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Neni 6 (Funksionet e Këshillit)

“1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore:

- 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil;*
- 1.2. mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil;*
- 1.3. monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.”*

Neni 8 (Përbërja e Këshillit)

- “1. Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve që emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.*
- 2. Përbërja e Këshillit pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës. Së paku dy (2) anëtarë emërohen nga komunitetet joshqiptare, dhe së paku dy (2) anëtarë duhet të jenë të gjinisë femërore.”*

Neni 9 (Kriteret për emërimin e anëtarit të Këshillit)

- “1. Kandidati që aplikon për t’u emëruar anëtar i Këshillit duhet të ketë kualifikimet dhe të plotësojë kriteret në vijim:*
- 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;*
- 1.2. të ketë diplomë të fakultetit juridik të vlefshme sipas ligjit në fuqi;*
- 1.3. të ketë së paku dhjetë (10) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave së paku pesë (5) vite përvojë pune në shërbimin civil;*
- 1.4. të ketë të kryer provimin e jurisprudencës;*
- 1.5. të jetë njohës mirë i legjislacionit në fuqi;*
- 1.6. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje*
- 1.7. ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil me vendim përfundimtar.”*

Neni 10 (Procedura për emërimin e anëtarëve të Këshillit)

- “[...]*
- 4. Për zhvillimin e procedurave për emërimin e anëtarëve të Këshillit, Kuvendi i Kosovës themelon një Komision ad-hoc, i cili ka kompetenca si në vijim:*
 - 4.1. shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve;*

- 4.2. përgatitjen e listës së shkurtër të kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara ligjore;
- 4.3. intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve, si dhe 4.4. përgatitjen e rekomandimit për kandidatët e suksesshëm.
5. Brenda periudhës kohore prej njëzetënjë (21) ditësh pas mbylljes së shpalljes publike, Komisioni ad-hoc, përfundon procedurën e përzgjedhjes dhe i rekomandon Kuvendit të Kosovës dy (2) kandidatë të cilët janë vlerësuar me më së shumti pikë, për çdo vend të lirë të punës në Këshill.”

Neni 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit)

- [...]
3. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi.”

Neni 16 (Shqyrtimi i ankesave)

- “1. Nëpunësi civil, apo kandidati për pranim në shërbimin civil i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshill, lidhur me pretendimin për shkeljen e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.
2. Nëpunësi civil apo kandidati për pranim në shërbimin civil ka të drejtë që të parashtojë ankesë në Këshill në mënyrë elektronike në pajtim me legjislacionin përkatës për komunikimin elektronik si dhe rregullat e përcaktuara me rregulloren përkatëse për parashtrimin e ankesave në Këshill.
3. Në emër të Këshillit, ankesat i shqyrton dhe i vendos Kolegji i përbërë nga tre (3) anëtarë, i cili përcaktohet me vendim të Këshillit.
4. Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe.
5. Këshilli duhet tu jap të drejtë palëve në procedurë që të paraqesin me shkrim provat dhe faktet e tyre lidhur me rastin. Në rast të kontestit lidhur me faktet materiale, të dy palëve u jepet mundësia që së bashku të merren në pyetje nga Këshilli, me qëllim të paraqitjes së provave dhe dëshmive përkatëse.
6. Anëtari i Këshillit i cili ka mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes për emërimet e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, nuk ka të drejtë të marrë pjesë në procedurën e shqyrtimit të ankesës lidhur me të njëjtën procedurë.”

Neni 19 Procedura e mbikëqyrjes së përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues

- “1. Këshilli mbikëqyrë të gjitha procedurat e përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues.
2. Institucioni i administratës publike që fillon procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civil sipas paragrafit 1 të këtij neni, është i obliguar që brenda pesë (5) ditësh nga momenti i publikimit të shpalljes së konkursit, të njoftojë me shkrim Këshillin.
- [...]
6. Këshilli është i obliguar që të nxjerr vendim për procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, brenda afatit prej

tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të dosjes complete nga organi i punësimit. 7. Nëse zhvillimi i procedurës për përzgjedhjen e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, bëhet pa njoftim të Këshillit për pjesëmarrje në mbikëqyrje, procedura konsiderohet e pavlefshme dhe Këshilli sipas detyrës zyrtare nxjerr vendim për anulimin e procedurës. 8. Vendimi i Këshillit për procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, është vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe kundër këtij vendimi palët në procedurë kanë të drejtë të iniciojnë konflikt administrativ, në pajtim me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ.”

Neni 21 (Vendimi i Këshillit)

“1. Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës.

2. Zbatimi i vendimit duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Këshillit.

3. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit, paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës.”

I. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës në rastin KO232/23

29. Parashtruesit e kërkesës KO232/23, fillimisht pretendojnë se procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar është zhvilluar në kundërshtim me nenin 77 (Shqyrtimi i projektligjit të qeverisë për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit) të Rregullores së Kuvendit si dhe kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së përmbajtjes së Ligjit të kontestuar, duke pretenduar se dispozitat e tij nuk janë në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 101 [Shërbimi Civil], nenin 142 [Agjencitë e Pavarura], të Kushtetutës.
30. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO232/23 lidhur me i) procedurën e ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar, për të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se është nxjerrë në kundërshtim me nenin 77 (Shqyrtimi i projektligjit të qeverisë për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit) të Rregullores së Kuvendit; si dhe ii) përmbajtjen e Ligjit të kontestuar, për të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nuk është në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 101 [Shërbimi Civil] dhe nenin 142 [Agjencitë e Pavarura], të Kushtetutës.
31. Gjykata në vijim do të reflektojë pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës, sipas kronologjisë së paraqitur në kërkesë në ndërlidhje me Ligjin e kontestuar.
 - (i) *Pretendimet për shkeljet procedurale gjatë miratimit të Ligjit të kontestuar*
32. Lidhur me procedurën e miratimit të Ligjit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: *“Nisma për hartimin dhe miratimin e ligjit kontestues është marrë nga ana e Qeverisë dhe si e tillë është propozuar për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Megjithatë, ndryshimet e miratuara në përmbajtjen e tekstit të ligjit të kontestuar tejkalojnë vëllimin e ndryshimeve të propozimeve në draftin e projektligjit të qeverisë, pasi Komisioni, në kundërshtim me nenin 77 (Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit) të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka propozuar edhe amendamente, respektivisht nen të reja”.*

- (ii) *Pretendimet për mospërputhshmërinë e Ligji të kontestuar me Kushtetutën*
33. Parashtruesit e kërkesës KO232/23, theksojnë se Ligji i kontestuar në tërësinë e tij cenon “rolin, funksionin dhe statusin kushtetues” të KPMSHCK-së, sepse sipas tyre:
- “i) E zhvesh nga përgjegjësia kushtetuese për vlerësimin e ankesave dhe ligjshmërisë së procedurave (për të cilat vendos Qeveria) lidhur me marrëdhënien e punës së nivelit të lartë drejtues të zyrtarëve publikë;
 ii) E rrit përbërjen numerike të anëtarëve nga shtatë (7) sa ka aktualisht në pesëmbëdhjetë (15) anëtarë;
 iii) Anëtarëve të tij ua heq të drejtën kushtetuese në imunitet funksional;
 iv) E bën jo efektiv vendimin e Këshillit, në rastet kur iniciohet konflikt administrativ ndaj vendimit të tij në gjykatën kompetente, duke e cenuar në thelb parimin e sigurisë juridike dhe parimin e gjykimit të drejtë dhe në këtë arsyeshme, sepse inicimi i konfliktit administrativ, në bazë të ligjit të kontestuar e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit;”
- (iii) *Pretendimet përkitazi me nenin 2 të Ligjit të kontestuar, i cili plotëson dhe ndryshon nenin 6 të Ligjit bazik*
34. Në lidhje me nenin 2 të Ligjit të kontestuar, i cili plotëson dhe ndryshon nenin 6 (Funksionet e Këshillit) të Ligjit bazik, duke shtuar një paragraf të ri, respektivisht paragrafin 2, siç është reflektuar tek dispozitat e Ligjit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës theksojnë se me nenin 6 të Ligjit bazik janë të përcaktuara funksionet e KPMSHCK-së, duke specifikuar se ky i fundit merr vendime për ankesat e të gjithë nëpunësve civil, ndërsa përmes ndryshimeve me Ligjin e kontestuar, ky i fundit “[...] e zhvesh nga përgjegjësia kushtetuese për vlerësimin e ankesave dhe ligjshmërisë së procedurave (për të cilat vendos Qeveria” lidhur me marrëdhënien e punës së nivelit të lartë drejtues të zyrtarëve publik, dhe në këtë mënyrë e ngushton dhe zvogëlon këtë funksion”.
35. Sipas parashtruesve, neni 2 i Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës, “[...] duke kufizuar kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit me Ligj, përderisa të njëjtat janë të garantuara me Kushtetutë”.
36. Parashtruesit e kërkesës tutje theksojnë se: “përcaktimi i KPMSHCK si institucion kushtetues për të mbrojtur rregullat mbi shërbimin civil ka për qëllim, krahas mbrojtjes së standardeve dhe parimeve në shërbimin civil, edhe garantimin e mjeteve juridike efektive për subjektet të cilët janë pjesë e procedurave ku zbatohen rregullat e shërbimit civil”. Sipas parashtruesve të kërkesës, neni 2 i Ligjit të kontestuar, jo vetëm që pakëson kompetencat e vet institucionit, por shihet edhe si “mohim i të drejtës në ushtrimin e mjetit juridik për një pjesë të shërbimit civil në të drejtat e tyre kushtetuese”, respektivisht shkel nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.
37. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu theksojnë se neni 2 i Ligjit të kontestuar, “[...] përjashton nga e drejta e ankesës në KPMSHCK një pjesë të zyrtarëve publik derisa u lejon mundësi për ankesë zyrtarëve të tjerë publikë”. Sipas parashtruesve, kjo e cenon nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesit theksojnë se në një situatë analoge kishte vlerësuar edhe Gjykata Kushtetuese, ku kishte nënvizuar se “trajtimi i pabarabartë i shërbyesve civil në raport me kompetencat e Këshillit për mbikëqyrje të përzgjedhjes së shërbyesve civil, i përcaktuar me nenin 6 paragrafi 1.2 i Ligjit të kontestuar nuk është në pajtueshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës. Krahas shkeljes kushtetuese, reflektimi i kësaj dispozite në praktikë paraqet një potencial ekstremisht të lartë për

cenimin e të drejtave të njeriut, influencë politike në rekrutimin e këtyre pozitave dhe dëmtim të buxhetit”.

(iv) Pretendimet përkitazi me nenet 3, 4 dhe 5 të Ligjit të kontestuar, të cilat plotësojnë dhe ndryshojnë nenet 8, 9 dhe 10 të Ligjit bazik

38. Përkitazi me nenet 3, 4 dhe 5 të Ligjit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se “*paraqesin ndryshime të reja të miratuara në përmbajtjen e tekstit të ligjit të cilat tejkalojnë vëllimin e ndryshimeve të propozimeve në draftin e projektligjit të qeverisë, pasi komisioni, në kundërshtim me nenin 77 (Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit) të Rregullores së Punës së Kuvendit ka propozuar edhe amendamente, respektivisht nenet 3, 4 dhe 5” .*

39. Sipas parashtruesve të kërkesës, neni 3 i Ligjit të kontestuar paraqet shkelje procedurale, duke “*përrjashtuar mundësinë që të hartohen, propozohen dhe të miratohen nene të reja në raste të tilla”.*

40. Lidhur me këtë pretendim, në fund parashtruesit e kërkesës shtojnë se Ligji i kontestuar është miratuar me procedurë që rezulton me shkelje të Rregullores së Punës së Kuvendit.

(v) Pretendimet përkitazi me nenin 6 të Ligjit të kontestuar, i cili plotëson dhe ndryshon nenin 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit bazik

41. Neni 6 i Ligjit të kontestuar ndryshon nenin 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit bazik duke fshirë paragrafin 3 të këtij të fundit

42. Parashtruesit e kërkesës potencojnë se Ligji bazik është “*materializim dhe operacionalizim*” i neneve 101 [Shërbimi Civil] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, dhe sipas tyre “*çdo shkelje e tij, sidomos sa i takon heqjes së imunitetit është shkelje e qartë e dispozitave si më sipër të Kushtetutës”.*

43. Më tutje, lidhur me këtë parashtruesit e kërkesës theksojnë se sipas praktikës së vet Gjykatës “*ky imunitet [...] është tërësisht i vlefshëm dhe si i tillë është i karakterit funksional, përderisa në kuptimin e rolit që ka, KPMSHCK gëzon prerogativat e një gjykate në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*

44. Tutje, ata theksojnë se marrja e imunitetit për kryetarin dhe anëtarët e tjerë të KPMSHCK-së “[...] drejtpërdrejtë cenon pavarësinë e këtij institucioni si dhe cenon të drejtat e palëve. Është absurde të konsiderohet se për secilin rast, anëtarët e KPMSHCK do të bartin edhe përgjegjësi civile”.

45. Parashtruesit e kërkesës në ndërlidhje me këtë pretendim i referohen edhe rastit të Gjykatës KO171/18, parashtrues Avokati i Popullit, Aktgjykim i 25 prillit 2019, respektivisht paragrafit 247, duke theksuar ndër të tjera se “*Ky aktgjykim tashmë ka statusin e normës kushtetuese, pra është i barabartë për nga efekti juridik me çdo dispozitë tjetër të Kushtetutës”.*

46. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës thirren edhe në rastin e Gjykatës, KO127/21 [parashtrues Abelard Tahiri dhe dhjetë deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2021, paragrafi 114], duke potencuar se imuniteti i anëtarëve të KPMSHCK-së është konsideruar si një element i domosdoshëm i pavarësisë dhe si një mundësi që anëtarët të jenë të lirë të “*ushtrojnë funksionet e tyre me pavarësi dhe pa frikën e pasojave për kryerjen e funksioneve të tyre në lidhje me pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre*

[...] ky institucion këtë nuk mund ta bëjë në mënyrën dhe standardet e kërkuara kushtetuese nëse nuk ka imunitet”.

(vi) Përkitazi me pretendimet e parashtruesve lidhur me nenin 10 të Ligjit të kontestuar, i cili ndryshon dhe plotëson paragrafin 2 të nenit 22 (Inicimi i konfliktit administrativ) të Ligjit bazik

47. *Në ndërlidhje me këtë parashtruesit e kërkesës, theksojnë se “Ligji i kontestuar përfundimisht e bën jo efektiv vendimin e Këshillit, në rastet kur iniciohet konflikt administrativ ndaj vendimit përkatës në gjykatën kompetente, duke e cenuar në thelb parimin e sigurisë juridike dhe parimin e gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme sepse inicimi i konfliktit administrativ, në bazë të ligjit kontestues e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit. Aktualisht, në procedurën administrative Këshilli vepron si shkallë e dytë. Në secilin rast kur merret një vendim nga institucioni në procedurën administrative të shkallës së parë, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshill. Në bazë të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative [neni 130] parashtrimi i ankesës e pezullon zbatimin e vendimit të shkallës së parë. Sipas Ligjit, vendimi i Këshillit konsiderohet i formës së prerë dhe është vendim i zbatueshëm. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit përjashtimisht nëse Gjykata vlerëson se në një rast specifik kjo duhet të ndodhë dhe vendosë masë të përkohshme”.*
48. *Parashtruesit e kërkesës shtojnë se përmes Ligjit të kontestuar, në rastet kur iniciohet konflikt administrativ në gjykatat e rregullta, Vendimet e KPMSHCK-së nuk do të zbatohen deri në një vendim përfundimtar të gjykatave të rregullta.*
49. *Të njëjtit po ashtu theksojnë se: “Kjo zgjidhje ligjore është në kundërshtim me aspektet konceptuale në mes të procedurës administrative dhe procedurës gjyqësore. Këto dy procedura janë procedura të ndryshme dhe të ndara. Procedura administrative, e cila përfundon në shkallë të dytë brenda institucioneve administrative, rregullohet me ligj tjetër nga konflikti administrativ që zhvillohet në gjykatë. Për këtë arsye, ndërlidhja e zbatueshmërisë së vendimit të Këshillit me vendimin e gjykatës, përderisa gjykata nuk ka shqiptuar mase të përkohshme, është përzierje e dallimeve bazë në mes të procedurës administrative dhe asaj gjyqësore. Ekzistimi i këshillit si organ administrativ për mbrojtjen e të drejtave gjyqësore ka për synim zgjidhjen e juridike të çështjeve dhe ankesave brenda administratës si dhe ngritjen e efikasitetit në trajtimin e këtyre rasteve. Pezullimi ex-lege i vendimit të këshillit deri në nxjerrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë praktikisht paraqet përjashtim të këshillit nga roli i tij kushtetues dhe pamundëson zgjidhjen e ankesave brenda procedurës administrative. Ky nen, që rregullon formën dhe mënyrat e themelimit të Agjencive të Pavarura, përcakton katër parime bazë që duhet të shoqërojnë themelimin dhe funksionimin e Agjencive të Pavarura. Së pari, Kuvendi i Kosovës është autoriteti kushtetues i cili mban tagrin e themelimit të Agjencive të Pavarura. Për themelimin e tyre, neni në fjalë përcakton që Kuvendi duhet të nxjerrë ligjet përkatëse, që rregullojnë, ndër të tjera, funksionimin, dhe fushëveprimin ligjor të tyre. Së dyti, Kushtetuta përcakton që Agjencive të Pavarura duhet t’u garantohet që ushtrimi i funksionit të tyre ligjor të realizohet pa ndikim dhe në mënyrë të pavarur nga çdo udhëzim apo ndërhyrje e organeve tjera shtetërore, përfshirë organin që e ka themeluar. Së treti, për garantimin e pavarësisë së tyre, neni 142 përcakton që Agjencitë e Pavarura duhet të posedojnë buxhetin e tyre të veçantë, dhe të administrojnë me këtë të fundit në mënyrë të pavarur, dhe, parimi i fundit kushtetues i cili duhet të shoqërojë themelimin e Agjencive të Pavarura, lidhet me gradacionin kushtetues që organet tjera shtetërore të ruajnë pavarësinë, të bashkëpunojnë dhe t’u përgjigjen kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre kushtetuese dhe ligjore”.*

50. Në fund, parashtruesit e kërkesës KO232/23, kërkojnë nga Gjykata si në vijim: (i) të deklarojë kërkesën e pranueshme; dhe (ii) të konstatojë se Ligji i kontestuar, nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën dhe i njëjti të shpallet i pavlefshëm në tërësi.

II. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës në rastin KO233/23

51. Parashtruesit e kësaj kërkesë pretendojnë se nenet 2, 3, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] si dhe nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.
52. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës KO233/23 lidhur me mospërputhshmërinë e neneve të lartcekura të Ligjit të kontestuar me Kushtetutën.

(i) Pretendimet që ndërlidhen me nenet 2, 7 dhe 8 të Ligjit të kontestuar

53. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se nenet 2, 7 dhe 8 të Ligjit të kontestuar “*kufizojnë rolin kushtetues të këtij institucioni, pasi që Kushtetuta e Republikës së Kosovës i ka dhënë mandat Këshillit që të "siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës". Pra, Kushtetuta i ka dhënë tagrin kushtetues Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës që të mbikëqyrë gjithë shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe jo vetëm disa kategorive të shërbimit civil*”.
54. Tutje, lidhur me nenet e lartcekura të Ligjit të kontestuar, ku ndër të tjera KPMSHCK-së i hiqet kompetenca për të vendosur për ankesat e nëpunësve të nivelit të lartë drejtues, parashtruesit e kërkesës theksojnë se “*në Aktgjykimin në rastin nr. KO 171/18 të publikuar me datën 20 maj 2019, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në pikën 98 dhe 99 të këtij Aktgjykimi ka konstatuar se “fushëveprimi i Këshillit është i lidhur ngushtë me ligjin bazik, respektivisht me ligjin e posaçëm që e rregullon shërbimin civil”. Prandaj, edhe në këtë kuptim me LIGJIN NR. 08/L-197 PER ZYRTARET PUBLIK, i cili e rregullon shërbimin civil dhe ka hyrë në fuqi me datën 18,09,2023, i është njohur kompetenca KPMSHCK-se që t'i trajtojë dhe të vendos për ankesat e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, Heqja e kompetencës së KPMSHCK për të vendosur për ankesat për pozitat e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues është në kundërshtim edhe me nenin 32 të Kushtetutës, Nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues iu pakësohen të drejtat e tyre kushtetuese, rrjedhimisht të drejtat e njeriut [neni 32] të garantuara me Kushtetutë, sepse iu pa mundësohet aplikimi i mjeteve juridike administrative në procedurë administrative. Kjo qasje e trajtimit jo të barabartë, është në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës, që garanton barazinë para ligjit*”.

(ii) Pretendimet përkitazi me nenin 6 të Ligjit të kontestuar

55. Në lidhje me nenin 6 të Ligjit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës, ndër të tjera, pretendojnë se: “*Çështja e imunitetit funksional për kryetarin dhe anëtarët e Këshillit, është e përmbyllur me Aktgjykimin në rastin nr. KO 171/18 të publikuar me datën 20 maj 2019 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Në këtë rast, Avokati i Popullit, ndër të tjera kishte kontestuar imunitetin e kryetarit dhe anëtarëve të KPMSHCK-se, por Gjykata Kushtetuese e kishte hedhur poshtë pretendimin e Avokatit të Popullit*”.

56. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës shtojnë se: *“Shumica parlamentare, synon që t’ua marr imunitetin funksional Kryetarit dhe anëtarëve të KPMSHCK. Marrja e imunitetit për kryetarin dhe anëtarët e KPMSHCK e cenon në bërthamë pavarësinë e këtij institucioni si dhe ndikon drejtpërdrejt në frikësimin dhe vendimmarrjen e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit, rrjedhimisht ndikon në pasigurinë juridike të mijëra nëpunësve civil, të cilët presin vendimmarrje të bazuar në ligj nga Këshilli i Pavarur dhe jo vendimmarrje nën presionin e Qeverisë dhe mekanizmave tjerë politikë.*
57. Parashtruesit e kërkesës, duke u thirrur në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), shtojnë se: *“[...] imuniteti funksional është i rëndësishëm si për pavarësinë e gjyqtarëve ashtu edhe për të drejtat e palëve. Në rastin e parë, imuniteti funksional u mundëson gjyqtarëve që të kryejnë detyrat e tyre pa frikën se ushtrimi i kompetencave të tyre mund të rezultojë që ata të konsiderohen përgjegjës për dëmet e shkaktuara. Po ashtu, ky lloj imuniteti u mundëson gjyqtarëve që të fokusohen në punën e tyre dhe që të mos shqetësohen vazhdimisht nga paditë e ngritura ndaj tyre. Krahas kësaj, sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, imuniteti funksional u mundëson palëve që të apelojnë vendimet gjyqësore në shkallë më të lartë dhe që mos kenë nevojë që të hapin një rast të veçantë civil. Pra, në këtë frymë, kuptohet fakti se qytetarët do t’i atakojnë vendimet e nxjerra dhe jo vendimmarrësi”.*
- (iii) *Pretendimet përkitazi me nenin 9 të Ligjit të kontestuar*
58. Parashtruesit e kërkesës, në ndërlidhje me këtë pretendim, fillimisht para Gjykatës theksojnë se Gjykata në disa raste të saj ka konstatuar se vendimet e KPMSHCK-së, janë vendime *“përfundimtare, të detyrueshme dhe të ekzekutueshme”.*
59. Për më tepër, lidhur me statusin juridik të KPMSHCK-së, parashtruesit e kërkesës thirren në praktikën e Gjykatës, respektivisht në rastin KO171/18, cituar më lart, si dhe në rastet individuale, respektivisht KI33/16, parashtrues *Minire Zeka*, Aktgjykim i 6 korrikut 2017, paragrafi 56; KI50/12, parashtrues *Agush Lloluni*, Aktgjykim i 9 korrikut 2012, paragrafi 36 ; di he KI129/11, parashtrues *Viktor Marku*, Aktgjykim i 11 korrikut 2012, paragrafi 42.
60. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (në tekstin e mëtejme: LPPA), parashtrimi i ankesës në KPMSHCK pezullon zbatimin e vendimit të institucionit përkatës, dhe se vendimet e KPMSHCK-së konsiderohen si vendime të formës së prerë. Të njëjtit nënvizojnë se *“[...] inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të KPMSHCK-së, përjashtimisht nëse gjykata vlerëson se në një rast specifik kjo duhet të ndodhë dhe vendosë masë të përkohshme”.*
61. Tutje, parashtruesit e kërkesës shtojnë se: *“Sipas dispozitave të Ligjit të kontestuar, në secilin rast kur ndaj vendimit të KPMSHCK iniciohet padi në gjykatë, vendimi i KPMSHCK nuk do të zbatohet deri në momentin kur gjykata të nxjerrë vendim të formës së prerë. [...] ndërlidhja e zbatueshmërisë së vendimit të KPMSHCK me vendimin e gjykatës, përderisa gjykata nuk ka shqiptuar masë të përkohshme, është përzierje e dallimeve bazë në mes të procedurës administrative dhe asaj gjyqësore, dhe e njëjta është në kundërshtim me nenin 31. Ekzistimi i KPMSHCK si organ përfundimtarë në procedurë administrative për zgjidhjen e kontesteve nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil ka për synim zgjidhjen e kontesteve brenda administratës si dhe ngritjen e efikasitetit në trajtimin e këtyre rasteve, Pezullimi ex lege i vendimit të KPMSHCK deri në nxjerrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë praktikisht paraqet përjashtim të KPMSHCK nga roli i saj kushtetues dhe*

pamundëson zgjidhjen e ankesave dhe zbatimin e vendimit brenda procedurës administrative”.

62. Krejt në fund, në ndërlidhje me këtë pretendim, parashtruesit shprehen se moszbatimi i vendimeve të KPMSHCK-së, nëse i njëjti atakohet në Gjykatë “[...] e godet në thelb autoritetin institucional të Këshillit, si institucion kuazi gjyqësor, dhe i njëjti pa këtë funksion nuk do të kishte fare rol në strukturën e institucioneve të pavarura, dhe si i tillë nuk do të duhej të ekzistonte fare”.

(iv) *Kërkesa për masë të përkohshme*

63. Parashtruesit e parashtruesit e kërkesës KO232/23 kërkojnë nga Gjykata që Ligji i kontestuar të pezullohet *ex-lege* dhe të mos dërgohet për zbatim deri në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për Ligjin e kontestuar.
64. Parashtruesit e kërkesës KO233/23 kërkojnë nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme, duke pretenduar si në vijim:

“(i) mosvënia e masës së përkohshme do të kishte pasoja të pariparueshme për gjithë nëpunësit civilë të Kosovës për shkak të mos zbatimit të vendimeve të KPMSHCK-së të cilat atakohen në Gjykatë, për kryetarin dhe anëtarët e Këshillit të Pavarur për shkak të heqjes së imunitetit si dhe për nëpunësit e nivelit të lartë drejtues që ju mohohet e drejta e aplikimit të mjeteve juridike në procedurë administrative;

(ii) për më tepër, si rrjedhojë e mos aplikimit të mjeteve juridike në procedurë administrative, rrjedhimisht mohimit të tyre për nëpunësit civil, do të shkaktohen pasoja të rënda të funksionimit të institucioneve si dhe do të dëmtohet buxheti i Republikës së Kosovës;

(iii) heqja e imunitetit për kryetarin dhe anëtarët e KPMSHCK do të ndikoj në frikësimin e tyre nga pushteti për të vendosur drejtë për ankesat e nëpunësve civil dhe do të dëmtonte rënd pavarësinë e këtij institucioni të pavarur.”

Komentet e dorëzuara nga KPMSHCK-ja më 14 nëntor 2023

65. Më 14 nëntor 2023, KPMSHCK-ja dorëzoi komentet e saj ndaj pretendimeve të parashtruesve të kërkesave. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë komentet e KPMSHCK-së përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe Ligjin e kontestuar, duke përfshirë ato që ndërlidhen me: (i) me nenin 2 të Ligjit të kontestuar, i cili plotëson dhe ndryshon nenin 6 (Funksionet e Këshillit) të Ligjit bazik; (ii) me nenin 6 të Ligjit të kontestuar, i cili plotëson dhe ndryshon nenin 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit bazik; dhe (iii) nenin 10 të Ligjit të kontestuar i cili ndryshon dhe plotëson paragrafin 2 të nenit 22 (inicimi i konfliktit administrativ) të Ligjit të bazik.

(i) *Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës në ndërlidhje me nenin 2 të Ligjit të kontestuar, i cili plotëson dhe ndryshon nenin 6 (Funksionet e Këshillit) të Ligjit bazik.*

66. Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës që ndërlidhet me pakësimin e kompetencave kushtetuese të KPMSHCK-së, ky i fundit pretendon se “*nuk është në pajtueshmëri me neni 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetues [...] në vlerësimin tonë fushëveprimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil është i kufizuar dhe i lidhur ngushtë me ligjin bazik respektivisht me ligjin bazik që rregullon shërbimin civil”.*

67. Sipas KPMSHCK-së, duke u bazuar në nenin 101 të Kushtetutës si dhe në nenin 5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, “*Këshilli ka mandat për mbikëqyrjen e*

zbatimit të rregullave dhe parimeve të shërbimit Civil në të gjitha institucionet e administratës publike ku ka të punësuar nëpunës Civil dhe se në përmbushje të mandatit kushtetues ushtron funksionin e shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave për të gjithë nëpunësit civil, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e drejtuesit të lartë, nëse pretendohet se janë cenuar të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, pa marrë parasysh nëse objekt i kontestit është vendimi i Qeverisë apo ndonjë vendim i organeve tjera të administratës publike [...] duke marrë parasysh se nëpunësit civil të kategorisë së lartë drejtuese, në njërin anë, si dhe nëpunësit e tjerë civil në anën tjetër, janë në situatë analoge ose situatë relativisht të ngjashme, për faktin se të gjithë janë nëpunës civil, vlerësojmë se neni 2 i ligjit të kontestuar, krijon situatë të trajtimit të pabarabartë të nëpunësve civil në raport me ushtrimin e mjeteve juridike efektive dhe si e tillë kjo dispozitë nuk është në pajtueshmëri as me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetues”.

(ii) Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës në ndërlidhje me nenin 6 të Ligjit të kontestuar i cili plotëson dhe ndryshon nenin 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit bazik

68. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për heqjen e imunitetit për anëtarët e KPMSHK-së, këta të fundit në komentet e tyre theksojnë se: “Imuniteti funksional për kryetarin dhe anëtarët e Këshillit ekziston për shkak se Këshilli kualifikohet si institucion “kuazi gjyqësor”, përkatësisht si tribunal përkitazi me zgjidhjen e kontesteve që burojnë nga shërbimi civil. Rrjedhimisht, Këshilli i Pavarur gëzon prerogativat e një “gjykate”, pikërisht për shkak të pavarësisë nga ekzekutivi dhe legjislativi dhe kualifikohet si institucion që ka juridiksion të plotë që të nxjerr vendime të detyrueshme, në lidhje me konfliktet në mes të shërbyesve civil ose kandidatëve për shërbyes civil në njërin anë, dhe institucioneve që kanë të punësuar nëpunësit civil, në anën tjetër (shih Aktgjykimin në rastin nr. KO0171/18, paragrafi 165 si dhe rastin nr. KO127/21, paragrafi 86)”.

69. Në fund, lidhur me këtë pretendim, KPMSHCK-ja shton se: “neni 3 i ligjit të kontestuar përmes të cilës dispozitë hiqet imuniteti për kryetarin dhe anëtarët e Këshillit cenon pavarësinë e Këshillit në ushtrimin e mandatit kushtetues dhe si e tillë kjo dispozitë nuk është në pajtueshmëri me nenin 101.2 të Kushtetutës, Aktgjykimin në rastin nr. KO171/18 dhe Aktgjykimin në rast-in nr. KO127/21 të Gjykatës Kushtetuese”.

(iii) Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës lidhur me nenin 10 të Ligjit të kontestuar i cili ndryshon dhe plotëson paragrafin 2 të nenit 22 (inicimi i konfliktit administrativ) të Ligjit të bazik

70. KPMSHCK-ja në komentet e saj lidhur me mungesën e efektivitetit të vendimit të KPMSHCK-së në rast të inicimit të konfliktit administrativ theksoi se: “Në rastet kur inicohet konflikt administrativ ndaj vendimit të Këshillit në gjykatën kompetente, ekzekutimi i vendimit për rastin bëhet vetëm kur ka vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente” duke ju referuar edhe rasteve të Gjykatës përkatësisht nr. KO171/18, paragrafi 165 si dhe rastin nr. KO127/21, paragrafi 86) shton se: “në rast se hapja e konfliktit administrativ ndaj vendimeve të Këshillit përbën shkak ligjor që vendimi i Këshillit të pezullohet, do t/i pamundësoj kësaj të fundit që të ushtroj në mënyrë efektive dhe efikase mandatin kushtetues për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.”

71. Në ndërlidhje me këtë, KPMSHCK-ja shton se: “pezullimi ex lege i vendimit të Këshillit bie ndesh edhe me frymën e praktikës së konsoliduar të GJEDNJ-se ku është konkluduar se në veprimet e administratës shtetërorë duhet të ketë ekuilibër midis

kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit”.

72. Në fund, duke u thirrur edhe në përmbajtjen e paragrafit 1 të nenit 13 dhe paragrafëve 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 22 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, KPMSHCK-ja thekson se: *“palëve në procedurë iu mundësohet mbrojtja e drejtave të tyre të pretenduara përmes parashtrimit të kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, me kushtin që ekzekutimi i vendimit do t’i sillte dëm paditësit i cili vështirë do të riparohej, shtyrja e ekzekutimit nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja e ekzekutimit do t’i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtarë përkatësisht personit të interesuar”.* Tutje, sipas KPMSHCK-së: *“neni 7 i ligjit të kontestuar përmes të cilat është përcaktuar se në rastet kur inicohet konflikt administrativ ndaj vendimit të Këshillit në gjykatën kompetente ekzekutimi i vendimit për rastin bëhet vetëm kur ka vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente, nuk është në pajtueshmëri me frymën e nenit 33 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, pasi që palëve të interesit në procedurë të konfliktit administrativ ku mund të jenë nëpunësit civil apo kandidatët për praninë në Shërbimin Civil, do t’iu pamundësohet shfrytëzimi i mjeteve juridike sipas kuadrit ligjor të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore, ngase dispozitat e këtyre dy ligjeve nuk kanë trajtuar dhe as rregulluar çështjen e pezullimit sipas parimit ex lege të aktit administrativ përfundimtar, sikurse janë edhe vendimet e Këshillit, përmes të cilave nëpunësve civil apo kandidatëve për praninë në shërbimin civil mund t’iu njihet apo konfirmohet ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e punës sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin civil dhe për rrjedhojë në frymën e nenit 49.1 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Kosovës”.*

Komentet e dorëzuara nga Qeveria më 15 nëntor 2023

73. Më 15 nëntor 2023, Kryeministri në emër të Qeverisë, dorëzoi komentet e tij ndaj pretendimeve të parashtruesve të kërkesave. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë komentet e Kryeministrit përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe Ligjin e kontestuar, duke përfshirë ato që ndërlidhen me (i) “zhveshjen” e KPMSHCK-së nga përgjegjësia kushtetuese; (ii) përbërjen e anëtarëve; (iii) heqjen e imunitetit; dhe (iv) mungesën e efektivitetit të vendimit të KPMSHCK-së në rast të inicimit të konfliktit administrative.

- (i) *Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për “zhveshjen” e KPMSHCK-së nga përgjegjësia kushtetuese*

74. Në lidhje me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për pakësimin e kompetencave kushtetuese të një institucioni kushtetues e me këtë, zvogëlimin e të drejtave të garantuara në nenin 32 [E drejta për mjete juridike] të Kushtetutës, Kryeministri mbështetet në Komentarin e Kushtetutës ku shtjellon nenin 32 të Kushtetutës që karakterizohet me parimin e dyshkallësisë së gjykimit si element i domosdoshëm, dhe në këtë drejtim thekson se: *“[...] sipas vetë Kushtetutës, elementi esencial përbrenda nenit 32 është sigurimi i dyshkallmërisë, gjë e cila përkon në tërësi me nenin 13 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (këtu e tutje referuar si: KEDNJ). Me ndryshimet e propozuara në ligjin e kontestuar në raport me pikën a), nuk pamundësohet dyshkallshmëria, përkundrazi. Vendimet e Qeverisë janë subjekt i vlerësimit të gjykatës andaj, me sigurimin e vlerësimit gjyqësor të vendimeve të Qeverisë, në dy shkallët minimalisht, realizohet e drejta e garantuar në nenin 32 të Kushtetutës, për më tepër, Komentari potencon që kjo e drejtë rregullohet me ligj, gjë e cila saktësisht është bërë me ndryshimet e propozuara në ligjin e kontestuar”.*

75. Kryeministri, në komentet e tij, thirret edhe në rastet e GJEDNJ, siç janë: [Ramirez Sanchez kundër Francës](#), nr. 59450/00, Aktgjykim i 4 korrikut 2006 dhe [Leander kundër Suedisë](#), nr. 9248/81, Aktgjykim i 26 marsit 1987, ku citon se GJEDNJ mund të shohë mjetin efektiv vetëm atë që paraqitet para autoriteteve gjyqësore dhe se për dallim nga rastet e mjeteve gjyqësore, GJEDNJ, çdo herë do të detyrohet të vlerësojë nëse autoritetet gjyqësore apo kuazi gjyqësore janë të pavarura. Në këtë drejtim, Kryeministrit thekson se “[...] ndryshimet e propozuara në Ligjin e kontestuar, palëve ju sigurohet pavarësi e pakontestuar e tribunalit/ gjykatës që vendos për rastin; procedura e qartë që padiskutueshëm lejon të dëgjuarit e të dy palëve (inaudita altera parte), dhe vendimmarrje e zbatueshme sipas fuqisë së autoritetit gjyqësor”.
76. Në raport me largimin e vendimmarrjes së KPMSHCK-së në raport me pushtetin ekzekutiv, Kryeministri citon komentarin e Kushtetutës lidhur me pozitën kushtetuese të Qeverisë, për të cilën konstaton se: “[...] shteti [Qeveria] përbën mekanizmin më të rëndësishëm të shtetit. Janë aty vetëm mekanizmat gjyqësore, (jo kuazi gjyqësorë apo pothuajse gjyqësorë), Kuvendi, kushtetuta apo partitë politike që e kufizojnë (apo ruajnë nga diktatura, siç citon Komentari), Si rrjedhojë, në ç’britë bëhet kufizimi i pushtetit ekzekutiv nga një trupë kuazi gjyqësore si KPMSHCK? Lidhur me këtë, duhet referuar edhe kompetencave të Qeverisë që burojnë nga Kushtetuta, në veçanti atyre që prekin drejtpërdrejtë administratën publike”.
77. Në këtë kontekst, Kryeministri, ndër të tjera, konstaton si në vijim: “1) Qeveria është përgjegjëse për menaxhimin e administratës publike (përfshirë nivelin jo politik të shërbimit civil) dhe që 2) brenda mbikëqyrjes, si kompetencë e Qeverisë, parashihet edhe shkarkimi i bartësve të administratës shtetërore brenda garancive të nenit 101. Në radhë të pare, nga autoriteti apo kompetencat e lartpërmendura kushtetuese të qeverisë, vërehet që vendimet e të njëjtës mund të bëhen subjekt i autoritetit të gjykatës apo kuvendit. Një gjë e këtillë parashihet shprehimisht me Kushtetute. [...]”
78. Kryeministri po ashtu konsideron se Qeverisë nuk mund t’i mbivendoset vendimmarrja e një trupe kuazi gjyqësore dhe në lidhje me këtë thekson: “[...] sipas Vendimit të Gjykatës Kushtetuese [KO171/18](#), nuk është institucion i pavarur kushtetues, vendimmarrjes së një pushteti të tërë të paraparë e mbrojtur me Kushtetutë”. I njëjti nënvizon se propozimi i bërë brenda Ligjit të kontestuar ka për qëllim ruajtjen e pushtetit të Qeverisë, të garantuar me Kushtetutë, mbrohet e sigurohet zbatimi i të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, respektivisht dyshkallshmëria, si dhe bëhet dallimi i domosdoshëm ndërmjet pozitave të cilat bazohen në peshën e tyre të përgjegjësisë, kompetencave dhe rolit të përgjithshëm në sigurimin e funksionimit të administratës.
- (ii) *Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për përbërjen e anëtarëve*
79. Kryeministri në komentet e tij lidhur me këtë pretendim vetëm thekson se: “Qeveria e Republikës së Kosovës konsideron që ndryshimi në përbërje të anëtarëve të KPMSHCK në asnjë baze nuk paraqet çështje kushtetuese, andaj për më tepër nuk do të lëshohet në trajtimin e pabazuar të pretenduesit të kërkesës në këtë pikë”.
- (iii) *Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për heqjen e imunitetit*
80. Në lidhje me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për ndalimin e largimit të imunitetit për anëtarët e KPMSHCK-së pasi që të njëjtit gëzojnë imunitetin në bazë të vetë Kushtetutës, sipas neneve 101 dhe 142 të saj, Kryeministri konsideron se ky konstatim i parashtruesve është i gabuar në kuptim të normave kushtetuese për shkak se sipas tyre, “KPMSHCK është organ administrativ, jo gjyqësor në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së, anëtarët e tij nuk janë gjyqtarë dhe nuk gëzojnë imunitet të garantuar

me Kushtetutë për gjyqtarët. Në këtë pikë duhet vërejtur që vetëm gjyqtarët, deputetet dhe anëtarët e Qeverisë, sipas fjalës së Kushtetutës, gëzojnë imunitetin funksional. Edhe në Vendimin KO171/18 Gjykata pohon se anëtarët e KPMSHCK nuk janë gjyqtarë e as pjesë e një institucioni gjyqësor në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së, andaj as nuk gëzojnë imunitetin e dhënë me automatizëm sipas detyrës”.

81. Për më tepër, Kryeministri thekson se (i) imuniteti është kategori ligjore; dhe 2) mund të caktohet me ligje të veçanta, si dhe rrjedhimisht, bie nën kategorizimin ligjor, Sipas tij, është në duart e ligjvënësit që të propozojë apo jo imunitetin përmes ligjit të veçantë, çka e bën heqjen e imunitetit jo kategori kushtetuese.
- (iv) *Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për mungesën e efektivitetit të vendimit të KPMSHCK-së në rast të inicimit të konfliktit administrative*
82. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për mungesën e efektivitetit të vendimit të KPMSHCK-së në rast të inicimit të konfliktit administrative, Kryeministri thekson se: “1. KPMSHCK nuk ka as formën e as organizimin e agjencisë së pavarur të Kuvendit; 2. KPMSHCK nuk mund t'i mbivendoset vendimeve të Qeverisë marrë parasysh mungesën e kompetencave që vetëm Kuvendi dhe sistemi gjyqësor kanë në bazë të Komentarit karshi Qeverisë; 3. Vendimet e KPMSHCK mund të jenë përfundimtare në procedurën administrative vetëm nëse një gjë e tillë parashihet në ligj që është pra krejtësisht në vullnetin e të zgjedhurve të popullit; 4. Zgjidhja gjyqësore e kontestit është zgjidhje e drejtë, e pavarur, ligjërishte e obligueshme dhe e zbatueshme, andaj si e tillë nuk mund të shkelë të drejtën në gjykim të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.
83. Kryeministri në komentet e tij argumenton se KPMSHCK nuk është agjenci e pavarur e Kuvendit të Republikës së Kosovës, fushëveprimi dhe funksionimi i të njëjtës do varehin nga vullneti i shprehur përmes ligjit të miratuar nga Kuvendi, dhe se edhe nëse do të ishte e tillë kompetencat varen nga legjislacioni primar që rregullon KPMSHCK-në, ashtu siç parashihet në ligjin e miratuar nga Kuvendi. Në këtë drejtim, Kryeministri thekson se pasi që burimi i kompetencave të KPMSHCK-së është Kuvendi, sipas Komentarit të Kushtetutës, kompetencat e Qeverisë nuk mund të kufizohen nga pushteti gjyqësor dhe ai legjislativ. Rrjedhimisht, sipas tij, në asnjë rrethanë nga KPMSHCK.
84. Në kontekst të efektit përfundimtar të vendimit të KPMSHCK-së, Kryeministri konsideron se zgjidhja që ofron Ligji i kontestuar edhe në aspektin e trajtimit të vendimit si përfundimtar, është zgjidhje përfundimtare. Kjo sepse sipas tij, përderisa ligji në fuqi e parasheh se vendimi i KPMSHCK-së është përfundimtar, kjo edhe zbatohet në praktikë. Prandaj, i njëjti konstaton se përderisa një gjë e tillë parashihet me ligj, rregullimi i këtillë nuk ka si të bëhet normë.
85. Kryeministri po ashtu përmend rastet e GJEDNJ-së, në të cilat theksohet se neni 6 i KEDNJ-së mbron zbatimin e vendimit final e të ekzekutueshëm si element kryesor i “*të drejtës në gjykatë*”, si dhe dispozitat e nenit 6 do t'i shmangeshin shfrytëzimit të efektshëm të tyre. Në këtë drejtim, i njëjti thirret në rastet e GJEDNJ-së, [Uzounis dhe të tjerët kundër Greqisë](#), nr. 49144/99, Aktgjykim i 18 prillit 2022, paragrafi 21; [Scordino kundër Italisë \(nr. 1\) \[DhM\]](#), nr. 36813/97, Aktgjykim i 29 korrikut 2004, paragrafi 196; [Hornsby kundër Greqisë](#), nr. 18357/91, Aktgjykim i 19 marsit 1997; paragrafi 40; dhe [Burdov kundër Ruisë](#), nr. 59498/00, Aktgjykim i 7 majit 2002, paragrafët 34-37.
86. Kryeministri gjithashtu thekson se: “E drejta e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore është e rëndësishme edhe më të madhe në kontekst të procedurave (Sharxhi dhe të tjerët

kundër Shqipërisë, 2018, § 92). Përmes ushtrimit të ankesës në gjykatën më të lartë administrative të shtetit, ankuesi kërkon zhvendosjen e efektit të vendimit paraprak që përkthehet në mbrojtjen efektive të të drejtave të ankuesit (Hornsby v. Greece, 1997, § 41; Kyrtatos v. Greece, 2003, §§ 31-32; and with regard to judgments of a constitutional court, see, mutatis mutandis, Xero Flor ë Polsce sp. z o.o. v. Poland, 2021, §§ 282-283)."

87. Për më tepër, Kryeministri në komentet e tij konsideron se Qeveria përmes krijimit të Gjykatës së veçantë për çështjet administrative, do të mundësojë:

*"1) gjykim të pavarur e të drejtë nga autoritet gjyqësore në kuptim të nenit 6 KEDNJ;
2) zgjidhjen e kontesteve në kohe të arsyeshme në kuptim të nenit 6 KEDNJ;
3) përzgjedhjen e autoriteteve gjyqësore sipas standardeve ndërkombëtare mbi të zgjedhurit "by their peers" duke eliminuar në tërësi ndikimin politik kundrejt pozitive të larta drejtuese të shërbimit civil, që paraqet qëllimin legjitim e të efektshëm në kuptim të ruajtjes së pavarësisë së administratës shtetërore nga politika por edhe diferencimit për qëllim të drejtë e legjitim, sipas definicionit të prodhuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës."*

88. Sa i përket parimit të sigurisë juridike, Kryeministri potencon se:

"Në përgjithësi, siguria juridike presupozon respektimin e parimeve të res judicata dhe finalitetit apo efektit përfundimtar të aktgjykimit (Guðmundur Andri Ástráðsson v Iceland [GC], 2020, § 238 and below).

Së fundmi, e drejta e gjyimit të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ kërkon që lënda "të dëgjohet nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm". Pavarësia e gjyqësorit është kusht sine qua non për një gjykim të drejtë sipas nenit 6 KEDNJ, (Grezedo v. Poland [GC], 2022, §301) kurse pavarësia e gjyqësorit është parakusht i sundimit të ligjit. Gjykatësit nuk mund të ruajnë sundimin e ligjit dhe t'i japin efekt të drejtave të Konventës përderisa ligjet nacionale i deprivojnë nga garancat e KEDNJ. Rrjedhimisht, përderisa Ligji për KPMSHCK obligon zbatimin e vendimeve të KPMSHCK-së edhe atëherë kur inicohet konflikti administrativ, i njëjti deprivon palët nga të dëgjuarit e lëndës së tyre nga një gjyqësor i pavarur dhe i paanshëm, i specializuar në çështjet administrative (referencë ndaj Gjykatës për Çështjet Administrative), sipas definimit të nenit 6 KEDNJ.

Andaj, parashtruesi i kërkesës përmes argumenteve të paraqitura deprivon gjykatën nga të zbatuarit e nenit 6 të KEDNJ-së dhe avokuar për mungesën e gjyimit të drejtë e të paanshëm sipas KEDNJ-së"

89. Përfundimisht, Kryeministri në emër të Qeverisë në komentet e tij, konstaton si në vijim:

"- KPMSCHK si institucion jo i pavarur kushtetues fushëveprimin e vet e rregullon me ligj të votuar nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

- propozimet e paraqitura në Ligjin e kontestuar bëjnë depolitizimin e nevojshëm të administratës publike dhe sigurojnë gjykimin e drejtë dhe të paanshëm sipas KEDNJ-së;

- rrjedhimisht, nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës kërkohet që argumentet e paraqitura nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës përmes kërkesës KO232/23 dhe KO233/23 t'i hedh pishë si të pabazuara dhe të shpall Ligjin e kontestuar si në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës."

Komentet e dorëzuara nga deputeti i grupit parlamentar të LVV-së, Valon Ramadani, më 15 nëntor 2023

90. Më 30 janar 2023, z. Ramadani, deputet i grupit parlamentar të LVV-së, dorëzoi në Gjykatë komentet e tij në lidhje me rastet KO232/22 dhe KO233/22.
91. Nga komentet e dorëzuara nga z. Ramadani, Gjykata vëren se të njëjtat ndërlidhen kryesisht me pretendimet e parashtruesve lidhur me shkeljet procedurale gjatë shqyrtimit të miratimit të ligjit të kontestuar.
92. Në komentet e dorëzuara para Gjykatës, z. Ramadani fillimisht thekson se pretendimet e parashtruesve lidhur me shkeljet procedurale gjatë shqyrtimit të miratimit të ligjit të kontestuar, nuk përbëjnë çështje kushtetuese. Në mbështetje të kësaj z. Ramadani thekson se: *“Nisur nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese [...] vendimet dhe/apo veprimet e trupave të Kuvendit të Kosovës nuk janë çështje kushtetuese dhe kësaj nuk mund të jenë objekt i vlerësimit në Gjykatën Kushtetuese”*.
93. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës i referohet edhe praktikës së vet Gjykatës, respektivisht rastit [KO45/18](#), parashtrues *Glauk Konjufca dhe 11 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 18 prillit 2018; [KO115/13](#), parashtrues *Ardian Gjini dhe 11 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktvendim për Papranueshmëri i 14 nëntorit 2013.
94. Tutje, z. Ramadani para Gjykatës theksoi se: *“Pretendimet e parashtruesit se ndryshimet e bëra në procedurë të rregullt parlamentare kanë tejkaluar vëllimin e ndryshimeve të propozuara nga nismëtari, përveçse të pabazuara, janë edhe të dëmshme për rolin dhe funksionin e Legjislativit. Vëllimi presupozon sasi, dhe kufizimi i rolit të deputeteve në vëllimin e ndryshimeve është sa kufizim i funksionit të tyre ligjvënës, po aq edhe absurd. Një kufizim i tillë nuk ka bazë në praktikën parlamentare. Nuk mund të cenohet kapaciteti i ligjvënësit për miratimin e ligjeve, qoftë edhe përmes paraqitjes dhe miratimit të amendamenteve, duke kufizuar masën e ndërhyrjeve, për sa kohë që ato ndryshime janë bërë në procedurë të rregullt dhe miratimi është në përputhje me Kushtetutën e në pajtueshmëri me propozuesin. Nuk ka autoritet që demarkon kufijtë e ndryshimit të një projektligji në procedurë parlamentare, për sa kohë vet sponsorizuesi/propozuesi nuk është kundër atyre ndryshimeve dhe se miratimi është bazuar në Kushtetutë. Parashtruesi i Kërkesës konteston shtimin e numrit të anëtarëve të KPMSHC-se nga 7 në 15 mbi baza procedurale. Parashtruesit, të bindur që rritja e numrit të anëtarëve në KPMSHC është çështje e pastër ligjore dhe nuk përbën çështje kushtetuese, përpigën të kontestojnë ndryshimin përmes kundërshtimit proceduralisht miratimin e ligjit”*.
95. Në komentet e tij para Gjykatës, Z. Ramadani shton se: *“Edhe vet Këshilli në raportet vjetore të punës ka ngritur nevojën shtimit të kapaciteteve, por edhe ngarkesën që ka Këshilli në trajtimin me efikasitet të ankesave. Siç dihet, Këshilli funksionon me panele të veçanta për raste konkrete. Prandaj rritja e numrit të anëtarëve e zgjeron bazën për krijimin e disa paneleve në të njëjtën kohë për të trajtuar secili panel raste konkrete. Kjo padyshim garanton efikasitet, por edhe cilësi në shqyrtimin e rasteve në kohë sa më të arsyeshme. Shto faktin, që Këshilli ka të përcaktuar afatin maksimal brenda të cilit duhet të marrë vendim për një ankesë të parashtruar. Gjithashtu, rritja e numrit të anëtarëve zgjeron mundësinë e përmbushjes së përgjegjësive tjera të Këshillit, si është realizimi i planit të monitorimit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislationit për shërbimin civil”*.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 3 [Barazia para Ligjit]

“1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. [...]”

Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

*“1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.
5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat. [...]”*

Neni 7 [Vlerat]

“1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut. [...]”

Neni 16 [Epërsia e Kushtetutës]

*“1. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.
2. Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta.
3. Republika e Kosovës respekton te drejtën ndërkombëtare,
4. Secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës.”*

Neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare]

*“[...]”
2. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.”*

Neni 22
[Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve
Ndërkombëtare]

“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

[...]”

Neni 24
[Barazia para Ligjit]

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.”

Neni 32
[E Drejta për Mjete Juridike]

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”

Neni 53
[Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Neni 55
[Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]

“1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.

2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.

[...]”

Neni 63
[Parimet e Përgjithshme]

“Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.”

Neni 65
[Kompetencat e Kuvendit]

“Kuvendi i Republikës së Kosovës:

[...]

(9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit;

[...]”

Neni 74
[Ushtrimi i Funkcionit]

“Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.”

Neni 76
[Rregullorja e Punës]

“Rregullat e Punës së Kuvendit miratohen me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij dhe përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së Kuvendit.”

Neni 101
[Shërbimi Civil]

*“1. Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht.
2. Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës.”*

Neni 142
[Agjencitë e Pavarura]

*“1. Agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës.
2. Agjencitë e pavarura kanë buxhetin e tyre, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligj.
3. Secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t’u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligj.”*

RREGULLORJA E KUVENDIT [e miratuar më 28 korrik 2022]

KREU VIII KOMISIONET E KUVENDIT

Neni 41 (Komisioni përgjegjës-raportues)

- “1. Kryetari i Kuvendit, sipas fushëveprimit, cakton njërin nga komisionet, si komision përgjegjës, për të raportuar për projektligjin dhe për dokumentet e tjera të parashtruara në Kuvend.*
- 2. Komisioni përgjegjës-raportues shqyrton projektligjin ose mocionin e dërguar, harton dhe rekomandon amendamente si dhe konstaton amendamentet që bien ndesh me njëri-tjetrin.*
- 3. Në Kuvend, për projektligjin, raporton vetëm Komisioni përgjegjës-raportues.*
- 4. Raporti përmban propozimet e Komisionit përgjegjës-raportues, arsyet dhe opinionet e kundërta, si dhe komentet e komisioneve të tjera, për të cilat Kuvendi vendos në seancë plenare.*
- 5. Kryetari apo raportuesi i Komisionit përgjegjës-raportues, paraqet në Kuvend raportin për shqyrtimin e projektligjit dhe vlerësimin e komisionit.”*

Neni 42 (Komisionet e përhershme dhe komisionet funksionale)

- “1. Kuvendi formon komisione të përhershme dhe komisione funksionale.*
- 2. Kuvendi, miraton formimin e komisioneve, si në paragrafin 1 të këtij neni, dhe ua përcakton fushëveprimin e tyre.*
- 3. Komisionet e përhershme janë komisionet që mbulojnë fushat përkatëse si: buxhet dhe financa, legjislacion, integrim evropian dhe të drejtat dhe interesat e komuniteteve.*
- 4. Komisioni i përhershëm i shqyrton të gjitha projektligjet dhe aktet e tjera, nga fushëveprimi i tij, e që parashtrohen në Kuvend dhe ngarkohet me vendim të Kuvendit.*
- 5. Komisioni funksional i shqyrton projektligjet dhe aktet e tjera vetëm nga fushëveprimi i tij.”*

KREU XI FAZAT E SHQYRTIMIT TË PROJEKTLIGJIT

Neni 77 (Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit)

“Në rastin kur me projektligj propozohet ndryshimi dhe plotësimi i ligjit, amendamentohen vetëm dispozitat e propozuara me projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.”

**PJESA VII
MJETET JURIDIKE ADMINISTRATIVE KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME PËR MJETET JURIDIKE ADMINISTRATIVE**

**Neni 10
(Parimi i jo formalitetit dhe efikasitetit të procedurës administrative)**

“[...]

2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa më të shpejtë dhe sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative.

**Neni 124
(Legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative)**

“1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtari i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë.

2. Përveç nëse caktohet ndryshe me ligj, mjetet juridike administrative mund të ushtrohen për shkak të paligjshmërisë.

3. Mjetet juridike administrative, të rregullta, janë:

3.1. ankesa;

3.2. kundërshtimi administrativ;

4. Mjet juridik administrativ përjashtimor është rihapja e procedurës administrative.

5. Pala mund t'i ushtrojë vetëm një herë mjetet juridike administrative të rregullta për të njëjtën çështje.

6. Shterimi i mjetit juridik administrativ të rregullt, përkatës, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative. Përjashtimisht, mund të ngrihet drejtpërdrejt padi në gjykatë, pa qenë e nevojshme shterimi i mjeteve juridike administrative, në këto raste:

6.1. nuk ekziston organi epror;

6.2. palës së tretë i janë cenuar të drejtat apo interesat juridike nga akti administrativ që zgjidh ankesën, apo

6.3 parashikohet shprehimisht me ligj.”

**Neni 144
(Ekzekutueshmëria e aktit)**

“1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me:

1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar;

1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa;

1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues;

1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji; apo

1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës.

2. Akti i zgjidhjes së ankesës që ndryshon një akt administrativ të ankimuar, bëhet i ekzekutueshëm me njoftimin e palës.

[...]”

LIGJI NR. 03/L-202 PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE [i cili do të shfuqizohet me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative, respektivisht 1 (një) vit pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare – data e publikimit 10 janar 2024]

**Neni 13
(Konflikti administrativ)**

- “1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë.
2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar.”*

**Neni 22
(pa titull)**

- “1. Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe.
2. Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohet, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.
3. Bashkë me kërkesën për shtyrje duhet paraqitur prova, që tregon se padia është parashtruar.
4. Për shtyrje të ekzekutimit, organi kompetent nxjerr vendimin brenda tri (3) ditëve nga data e marrjes së kërkesës për shtyrje.
[...]*”

**Neni 66
(pa titull)**

“Vendimet e gjykatës mund të ekzekutohen atëherë kur bëhen të plotfuqishme dhe të ekzekutueshme”.

LIGJI NR. 08/L-197 PËR ZYRTARËT PUBLIKË

**Neni 5
(Kategoritë e zyrtares/it publik)**

- “[...]
2. Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunëse/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunëse/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë.
[...]*”

Neni 38
(Klasifikimi i pozitave në shërbimin civil)

“2. Pozitat në shërbimin civil ndahen në këto kategori:

2.1. *Kategoria e lartë drejtuese që përfshin: sekretaren/in e përgjithshëm, drejtoren/i në përgjithshëm në agjenci të pavarur dhe rregullatore, drejtoren/in ekzekutiv dhe zëvendësdrejtoren/in e një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme me to;*

2.2. *Kategoria e mesme drejtuese që përfshin pozitën e drejtores/it të departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të;*

2.3. *Kategoria e ulët drejtuese që përfshin pozitën e udhëheqëses/it të divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të;*

2.4. *Kategoria e specialistëve që përfshin profesionistë në fusha që kërkojnë përgatitje specifike; dhe*

2.5. *Kategoria profesionale që përfshin zyrtarët profesional.”*

Neni 27
(E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës)

“[...]

3. *Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil.*

4. *E drejta e ankimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo kandidateje/i në procedurë pranimit në shërbimin civil.*

[...]”

Neni 49
(Emërimi dhe mandati në pozitën e nivelit të lartë drejtues)

“1. *Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë me vendim të arsyetuar përzgjedh kandidaten/in fitues të propozuar sipas paragrafit 8. të nenit 47 brenda një periudhe prej tridhjetë (30) ditësh nga shpallja e fituesve.*

[...]

6. *Vazhdimi i mandatit, në rastin e institucioneve të administratës shtetërore, miratohet nga Qeveria, me propozim të mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë, duke u bazuar në performancën e nëpunëses/it. Në rastin e institucioneve të tjera shtetërore, vendimi për vazhdimin e mandatit merret nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë.*

[...]”

Neni 74
(Lirimi nga Shërbimi Civil)

“[...]

3. *Lirimi nga shërbimi civil bëhet me vendim të:*

3.1. *NjMBNj-së, ku nëpunësja/i ushtron detyrën;*

3.2. *Qeverisë, me propozim të ministres/it përgjegjës për administratën publike, për nëpunësen/i në kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e administratës shtetërore.*

[...]”

Vlerësimi i Pranueshmërisë së Kërkesave

96. Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse kërkesat e parashtruara para Gjykatës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
97. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton se: *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”*.
98. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave i kanë ngritur kërkesat e tyre në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e cfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.”
99. Prandaj, bazuar në të lartcekurat, një kërkesë e parashtruar para Gjykatës sipas paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës duhet të (i) parashtrohet nga së paku 10 (dhjetë) deputetë të Kuvendit; (ii) që kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, për përmbajtjen dhe/ose për procedurën e ndjekur; si dhe (iii) kërkesa duhet të parashtrohet brenda një afatit prej 8 (tetë) ditësh nga dita e miratimit të aktit të kontestuar.
100. Gjykata, në vlerësimin e përmbushjes së kriterit të parë, përkatësisht numrit të nevojshëm të deputetëve të Kuvendit për të parashtruar kërkesat përkatëse, vëren se kërkesat KO232/23 dhe KO233/23 janë parashtruar nga 11 (njëmbëdhjetë) deputetë, prandaj, kërkesat e parashtruesve përmbushin kriterin e përcaktuar përmes fjalisë së parë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës për të vënë në lëvizje Gjykatën.
101. Gjykata, gjithashtu në vlerësimin e përmbushjes së kriterit të dytë, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave kontestojnë Ligjin Nr. 08/L-180 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të miratuar në Kuvend. Ndërsa, sa i përket kriterit të tretë, përkatësisht afatit kohor brenda të cilit duhet të parashtrohet kërkesa përkatëse në Gjykatë, kjo e fundit vëren se të dy kërkesat janë dorëzuar në Gjykatë më 20 tetor 2023, ndërkohë që Ligji i kontestuar është miratuar nga Kuvendi më 12 tetor 2023, që nënkupton se kërkesat janë dorëzuar në Gjykatë brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës.
102. Prandaj, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesave legjitimohen si palë e autorizuar në kuptim të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës për të kontestuar kushtetutshmërinë aktit të kontestuar para Gjykatës, si për nga përmbajtja, ashtu dhe për nga procedura e ndjekur, pasi në rastin konkret, parashtruesit e kërkesave, që të gjithë janë deputetë të legjislaturës së VIII të Kuvendit, prandaj, të njëjtit konsiderohen palë e autorizuar dhe rrjedhimisht, kanë të drejtën e kontestimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi.
103. Përveç kriterëve të lartcekura kushtetuese, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe nenin 42 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, që saktëson parashtrimin e kërkesës në bazë paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton si në vijim:

Nenin 42
(Saktësimi i kërkesës)

“1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.”

104. Gjykata, gjithashtu, i referohet dhe rregullit 72 [Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Rregulli 72

(Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit)

[...]

(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, ndër të tjera, duhet të përmbajë informatat e mëposhtme:

(a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit ose vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendi i Republikës së Kosovës;

(b) dispozitat e Kushtetutës ose të ndonjë akti ose ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

(c) paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti.

(2) Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e ligjit ose vendimit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, regjistri dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën, si dhe autorizimi i personit që i përfaqëson ata para Gjykatës.”

105. Në kontekst të dy dispozitave të lartcekura, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave (i) shënuan emrat dhe nënshkrimet e tyre në kërkesat e tyre përkatëse; (ii) specifikuan aktin e kontestuar; (iii) iu referuan neneve specifike të Kushtetutës, me të cilat ata pretendojnë se dispozitat e Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri; dhe (iv) dorëzuan prova dhe dëshmi për të mbështetur pretendimet e tyre.
106. Rrjedhimisht, marrë parasysh plotësimin e kritereve kushtetuese dhe ligjore përkitazi me pranueshmërinë e kërkesave përkatëse, Gjykata i deklaroi kërkesat e parashtruesve të kërkesave të pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e tyre.

Meritat

107. Gjykata rikujton se çështja kushtetuese që ngërthen kërkesa në fjalë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së (i) procedurës së ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar; dhe (ii) vlerësimi i përmbajtjes së Ligjit të kontestuar në tërësi.
108. Më saktësisht, Gjykata rikujton se: (i) sa i përket procedurës së ndjekur të Ligjit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ndryshimet e miratuara në përmbajtjen e tekstit të ligjit të kontestuar tejkalojnë vëllimin e ndryshimeve të propozimeve në draftin e projektligjit të Qeverisë, pasi që komisioni përkatës

parlamentar, në kundërshtim me nenin 77 (Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit) të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka propozuar edhe amendamente, respektivisht nene të reja; ndërsa (ii) sa i përket përmbajtjes së Ligjit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës, ndër të tjera, pretendojnë se: a) në lidhje me heqjen e përgjegjësisë së KPMSHCK-së për vlerësimin e ankesave dhe ligjshmërisë së procedurave lidhur me marrëdhënien e punës së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, përmes ndryshimeve me Ligjin e kontestuar, KPMSHCK zhveshët nga përgjegjësia kushtetuese për vlerësimin e ankesave dhe ligjshmërisë së procedurave marrëdhënien e punës së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, dhe në këtë mënyrë cenohen nenet 24 [Barazia para ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës; b) përkitazi me dispozitat ligjore për heqjen e imunitetit për anëtarët e KPMSHCK-së, marrja e imunitetit për kryetarin dhe anëtarët e KPMSHCK-së drejtpërdrejtë cenon pavarësinë e kësaj të fundit dhe cenon të drejtat e palëve, dhe është në kundërshtim me nenet 101 [Shërbimi Civil dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës; c) lidhur me mungesën e efektivitetit të vendimit përfundimtar të KPMSHCK-së në rast të inicimit të konfliktit administrativ, përmes ndryshimit të propozuar bëhet jo efektiv vendimi i KPMSHCK-së, në rastet kur inicohet konflikt administrativ ndaj vendimit përkatës në gjykatën kompetente duke cenuar në këtë mënyrë sigurinë juridike.

109. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës, (i) në parim, mbështeten nga KPMSHCK-ja, ndërsa (ii) kundërshtohen nga Kryeministri dhe deputeti i grupit parlamentar të LVV-së, z. Ramadani.
110. Gjykata (i) e ka kufizuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar në fushëveprimin e dispozitave të kontestuara nga parashtruesit e kërkesës dhe atyre të ndërlydhura me to; dhe (ii) përgjatë këtij vlerësimi, ndër të tjera, ka shtjelluar dhe aplikuar parimet e përgjithshme të vendosura nga Gjykata, me theks në: (i) Aktgjykimin e rastit [KO171/18](#); (ii) Aktgjykimin në rastin [KO127/21](#), dhe (iii) Aktgjykimin në rastin [KO216/22 dhe KO220/22](#), me parashtrues *Isak Shabani dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë si dhe Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë*, përkitazi me vlerësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi në rastin KO216/22 dhe KO220/22); si dhe praktikën gjyqësore të GJENDJ-së.
111. Me qëllim të vlerësimit të dispozitave të Ligjit të kontestuar, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të lartpërmendur, respektivisht Aktgjykimin e rastit KO171/18, Aktgjykimin në rastin KO127/21, si dhe Aktgjykimin në rastin KO216/22 dhe KO220/22, cituar më lart, për aq sa aktgjykimet e lartpërmendura janë relevante dhe ndërlydhen me rrethanat e rastit konkret.
112. Për aq sa është relevante, Gjykata rikujton se në Aktgjykimin KO171/18, kishte vlerësuar kushtetutshmërinë e Ligjit bazik për KPMSHCK-në, me ç'rast vlerësoi se KPMSHCK nuk mund të kategorizohet si institucion i pavarur kushtetues sipas Kapitullit XII [Institucionet e Pavarura] të Kushtetutës dhe as si agjenci e pavarur në bazë të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, por si institucion i pavarur i themeluar me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kapitullit VI [Qeveria e Republikës së Kosovës] të Kushtetutës, për qëllim të sigurimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil në Republikën e Kosovës (shih Aktgjykimin e Gjykatës KO171/18, paragrafët 155-159). Gjykata në aktgjykimin e mësipërm, ndër të tjera, konstatoi si në vijim: (i) shprehja “Shërbimi Civil” sipas leximit dhe interpretimit të nenit 101 të Kushtetutës, duhet kuptuar në kontekstin e saj dhe në qëllimin që ka pasur hartuesi, qëllim i cili është i shprehur në nenin 1 të Ligjit të Shërbimit Civil, duke evituar kështu mundësinë e keqinterpretimeve ose të interpretimeve teknike të normës në fjalë; (ii) përkitazi me pretendimet për shkeljen e pavarësisë kushtetuese të Avokatit të Popullit dhe të institucioneve të tjera të pavarura kushtetuese, theksoi që këto të fundit

nuk lirohen nga detyrimi që në rregullore apo në aktet juridike t'i rregullojnë specifikat në lidhje me marrëdhënien e punës, që dallojnë nga normat e përgjithshme të përcaktuara me ligjet e tjera, duke përfshirë edhe Ligjin e kontestuar për KPMSHCK-në në rastin në fjalë; dhe gjatë zbatimit të tij duhet t'u njihet funksioni i tyre, ndër të tjera, në nxjerrjen dhe në aplikimin e rregullave të tyre të brendshme për të mbrojtur pavarësinë e tyre të përcaktuar me Kushtetutë dhe në ligje të veçanta, deri në masën e nevojshme, për të mbrojtur pavarësinë e tyre; si dhe (iii) përkitazi me pretendimet për dhënien e imunitetit anëtarëve të KPMSCHK-së përmes ligjit, vlerësoi se i njëjti është "në pajtueshmëri me Kushtetutën". (shih, Aktgjykimin e Gjykatës KO171/18).

113. Në Aktgjykimin e Gjykatës KO127/21, përgjatë vlerësimit të kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit për shkarkimin e anëtarëve të KPMSHCK-së, Gjykata duke u bazuar në parimet e përgjithshme në lidhje me pavarësinë e KPMSHCK-së, natyrën e vendimeve që ai institucion nxjerr, si dhe në imunitetin funksional të anëtarëve të KPMSHCK-së, konstatoi se të njëjtit nuk mund të thirren në përgjegjësi për mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre, sepse kjo do cenonte pavarësinë e tyre në ushtrimin e kompetencave si anëtarë të KPMSCHK-së, siç garantohet me parimet e mishëruara në paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës. (shih, Aktgjykimin e Gjykatës KO127/21).
114. Po ashtu, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton konstatimin e saj në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO216/22 dhe KO220/22, se kompetenca e Ministrisë përgjegjëse për administratën publike lidhur me "*mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për zyrtarët/in publik*" e përcaktuar në nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2 të nenit 13, të Ligjit të kontestuar për Zyrtarët Publikë në rastin në fjalë është kompetencë e KPMSHCK-së, sipas paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës dhe nenit 6 (Kompetencat e Këshillit), përfshirë edhe nenin 19 (Procedura e mbikëqyrjes së përzgjedhjes së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues) të Ligjit bazik. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi dispozitat e lartcekura nuk ishin në përputhje me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve] dhe paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës dhe si rezultat të njëjtat i shfuqizoi (shih rastin e Gjykatës, KO216/22 dhe KO220/22, paragrafi 254).
115. Në vijim, Gjykata fillimisht do të shqyrtojë në merita: (i) procedurën e ndjekur për miratimin e ligjit të kontestuar, e më pas do të vazhdojë me shqyrtimin (ii) e përmbajtjes së tij për aq sa është kontestuar nga parashtruesit e kërkesës.

I. SA I PËRKET PROCEDURËS SË NDJEKUR PËR MIRATIMIN E LIGJIT TË KONTESTUAR

116. Gjykata rikujton se sa i përket procedurës së ndjekur, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nenet 3, 4 dhe 5 të Ligjit të kontestuar paraqesin ndryshime të reja të miratuara në përmbajtjen e tekstit të Ligjit të kontestuar, të cilat tejkalojnë vëllimin e ndryshimeve të propozimeve në draftin e projektligjit të qeverisë, pasi komisioni përkatës parlamentar, në kundërshtim me nenin 77 (Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit) të Rregullores së Kuvendit ka propozuar edhe amendamente në Ligjin e kontestuar, respektivisht nenet 3, 4 dhe 5 të tij. Më specifikisht, parashtruesit e kërkesës theksojnë se ndryshimet e propozuara pas miratimit të Ligjit të kontestuar nga Qeveria, respektivisht ndryshimet e dala nga Komisioni funksional, rezultojnë në shkeljen e neni 77 i Rregullores së Kuvendit.
117. Në mënyrë që të trajtojë pretendimin e parashtruesve të kërkesës, fillimisht Gjykata rithekson përmbajtjen e neneve 3, 4 dhe 5 të Ligjit të kontestuar, si në vijim:

Neni 3 (pa titull)

“Neni 8 i Ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

Neni 8 (Përbërja e Këshillit)

- 1. Këshilli përbëhet prej pesëmbëdhjete (15) anëtareve që emërohen nga Kuvendi Republikës së Kosovës.*
- 2. Përbërja e Këshillit pasqyron karakterin shumëetnik dhe gjinor të Kosovës. Së paku tre (3) anëtarë emërohen nga komunitetet joshqiptare, dhe se paku katër (4) anëtarë duhet të jenë të gjinisë femërore.”*

Neni 4 (pa titull)

“Neni 9 i Ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

Neni 9 (Kriteret për emërimin e anëtarit të Këshillit)

- 1. Kandidati që aplikon për t'u emëruar anëtar i Këshillit duhet të ketë kualifikimet dhe të plotësojë kriteret në vijim:*
 - 1.1. të jete shtetas i Republikës së Kosovës;*
 - 1.2. të ketë diplomë të fakultetit juridik të vlefshme sipas ligjit në fuqi;*
 - 1.3. të ketë së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave se paku katër (4) vite përvojë pune në shërbimin civil apo zyrtar publik;*
 - 1.4. të jetë njohës i mirë i legjislacionit në fuqi;*
 - 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;*
 - 1.6. ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil me vendim përfundimtar.”*

Neni 5 (pa titull)

“Neni 10 i Ligjit bazik, paragrafët 4. dhe 5. ndryshohen si në vijim:

- 4. Për zhvillimin e procedurave për emërimin e anëtareve të Këshillit, Komisioni funksional përkatës ka kompetenca si në vijim:*
 - 4.1. shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve;*
 - 4.2. përgatitjen e listës së shkurtër të kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara ligjore;*
 - 4.3. intervistimin dhe vlerësimin e kandidateve, si dhe*
 - 4.4. përgatitjen e rekomandimit për kandidatët e suksesshëm.*
- 5. Brenda periudhës kohore prej njëzetënjë (21) ditësh pas mbylljes së shpalljes publike, Komisioni funksional përkatës, përfundon procedurën e përzgjedhjes dhe i rekomandon Kuvendit të Kosovës dy (2) kandidate të cilët janë vlerësuar me më së shumti pikë, për çdo vend të lirë të punës në Këshill.”*

118. Gjykata vëren se përmbajtja e neneve 3, 4 dhe 5 të Ligjit të kontestuar ka të bëjë me ndryshimin e dispozitave përkatëse të Ligjit bazik në lidhje (i) me numrin dhe përbërjen e anëtarëve të KPMSHCK-së, (ii) kriteret për emërimin e anëtarëve të tij si dhe (iii) ndryshimin e procedurës për emërimin e anëtarëve të këtij institucioni.

119. Megjithatë, Gjykata edhe një herë rikujton se parashtruesit e kërkesës këtë pretendim e ndërlidhin vetëm me procedurën e ndjekur nga Kuvendi për miratimin e Ligjit të kontestuar, duke potencuar se janë shkelur rregullat procedurale të Kuvendit, respektivisht neni 77 (Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit) i Rregullores së Kuvendit.
120. Bazuar në pretendimet e parashtruesve të kërkesës, Gjykata rikujton përmbajtjen e nenit 77 të Rregullores së Kuvendit, i cili përcakton si në vijim: *“Në rastin kur me projektligj propozohet ndryshimi dhe plotësimi i ligjit, amendamentohen vetëm dispozitat e propozuara me projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit”*.
121. Në lidhje me pretendimin për shkeljen e dispozitave të Rregullores së Kuvendit dhe rrethanave përkatëse të rastit, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore, respektivisht Aktvendimit për Papranueshmëri në rastin e saj KO120/16, parashtrues *Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës* lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, ku parashtruesit e kërkesës, ndër të tjera, kishin ngritur pretendimin për shkeljen e neneve 56 (Shqyrtimi i parë i një projektligji) dhe 57 (Shqyrtimi i projektligjit në komisione) të Rregullores së Kuvendit që ishte në fuqi asokohe. Në lidhje me këtë, Gjykata kishte vlerësuar se fushëveprimi i juridiksionit të saj sipas paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës është që të shqyrtojë pajtueshmërinë me rregullat procedurale të përfshira në Kushtetutë, të procedurës së ndjekur në Kuvend, dhe kishte konsideruar se parashtruesit nuk kishin dëshmuar se si ky pretendim, që ka të bëjë me Rregulloren e Kuvendit, paraqet shkelje kushtetuese, të cilat, Gjykata do të kishte kompetencë që t'i shqyrtonte (shih rastet e Gjykatës [KO120/16](#), parashtrues *Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, Aktvendim për Papranueshmëri i 20 janarit 2017, paragrafët 93-94 dhe *mutatis mutandis*, [KO94/16](#), Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Nr. 05/L-010, Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2016, paragrafi 53).
122. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendimin për procedurën e ndjekur nga Kuvendi për miratimin e Ligjit të kontestuar, për të cilën pretendojnë se ka rezultuar në shkeljen e rregullave procedurale të Kuvendit, respektivisht nenin 77 (Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit) të Rregullores së Kuvendit, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesës në kërkesat e tyre nuk kanë argumentuar se pse shkelja e nenit 77 të Rregullores së Kuvendit përbën shkelje kushtetuese. Për më tepër, ata, këtë pretendim nuk e kanë ndërlidhur me shkeljen e ndonjë neni të Kushtetutës.
123. Gjykata nga si më sipër, konstaton se mënyra se si parashtruesit e kërkesës e kanë ngritur pretendimin për shkeljen e procedurës së ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar nga parashtruesit e kërkesës, përkatësisht në kontekst të shkeljes së nenit 77 të Rregullores së Kuvendit duke mos e ndërlidhur në mënyrë specifike me ndonjë nen të Kushtetutës, nuk ngritë çështje në nivel kushtetues.
124. Rrjedhimisht, Gjykata nuk do ta shqyrtojë tutje këtë pretendim të parashtruesve të kërkesës.

II. SA I PËRKET PËRMBAJTJES SË LIGJIT TË KONTESTUAR

125. Gjykata fillimisht rikujton se 22 (njëzet e dy) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përmes dy (2) kërkesave të ndara, bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 të

Kushtetutës, kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së të Ligjit të kontestuar në tërësi, për të cilat nene pretendojnë se nuk janë në përputhshmëri me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], 101 [Shërbimi Civil] si dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.

126. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se të gjitha dispozitat e Ligjit të kontestuar në tërësi janë kundërkushtetuese, ndër të tjera, për arsyet në vijim:

(i) Heqja e përgjegjësisë së KPMSHCK-së për vlerësimin e ankesave dhe ligjshmërisë së procedurave lidhur me marrëdhënien e punës së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues, përmes ndryshimeve me Ligjin e kontestuar, zhvesh KPMSHCK-në nga përgjegjësia kushtetuese për vlerësimin e ankesave dhe ligjshmërisë së procedurave marrëdhënien e punës së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, dhe në këtë mënyrë cenohen nenet: 24 [Barazia para ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës;

(ii) Heqja e imunitetit për anëtarët e KPMSHCK-së, cenon drejtpërdrejtë pavarësinë e kësaj të fundit dhe cenon të drejtat e palëve, si dhe është në kundërshtim me nenet: 101 [Shërbimi Civil] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës;

(iii) Mungesa e efektivitetit të vendimit përfundimtar të KPMSHCK-së në rast të inicimit të konfliktit administrativ, përmes ndryshimit të propozuar, e bën jo efektiv vendimin e KPMSHCK-së, në rastet kur inicohet konflikt administrativ ndaj vendimit përkatës në gjykatën kompetente duke cenuar në këtë mënyrë sigurinë juridike dhe shkelur nenet: 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.

127. Këto pretendime, në esencë dhe sipas sqarimeve të dhëna në pjesën që ndërlidhet me pretendimet dhe përgjigjet e palëve të interesuara para Gjykatës, në parim, mbështeten edhe nga KPMSHCK-ja, ndërsa kundër-argumentohen nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe deputeti i grupit parlamentar të LVV-së.

128. Me qëllim të vlerësimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, Gjykata lidhur me secilin nen të kontestuar, fillimisht do të paraqesë: (a) pretendimet dhe komentet e palëve; (b) parimet e përgjithshme të vendosura nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe/ose GJEDNJ-së; dhe më pas, Gjykata do të vazhdojë me: (c) aplikimin e atyre parimeve në nenet e kontestuara të Ligjit të kontestuar.

A. Përkitazi me pretendimet në lidhje me nenet 2, 7 dhe 8 të Ligjit të kontestuar, të cilët plotësojnë dhe ndryshojnë nenet 6, 16 dhe 19 të Ligjit bazik

129. Fillimisht dhe për qëllime të vlerësimit të kushtetutshmërisë së neneve 2, 7 dhe 8 (pa tituj) të Ligjit të kontestuar, të cilët plotësojnë dhe ndryshojnë nenet 6 (Funkcionet e Këshillit), 16 (Shqyrtimi i ankesave) dhe 19 (Procedura e mbikëqyrjes së përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues) të Ligjit bazik, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet parashtruesve të kërkesës përkitazi me shkeljen e neneve 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës. Më specifikisht, gjatë vlerësimit të këtyre pretendimeve, Gjykatave do të paraqesë fillimisht: (a) thelbin e pretendimeve, komenteve dhe përgjigjeve përkatëse; (b) parimet e përgjithshme përkatëse; si dhe pas (c) vlerësimin e gjykatës përkitazi me pretendimet specifike.

a. Thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe komenteve të palëve kundërshtare dhe të interesuara

130. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ndryshimet ligjore lidhur me kompetencën e KPMSHCK-së për vlerësimin e ankesave dhe ligjshmërisë së procedurave lidhur me marrëdhënien e punës së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, shkelin nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.
131. Më specifikisht, Gjykata rikujton se në kontekst të shkeljes së nenit 101 të Kushtetutës, ata theksojnë se me nenin 6 të Ligjit bazik për KPMSHCK-në, janë të përcaktuara funksionet e KPMSHCK-së, duke specifikuar se ky i fundit merr vendime për ankesat e të gjithë nëpunësve civil, ndërsa përmes ndryshimeve të përcaktuara në nenet 2, 7 dhe 8 të Ligjit të kontestuar, ky i fundit sipas tyre, *“[...] e zhvesh nga përgjegjësia kushtetuese për vlerësimin e ankesave dhe ligjshmërisë së procedurave (për të cilat vendos Qeveria) lidhur me marrëdhënien e punës së nivelit të lartë drejtues të zyrtarëve publik, dhe në këtë mënyrë e ngushton dhe zvogëlon këtë funksion”*. Për më tepër, Gjykata vë në dukje parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se kjo kufizon kompetencat dhe përgjegjësitë e KPMSHCK-së, të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj, dhe theksojnë se cenohet kompetenca e këtij institucioni *“që të mbikëqyrë gjithë shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe jo vetëm disa kategorive të shërbimit civil”*.
132. Përkitazi me pretendimin për cenimin e nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, Gjykata rithekson se parashtruesit e kërkesës duke u mbështetur në një nga aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese, pa specifikuar të njëjtin, theksojnë si në vijim: *“[...] trajtimi i pabarabartë i shërbyesve civil në raport me kompetencat e Këshillit për mbikëqyrje të përzgjedhjes së shërbyesve civil, i përcaktuar me nenin 6 paragrafi 1.2 i Ligjit të kontestuar nuk është në pajtueshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës. Krahas shkeljes kushtetuese, reflektimi i kësaj dispozite në praktikë paraqet një potencial ekstremisht të lartë për cenimin e të drejtave të njeriut, influencë politike në rekrutimin e këtyre pozitave dhe dëmtim të buxhetit”*.
133. Ndërsa, në kontekst të shkeljes së nenit 32 [E Drejta për Mjet Juridik] të Kushtetutës, Gjykata rikujton edhe njëherë pretendimin e parashtruesve të kërkesës se *“[...] përcaktimi i KPMSHCK si institucion kushtetues për të mbrojtur rregullat mbi shërbimin civil ka për qëllim, krahas mbrojtjes së standardeve dhe parimeve në shërbimin civil, edhe garantimin e mjeteve juridike efektive për subjektet të cilët janë pjesë e procedurave ku zbatohen rregullat e shërbimit civil”* dhe se kjo në thelb, jo vetëm që pakëson kompetencat e vet institucionit, por shihet edhe si *“mohim i të drejtës në ushtrimin e mjetit juridik për një pjesë të shërbimit civil në të drejtat e tyre kushtetuese”*.
134. Gjykata vë në pah edhe komentet e KPMSHCK-së, të cilët duke u bazuar në nenin 101 të Kushtetutës si dhe në nenin 5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë konsiderojnë se kanë ka mandat për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të shërbimit Civil në të gjitha institucionet e administratës publike ku ka të punësuar nëpunës Civil dhe se në përmbushje të mandatit të tyre kushtetues ushtrojnë funksionin e shqyrtimit dhe vendosjes se ankesave për të gjithë nëpunësit civil, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e drejtuesit të lartë, nëse pretendohet se janë cenuar të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, pa marr parasysh nëse objekt i kontestit është vendimi i Qeverisë apo ndonjë vendim i organeve tjera të administratës publike dhe se në këtë kuptim neni 2 i Ligjit të kontestuar, përmes ndryshimeve të propozuara krijon situatë të trajtimit të pabarabartë të nëpunësve civil në raport me ushtrimin e mjeteve juridike efektive dhe

si e tillë kjo dispozitë nuk është në pajtueshmëri as me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

135. Gjykata nënvizon edhe komentet e Kryeministrit, i cili mbështetet në Komentarin e Kushtetutës ku shtjellon nenin 32 të Kushtetutës, nen që sipas tij, karakterizohet me parimin e dyshkallësisë së gjykimit si element i domosdoshëm, dhe në këtë drejtim thekson se me: “[...] ndryshimet e propozuara në Ligjin e kontestuar, palëve ju sigurohet pavarësi e pakontestuar e tribunalit/ gjykatës që vendos për rastin; procedura e qartë që padiskutueshëm lejon të dëgjuarit e të dy palëve (inaudita altera parte), dhe vendimmarrje e zbatueshme sipas fuqisë së autoritetit gjyqësor”. Kryeministri në thelb pretendon se kompetenca e KPMSHCK-së për të vlerësuar vendimmarrjen e Qeverisë si “mekanizmin më të rëndësishëm të shtetit” në lidhje me marrëdhënien e punës së zyrtarëve publikë të nivelit të lartë, kufizon pushtetin ekzekutiv dhe se në këtë kontekst, i njëjti nuk mund të mbivendoset nga një trupë kuazi gjyqësore si KPMSHCK
136. Në fund, Gjykata rithekson se z. Ramadani, deputet i grupit parlamentar i LVV, në esencë, konsideron se KPMSHC si një institucion kuazi gjyqësor në asnjë mënyrë nuk mund të veshët pa kurrfarë baze se parashikimi kushtetues me autorizime për të kontrolluar vendimet e ekzekutivit si institucion kolegjal, pushtet i pavarur dhe me kompetenca të përcaktuara qartë e shprehimisht me Kushtetutë dhe se Qeveria si bartës i pushtetit ekzekutiv në kuptimin e vendimmarrjes i nënshtrohet për arsye e për nga natyra të ndryshme, vetëm Kuvendit të Republikës të Kosovës, gjyqësorit dhe Gjykatës Kushtetuese, por në asnjë mënyrë këto vendime nuk mund të jenë objekt i trajtimit nga një institucion siç është KPMSHCK, kur bëhet fjalë për shkarkimin e zyrtarëve të lartë civil përmes votës në Qeveri.

b. Parimet themelore që burojnë nga praktika e GJEDNJ-së dhe Gjykatës në lidhje me barazinë para ligjit, të drejtën për mjet juridik si dhe kompetencën kushtetuese të KPMSHCK-së, të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës

137. Së pari, në lidhje me kompetencën kushtetuese të KPMSHCK-së, Gjykata në praktikën e saj ka theksuar që KPMSCHK është institucion i themeluar me Kushtetutë, e cila i ka atribuuar asaj (i) cilësimin e institucionit “të pavarur” në lidhje me (ii) ushtrimin e funksionit të tij kushtetues, përkatësisht, “sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil”. Më saktësisht, paragrafi 2 i nenit 101 të Kushtetutës, (i) përcakton saktë emërtimin e KPMSCHK-së si i “pavarur”; dhe (ii) këtë “pavarësi” ia ka atribuuar me qëllim të “sigurimit të respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil”. Për pasojë, qëllimi i dispozitës përkatëse kushtetuese reflekton pavarësinë institucionale të KPMSHCK-së me qëllim të ushtrimit të funksionit të tij për “sigurimin e respektimit të parimeve dhe rregullave që rregullojnë shërbimin civil” (shih rastin e Gjykatës, KO127/21, cituar më lart, paragrafi 83).
138. Për më tepër, Gjykata në praktikën e saj, kualifikoi KPMSHCK-në si institucion “kuazi gjyqësor”, përkatësisht si tribunal përkitazi me zgjidhjen e kontesteve që burojnë nga shërbimi civil (emërtimi “tribunal” gjen përdorim më të gjerë në diskursin e GJEDNJ-së). Rrjedhimisht, KPMSHCK gëzon prerogativat e një “gjykate” pikërisht për shkak të pavarësisë nga ekzekutivi dhe legjislativi dhe kualifikohet si institucion që ka juridiksion të plotë që të nxjerr vendime të detyrueshme, në lidhje me konfliktet në mes të nëpunësve civil ose kandidatëve për nëpunës civil në njërin anë, dhe institucioneve që kanë të punësuar nëpunësit civil, në anën tjetër (shih rastet e Gjykatës, KO171/18, paragrafi 165 dhe KO127/21, cituar më lart, paragrafi 86).

139. Në këtë kontekst, Gjykata kishte theksuar po ashtu që ligjshmëria e vendimeve të KPMSHCK-së i nënshtrohet më tej kontrollit të pushtetit gjyqësor përmes inicimit të konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda kushteve dhe afateve të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Konfliktin Administrativ, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 22 (Inicimi i konfliktit administrativ) të Ligjit bazik. Rrjedhimisht, kontrolli, përkatësisht vlerësimi i ligjshmërisë së vendimeve të KPMSHCK-së, është kompetencë e pushtetit gjyqësor (shih rastin e Gjykatës, KO127/21, cituar më lart, paragrafi 87).
140. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika e GJEDNJ-së dhe Gjykatës përkitazi me (i) parimin e barazisë para ligjit; dhe (ii) të drejtën për mjet juridik, për të vazhduar me aplikimin e të njëjtave në rastin konkret.
- (i) Parimet e përgjithshme lidhur me barazinë para ligjit
141. Përkitazi me parimin e barazisë para ligjit, për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se neni 14 (Ndalimi i diskriminimit) i KEDNJ-së garanton mbrojtjen ndaj diskriminimit në gëzimin e të drejtave të garantuara me KEDNJ. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, parimi i ndalimit të diskriminimit është i natyrës “*fundamentale*” dhe ndërlidh KEDNJ-në me sundimin e ligjit dhe vlerat e tolerancës dhe paqes sociale (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së [S.A.S. kundër Francës](#), nr. 43835/11, Aktgjykim i 1 korrikut 2014, paragrafi 149). Mbrojtja kundër diskriminimit e përcaktuar në nenin 14 të KEDNJ-së, më tej është kompletuar dhe përforcuar edhe përmes nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, i cili ndalon diskriminimin në mënyrë më të përgjithësuar, përtej të drejtave të garantuara me KEDNJ, pra edhe në gëzimin e çdo të drejte të përcaktuar me ligj (shih, gjithashtu dhe ndër të tjera, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO93/21](#), parashtrues, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 Deputetë të Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 28 dhjetorit 2021, paragrafi 287).
142. Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, vëren se kjo e fundit, në parim, ka konstatuar se neni 14 i KEDNJ-së, nuk ka ekzistencë autonome, por në mënyrë që ky nen të jetë i aplikueshëm duhet që të ndërlidhet edhe me pretendimin e një shkeljeje të një të drejte apo lirie tjetër të garantuar me dispozitat e KEDNJ-së. Megjithatë, në praktikën e saj gjyqësore GJEDNJ ka theksuar se ndalimi i diskriminimit aplikohet edhe përkitazi me të drejtat e tjera shtesë, të cilat bien në fushëveprimin e përgjithshëm të njërit nga nenet e KEDNJ-së, për të cilat të drejta, shtetet në mënyrë vullnetare kanë vendosur që të garantojnë mbrojtjen e tyre (shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, [Fábián kundër Hungarisë](#), nr. 78117/13, Aktgjykim i 5 shtatorit 2017, paragrafi 112; [Biao kundër Danimarkës](#), nr. 38590/10, Aktgjykim i 24 majit 2016, paragrafi 88; [İzzettin Doğan dhe të tjerët kundër Turqisë](#), nr. 62649/10, Aktgjykim i 26 prillit 2016, paragrafi 158; dhe [Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 42184/05, Aktgjykim i 10 marsit 2010, paragrafi 63). Thënë këtë, neni 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) i Protokollit Nr. 12 të KEDNJ-së ka zgjeruar fushëveprimin e mbrojtjes nga diskriminimi në nivel të GJEDNJ-së, duke përcaktuar një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit, dhe rrjedhimisht duke përfshirë edhe të drejtat e përcaktuara me ligj.
143. Gjykata në Aktgjykimin e saj në rastet KO100/22 dhe KO101/22, theksoi se praktika e saj gjyqësore në kontekst të nenit 24 të Kushtetutës, përfshirë në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 12 të KEDNJ-së, është e konsoliduar bazuar në praktikën relevante të GJEDNJ-së dhe është sqaruar, ndër të tjera, përmes Aktgjykimeve të Gjykatës në rastet (i) [KO01/17](#), parashtrues *Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit*, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Aktgjykim i 28 marsit 2017; (ii) [KO157/18](#), parashtrues *Gjykata Supreme*,

vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafit 1.7 të Ligjit Nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 13 marsit 2019; (iii) [KO93/21](#); dhe (iv) [KO190/19](#), parashtrues *Gjykata Supreme*, vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 8, paragrafit 2, të Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti lidhur me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve, Aktgjykim i 30 dhjetorit 2022 (shih rastet e Gjykatës, KO100/22 dhe KO101/22, cituar më lart, paragrafi 332)

144. Përmes këtyre Aktgjykimeve është sqaruar që testi që aplikohet për të konstatuar nëse një akt i nxjerrë nga një autoritet publik është në kundërshtim me të drejtën për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, përfshin fillimisht vlerësimin (i) nëse ka pasur “*dallim në trajtim*” të personave në situata “*analoge ose situata relativisht të ngjashme*” ose dështim për të trajtuar persona ndryshe në situata relativisht të ndryshme; dhe nëse ky është rasti, (ii) vlerësimin nëse një dallim i tillë ose mungesë e dallimit është e justifikuar në mënyrë objektive, përkatësisht nëse kufizimi është “*i përcaktuar në ligj*”, ka ndjekur “*një qëllim legjitim*” dhe masa e ndërmarrë ka qenë “*proporcionale*” me qëllimin që është synuar të realizohet (shih rastet e Gjykatës, KO100/22 dhe KO101/22, cituar më lart, paragrafi 333).

(ii) Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën për mjet juridik

145. Në lidhje me të drejtën për mjete juridike, kjo e drejtë plotësohet dhe duhet të lexohet ngushtë dhe në lidhshmëri me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, si dhe me praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së. Neni 13 i KEDNJ-së garanton të drejtën për një “*zgjidhje efektive*” në rast të shkeljes së të drejtave të garantuara me KEDNJ nga një autoritet publik (shih rastin e Gjykatës, [KI48/18](#), parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, Aktgjykim i 23 janarit 2019, paragrafi 197).
146. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim, qëllimi i nenit 13 të KEDNJ-së është të ofrojë një mjet juridik përmes të cilit individët mund të arrijnë një zgjidhje efektive për shkeljet e të drejtave të tyre të garantuara përmes KEDNJ-së në nivelin vendor, përpara se të vihet në lëvizje makineria e ankesave para GJEDNJ-së (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, [Kudla kundër Polonisë](#), nr. 30210/96, Aktgjykim i 26 tetorit 2000, paragrafi 152). Në të kundërtën, mungesa e ekzistencës së mjeteve juridike përkatëse, do të dobësonte dhe do t'i bënte iluzore garancitë e nenit 13 të KEDNJ-së, ndërsa kjo e fundit, siç është theksuar tashmë, nuk synon të garantojë të drejta “*teorike ose iluzore*”, por të drejta që janë “*praktike dhe efektive*” (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, [Scordino kundër Italisë \(nr. 1\)](#), nr. 36813/97, Aktgjykim i 29 marsit 2006, paragrafi 192).
147. Për më tepër, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, kjo praktikë gjyqësore lidhur me interpretimin e nenit 13 të KEDNJ-së, thekson se kur një individ ka një pretendim “*të argumentueshëm*” se është viktimë e një shkeljeje të të drejtave të përcaktuara nga KEDNJ, ai/ajo duhet të ketë një mjet juridik përpara një “*autoriteti kombëtar*”, dhe i cili i mundëson vendosjen mbi thelbin e pretendimit përkatës por dhe, nëse është e përshtatshme, t'i mundëson realizimin e korrigjimit të duhur (shih rastin e Gjykatës [KI56/18](#), parashtrues *Ahmet Frangu*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafi 134).

c. Vlerësimi i Gjykatës

148. Në vijim të pretendimeve të lartcekura të parashtrueseve të kërkesës, Gjykata konsideron se në thelb, parashtruesit ngritin dy çështje kushtetuese, përkatësisht (i)

kompetencën kushtetuese të KPMSHCK-së për të siguruar respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil në Republikën e Kosovës; dhe (ii) barazinë para ligjit në lidhje me të drejtën në mjet juridik në kontekst të kandidatëve për dhe nëpunësive civilë në pozitat e larta drejtuese dhe kategorive tjera të shërbimit civil.

149. Me qëllim të vlerësimit të pretendimeve të lartcekura, Gjykata fillimisht i referohet edhe një herë përmbajtjes së nenit 2 (pa titull) të Ligjit të kontestuar, i cili plotëson dhe ndryshon nenin 6 (Funksionet e Këshillit) të Ligjit bazik, që përcakton si në vijim:

“Te neni 6 i ligjit bazik, shtohet paragrafi 2. si në vijim:

2. Pavarësisht paragrafit 1. nën-paragrafit 1.1. të këtij neni, KPMSHCK nuk ka kompetencë të vendosë për ankesat kundër vendimit të Qeverisë për nëpunësit civilë në pozitat e larta drejtuese. Kundër këtyre vendimeve, pala ka të drejtë të hap konflikt administrativ në gjykatën kompetente në pajtim me ligjin përkatës për konfliktet administrative.”

150. Gjykata rikujton se neni 6 i Ligjit bazik përcakton se:

“1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore:

1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil;

1.2. mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil;

1.3. monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.”

151. Gjykata vëren se neni 2 i Ligjit të kontestuar ndryshon nenin 6 të Ligjit bazik, ashtu që ndryshon kompetencën e KPMSHCK-së, duke ia hequr asaj të drejtën e shqyrtimit të ankesave kundër vendimit të Qeverisë për nëpunësit civilë në pozitat e larta drejtuese. Gjykata po ashtu thekson se ligjvënësi në këtë drejtim ia ka lënë mundësinë palës që të hap konflikt administrativ drejtpërdrejt kundër këtij vendimi në gjykatën kompetente. Në këtë kontekst, Gjykata vë theksin në togfjalëshin “kundër vendimit të Qeverisë”, i cili kufizon ndryshimin e propozuar vetëm kundër vendimmarrjes së Qeverisë.

152. Gjykata po ashtu iu referohet neneve 7 dhe 8 (pa tituj) të Ligjit të kontestuar, të cilët ndryshojnë nenet 16 (Shqyrtimi i ankesave) dhe 19 (Procedura e mbikëqyrjes së përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues) të Ligjit bazik, si në vijim:

Neni 7

“1. Tek neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 1., në fjalinë e parë, pas togfjalëshit: "apo kandidati për praninë në shërbim civil", shtohen fjalët: "në përjashtim të kandidateve të suksesshëm të propozuar për pozita të larta drejtuese".

2. Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 6. fshihen fjalët "të nivelit të lartë drejtues" nga teksti i ligjit bazik.”

Neni 8

“Tek neni 19 i ligjit bazik, në secilin paragraf apo nën-paragraf të këtij neni, fshihen fjalët "të nivelit të lartë drejtues".”

153. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu vë në pah dispozitat e Ligjit bazik, që ndryshohen përmes neneve të lartcekura të Ligjit të kontestuar.

**Neni 16
(Shqyrtimi i ankesave)**

“1. Nëpunësi civil, apo kandidati për pranim në shërbimin civil i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshill, lidhur me pretendimin për shkeljen e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

[...]

6. Anëtari i Këshillit i cili ka mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes për emërimet e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, nuk ka të drejtë të marrë pjesë në procedurën e shqyrtimit të ankesës lidhur me të njëjtën procedurë.”

**Neni 19
(Procedura e mbikëqyrjes së përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues)**

“1. Këshilli mbikëqyrë të gjitha procedurat e përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues.

[...]

6. Këshilli është i obliguar që të nxjerr vendim për procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të dosjes complete nga organi i punësimit.

7. Nëse zhvillimi i procedurës për përzgjedhjen e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, bëhet pa njoftim të Këshillit për pjesëmarrje në mbikëqyrje, procedura konsiderohet e pavlefshme dhe Këshilli sipas detyrës zyrtare nxjerr vendim për anulimin e procedurës.

8. Vendimi i Këshillit për procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, është vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe kundër këtij vendimi palët në procedurë kanë të drejtë të iniciojnë konflikt administrativ, në pajtim me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ.”

154. Gjykata vëren se Ligji i kontestuar përmes neneve 7 dhe 8 të Ligjit të kontestuar ka fshirë referencat e togfjalëshit “*nivelin e lartë drejtues*” në nenet 16 dhe 19 të Ligjit bazik, të cilat nene kanë rregulluar procedurat e ankesës, respektivisht, të mbikëqyrjes së procedurës së përzgjedhjes dhe vendosjes në lidhje me ankesat e të gjithë nëpunësve civilë, përfshirë ata të nivelit të lartë drejtues nga ana e KPMSHCK-së.
155. Thënë këtë, Gjykata vëren se ligjvënësi në thelb, përmes neneve 2, 7 dhe 8 (pa tituj) të Ligjit të kontestuar, respektivisht, ndryshimit dhe plotësimit të neneve 6 (Funkcionet e Këshillit), 16 (Shqyrtimi i ankesave) dhe 19 (Procedura e mbikëqyrjes së përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues) të Ligjit bazik, ka: (i) shfuqizuar shprehimisht kompetencën e KPMSHCK-së për shqyrtimin e ankesave kundër vendimit të Qeverisë për nëpunësit civilë në pozitat e larta drejtuese përmes nenit 2 të Ligjit të kontestuar, por edhe të gjithë kandidatëve për dhe nëpunësve të tjerë civilë të nivelit të lartë drejtues përmes nenit 7 të Ligjit të kontestuar; si dhe (ii) ka shfuqizuar kompetencën e KPMSHCK-së që të mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 19 të Ligjit bazik përmes nenit 8 të Ligjit të kontestuar.
156. Në vijim, Gjykata do të shqyrtojë së bashku pretendimet e parashtruesve të kërkesës për (i) cenimin e kompetencës kushtetuese të KPMSHCK-së për të siguruar respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil në Republikën e Kosovës, të

- garantuar me nenin 101 të Kushtetutës; si dhe (ii) shkeljen e të drejtës për mosdiskriminim të nëpunësve të nivelit të lartë drejtues në raport me kategoritë e tjera të shërbimit civil, të garantuar përmes nenit 24 të Kushtetutës, në lidhje me të drejtën e tyre për mjet juridik, të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës, në pajtim me parimet e lartcekura të Gjykatës dhe GJEDNJ-së.
157. Fillimisht, bazuar në parimet e lartcekura për kompetencën e KPMSHCK-së në lidhje me *“sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil”*, të garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 101 [Shërbimi Civil] i Kushtetutës dhe praktikën gjyqësore të saj, Gjykata sqaron se KPMSHCK ka për kompetencë mbikëqyrjen e shërbimit civil, e cila kompetencë përfshin: (i) mbikëqyrjen e procedurës së përzgjedhjes dhe vendosjes nëse emërimet e nëpunësve civilë janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil, si dhe (ii) vlerësimin e ankesave të tyre në procedurë administrative (shih rastin e Gjykatës KO216/22 dhe KO220/22, cituar më lart, paragrafi 254). Në këtë kontekst, Gjykata nënvizon edhe parimet e lartcekura, që burojnë nga praktika e Gjykatës në lidhje me natyrën *“kuazi gjyqësore”* të KPMSHCK-së, përkatësisht të tribunalit përkitazi me zgjidhjen e kontesteve që burojnë nga shërbimi civil, dhe si institucion që ka juridiksion të plotë që të nxjerr vendime të detyrueshme, në lidhje me konfliktet në mes të nëpunësve civilë ose kandidatëve për nëpunës civilë.
158. Duke pasur parasysh ndryshimet e propozuara në Ligjin e kontestuar, për efekt sqarimi në lidhje me kategoritë e shërbimit civil, Gjykata vë në dukje dispozitat ligjore të LPZ-së që kategorizojnë pozitat në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, më saktësisht paragrafin 2 të nenit 38 (Klasifikimi i pozitave në Shërbimin Civil) të LZP-së, nga ku rezulton se pozitat në shërbimin civil ndahen në kategoritë në vijim: (i) kategoria e lartë drejtuese që përfshin: sekretaren/in e përgjithshëm, drejtoresh/in në përgjithshëm në agjenci të pavarur dhe rregullatore, drejtoresh/in ekzekutiv dhe zëvendësdrejtoresh/in e një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme me to; (ii) kategoria e mesme drejtuese që përfshin pozitën e drejtoresh/it të departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; (iii) kategoria e ulët drejtuese që përfshin pozitën e udhëheqëses/it të divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; (iv) kategoria e specialistëve që përfshin profesionistë në fusha që kërkojnë përgatitje specifike; dhe (v) kategoria profesionale që përfshin zyrtarët profesional.
159. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se edhe gjuha e përdorur në Kushtetutë por edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës i referohet shërbimit civil, pa ndarje të kategorive të saj, si dhe Kushtetuta ka përcaktuar një institucion për mbikëqyrjen e shërbimit civil siç është KPMSHCK, dhe jo institucione të tjera, duke mos fragmentarizuar kompetencën e tillë. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, edhe LZP e ndan shërbimin civil në kategori të caktuara, siç është cekur më lart, megjithatë, kudo në ligj kur i referohet shërbimit civil, e konsideron të njëjtin si unik, duke përfshirë edhe përkufizimin e përgjithshëm të nëpunësit civil në paragrafin 2 të nenit 5 (Kategoritë e zyrtarit/es publik) të LZP-së, ku i njëjti definohet si në vijim: *“2. Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunës/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunës/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë”*.

160. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se KPMSHCK, si institucion i themeluar me Kushtetutë, ka për kompetencë sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil për të gjitha kategoritë e tij (shih rastin e Gjykatës, KO171/18, cituar më lart).
161. Në vijim, në kontekst të pretendimeve për shkeljen e të drejtës për barazi para ligjit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë në raport me kategoritë e tjera të shërbimit civil në ndërlidhje me të drejtën e tyre për të përdorur mjetin juridik të ankesës, Gjykata duke u bazuar në praktikën gjyqësore të lartpërmendur të saj, sqaron se testi që aplikohet për të konstatuar nëse një akt i nxjerrë nga një autoritet publik është në kundërshtim me të drejtën për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës përfshin fillimisht vlerësimin nëse ka pasur (i) *“dallim në trajtim”* të personave në situata *“analoge ose situata relativisht të ngjashme”* ose dështim për të trajtuar persona ndryshe në situata relativisht të ndryshme; dhe nëse ky është rasti, (ii) vlerësimin nëse një dallim i tillë ose mungesë e dallimit është e justifikuar në mënyrë objektive, përkatësisht nëse kufizimi është (a) *“i përcaktuar në ligj”*, ka ndjekur (b) *“një qëllim legjitim”* dhe (c) masa e ndërmarrë ka qenë *“proporcionale”* me qëllimin që është synuar të realizohet. Po ashtu, duke qenë se nga vet praktika gjyqësore e saj rezulton se e drejta për barazi ligjore nuk ka ekzistencë autonome, por në mënyrë që ky nen të jetë i aplikueshëm duhet që të ndërlidhet edhe me pretendimin e një shkeljeje të një të drejte apo lirie tjetër të garantuar me dispozitat e KEDNJ-së, Gjykata do të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret plotësojnë kriteret e lartcekura në ndërlidhje me të drejtën për mjete juridike, të garantuar në nenin 32 të Kushtetutës.

(i) Nëse ka pasur dallim në trajtim në lidhje me të drejtën për mjete juridike

162. Siç është sqaruar më lart, nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues hyjnë në njëërën prej kategorive të shërbimit civil, të përcaktuara me paragrafin 2 të nenit 38 të LZP-së. Në kontekst të analizës nëse ka pasur dallim në trajtim në lidhje me të drejtën për mjete juridike, Gjykata konsideron se në rrethanat e rastit konkret, nuk është kontestuese që nëpunësit civilë të kategorisë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese në njëërën anë dhe nëpunësit civilë të kategorisë së nivelit të lartë drejtues në anën tjetër, janë në *“situata analoge ose situata relativisht të ngjashme”*, sepse (i) të gjithë janë pjesëtarë të shërbimit civil; (ii) ushtrojnë detyra në kuadër të shërbimit civil, siç janë përcaktuar në Kushtetutë dhe ligjin përkatës për zyrtarët publikë; dhe (iii) kanë detyrimin të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme dhe në interes të funksionimit të shërbimit civil, pa marrë parasysh që mënyra e zgjedhjes së tyre dhe kompleksiteti i natyrës së punës nuk është i njëjtë. Për më tepër, gjithashtu nuk është kontestuese që në rrethanat e nëpunësve civilë të nivelit profesional, të ulët dhe të mesëm drejtues në raport me nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues ka *“dallim në trajtim”* në kontekst të mjetit juridik në dispozicion për të kontestuar vendimet përkatëse në lidhje me marrëdhënien e tyre të punës. Grupit të parë, përkatësisht nëpunësve civilë të nivelit profesional, të ulët dhe të mesëm drejtues, i është dhënë qasje e drejtpërdrejtë në KPMSHCK, i cili është i detyruar të vendos brenda afateve të saktësuara në ligjin e aplikueshëm, ndërsa grupit të dytë, përkatësisht nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, i është mohuar e drejta e ankesës në KPMSHCK, por i është mundësuar inicimi i konflikti administrativ drejtpërdrejtë në gjykatën kompetente, pa afat të saktësuar për vendimmarrjen përkatëse.
163. Megjithatë, siç është sqaruar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të cituar më lart, fakti që ka një *“dallim në trajtim”* në këtë rast, në lidhje me të drejtën për mjete juridike jodetyrimisht rezulton në cenim të nenit 24 të Kushtetutës, sepse paraprakisht, duhet të vlerësohet nëse ky *“dallim në trajtim”* ka *“një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm”*

dhe më saktësisht nëse (i) është “i përcaktuar me ligj”; (ii) ndjek “një qëllim legjitim”; dhe (iii) është “proporcional”.

(ii) Testi i “dallimit në trajtim”

(a) Nëse dallimi në trajtim është i “përcaktuar me ligj”

164. Në vlerësimin nëse “dallimi përkatës në trajtim” është i “përcaktuar me ligj”, Gjykata rikujton se e drejta për mjet juridik përkatësish e drejta e ankesës drejtpërdrejtë në KPMSHCK i është njohur nëpunësve civilë të nivelit profesional, të ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues përmes paragrafit 1 të nenit 16 të Ligjit bazik, por përmes ndryshimeve të propozuara në Ligjin e kontestuar, përkatësisht nenet 2, 7 dhe 8 (pa tituj) të tij, nga një e drejtë e tillë, përjashtohen vetëm nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, të cilët edhe pse në rrethana “të ngjashme apo analoge” me pjesëtarët e tjerë të shërbimit civil, duhet të përdorin të drejtën për ankesë përmes legjislacionit tjetër në fuqi, duke ju drejtuar gjykatës kompetente të shkallës së parë për konflikt administrativ për të kontestuar vendimet përkatëse në lidhje marrëdhënien e tyre të punës. Prandaj, dallimi në trajtim në mes dy kategorive të lartcekura të nëpunësve civilë është “i përcaktuar me ligj”, përkatësisht në nenet 2, 7 dhe 8 të Ligjit të kontestuar. Për pasojë dhe në vijim, Gjykata duhet të vazhdojë me vlerësimin nëse “dallimi në trajtim” i lartcekur dhe i “përcaktuar me ligj” ka ndjekur një “qëllim legjitim”, dhe nëse ky është rasti, duhet të vazhdojë me vlerësimin nëse masat e ndërmarra kanë qenë “proporcionale” me synimin për të arritur qëllimin.

(b) Nëse ekziston një “qëllim legjitim”

165. Në kontekst të vlerësimit nëse qëllimi përkatës në “dallimin në trajtim” në mes të nëpunësve civilë të kategorive të tjera në raport me nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues ndjek “një qëllim legjitim”, Gjykata thekson që bazuar në paragrafin 3 të nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës por edhe parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, përcaktohet që kufizimet e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë “nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar”. Sipas këtij paragrafi, siç është interpretuar përmes praktikës së konsoliduar të Gjykatës dhe të cituar më lart, në parim, qëllimet e një kufizimi duhet të jenë qartësisht të përcaktuara dhe asnjë autoritet publik nuk mund të kufizojë ndonjë të drejtë apo liri mbi bazën e një qëllimi tjetër përtej atij që veçse është përcaktuar në ligjin në të cilin është lejuar/saktësuar kufizimi përkatës. Në parim, dhe në kontekst të rrethanave të rastit konkret, bazuar në këtë praktikë gjyqësore, i takon Qeverisë si sponsorizuese e Ligjit të kontestuar dhe Kuvendit që ka miratuar Ligjin e kontestuar, që të tregojnë se ai dallim ishte i justifikuar (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, [D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke](#), nr. 57325/00, Aktgjykim i 13 nëntorit 2007, paragrafi 177; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KO190/19, cituar më lart, paragrafët 206 dhe 208 dhe referencat e përdorura aty, KO100/22 dhe KO101/22, cituar më lart, paragrafët 336-338). Gjykata po ashtu rikujton se autoritetet shtetërore gëzojnë një margjinë të gjerë të vlerësimit si në drejtim të zgjedhjes së mjeteve zbatuese, ashtu edhe në aspektin e konstatimit nëse pasojat e zbatimit justifikohen me interesin e përgjithshëm për të arritur qëllimin e ligjit të caktuar (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, [Beyeler kundër Italisë](#), nr. 33202/96, Aktgjykim i 5 janarit 2000, paragrafi 112, si dhe rastet e Gjykatës, [KI185/21](#), parashtues SHPK “Co Colina”, Aktgjykim i 13 marsit 2023, paragrafi 209, dhe KO216/22 dhe KO220/22, cituar më lart, paragrafi 366).
166. Po ashtu, bazuar në praktikën e lartcekur, nëse një politikë publike e saktësuar përmes ligjit të miratuar në Kuvend është e duhura ose jo, është çështje e autoriteteve tjera publike dhe jo e Gjykatës, për aq sa, e njëjta nuk cenon dispozitat e Kushtetutës (shih *mutandis mutatis*, rastin e Gjykatës, KO216/22 dhe KO220/22, cituar më lart, paragrafi 366)

167. Rrjedhimisht, Gjykata duke pasur parasysh edhe marginën e gjerë të vlerësimit të autoriteteve shtetërore në hartimin e politikave publike, vlerëson që “*dallimi në trajtim*” në mes të nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe nëpunësve civilë të kategorive të tjera në shërbimin civil, edhe mund të ndjek një “*qëllim legjitim*”.
168. Andaj, në vazhdim Gjykata do të vlerësojë nëse masat e ndërmarra janë “*proporcionale*” në raport me qëllimin që synohet të arrihet, që është edhe hapi i fundit për të vlerësuar nëse “*dallimi në trajtim*” mund të rezultojë në cenimin e të drejtës për barazi para ligjit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues.

(c) Nëse ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës dhe qëllimit që synohet të arrihet

169. Bazuar në paragrafin 4 të nenit 55 të Kushtetutës por edhe parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, është përcaktuar që me rastin e kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore, krijohet përgjegjësi kushtetuese për autoritet publike që gjatë interpretimit dhe vendosjes në rastet para tyre, t’i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës e cila është kufizuar, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës, [KO157/18](#), cituar më lart, paragrafi 102; dhe KO190/19, paragrafi 212).
170. Gjykata vendos theksin në rëndësinë e qëllimit të kufizimit dhe marrëdhënien e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet. Në dritën e këtij kriteri, Gjykata po ashtu i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përmes të cilës ka theksuar se dallimi në trajtim kërkon një ekuilibër të drejtë midis mbrojtjes së interesave të komunitetit dhe respektimit të të drejtave të individëve. Rrjedhimisht, GJEDNJ ka specifikuar se dallimi në trajtim kërkon një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis masës së ndërmarrë dhe qëllimit që synohet që të arrihet (shih rastet e GJEDNJ-së, [Molla Sali kundër Gregisë](#), cituar më lart, paragrafi 135; [Fabris kundër Francës](#), nr. 16574/08, Aktgjykim i 7 shkurtit 2013, paragrafi 56; [Mazurek kundër Francës](#), nr. 34406/97, Aktgjykim i 1 shkurtit 2000, paragrafët 46 dhe 48; dhe [Larkos kundër Qipros](#), nr. 29515/95, Aktgjykim i 18 shkurtit 1999, paragrafi 29, si dhe Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO190/19, paragrafi 213).
171. Në vijim të vlerësimit të ndryshimeve ligjore përmes Ligjit të kontestuar, të cilat ia pamundësojnë vetëm një kategori të nëpunësve civilë (nivelit të lartë drejtues) që t’i drejtohen KPMSHCK-së në lidhje me vendimet për marrëdhënien e tyre të punës, në raport me kolegët e tyre të kategorive të tjera të nëpunësve civilë (nivelit profesional, të ulët dhe të mesëm drejtues), Gjykata thekson se një dallim i tillë nuk është bërë në ligjet e mëparshme për shërbimin civil në lidhje me të drejtën e ankesës për nëpunësit civilë në pozitat e larta drejtuese, respektivisht as në Rregulloren Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil, të ndryshuar dhe plotësuar me rregulloret e UNMIK-ut Nr. 2006/20 dhe Nr. 2008/12 (2001), e cila ka themeluar për herë të parë KPMSCHK-në; dhe më pas (ii) ligjet përkitazi me shërbimin civil, përkatësisht Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës (2010), Ligjin Nr. 04/L-114 për Zyrtarët Publikë (2019) dhe Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë (2022).
172. Nga sa u tha më sipër, Gjykata vëren se (i) ligjet e viteve 2001, 2010, 2019 dhe 2022, respektivisht, u kanë vënë në dispozicion nëpunësve civilë, pa dallim të kategorisë, mjetin juridik të ankesës në KPMSHCK, si mjet i fundit juridik në procedurë administrative, para hapjes së konfliktit administrativ.

173. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton komentet e Kryeministrit në emër të Qeverisë si sponsorizuese e ligjit, që qëllimi i ndryshimeve të propozuara, respektivisht heqjes së kompetencës së KPMSHCK-së për të vlerësuar vendimmarrjen e Qeverisë si “mekanizmi më i rëndësishëm i shtetit” në lidhje me marrëdhënien e punës së zyrtarëve publikë të nivelit të lartë, është që një institucion si KPMSCHK të mos kufizojë pushtetin ekzekutiv.
174. Në kontekst të përgjigjes së Kryeministrit, Gjykata thekson që (i) ndryshimet e propozuara në nenet 2, 7 dhe 8 (pa tituj) të Ligjit të kontestuar nuk prekin vetëm të drejtën e ankesës kundër vendimeve të Qeverisë, por edhe institucioneve të tjera në lidhje me përzgjedhjen e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, prandaj, për pasojë, (ii) justifikimi se përmes mbivendosjes së një trupi kuazi gjyqësor si KPMSHCK ndaj vendimmarrjes së Qeverisë kufizohet pushteti ekzekutiv, nuk mund të aplikohet në raport mes nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues të institucioneve tjera, të cilët sipas legjislacionit në fuqi gëzojnë të drejtën e ankesës në kushte të barabarta në kuadër të shërbimit civil së bashku me nëpunësit civilë të kategorive të tjera, e drejtë kjo e garantuar përveç se me Ligjin bazik, edhe në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) të LZP-së, ku përcaktohet se: “3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil.” dhe “4. E drejta e ankimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo candidateje/i në procedurë pranimit në shërbimin civil”. Në këtë kontekst, Gjykata rithekson se sipas legjislacionit në fuqi, të gjithë nëpunësit civilë, pa dallim kategorie, gëzojnë të drejtën për ankesë në KPMSHCK dhe se këtë të drejtë e kanë pasur që nga viti 2001.
175. Gjykata rithekson se sipas ndryshimeve të propozuara në nenet 2, 7 dhe 8 (pa tituj) të Ligjit të kontestuar, nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues në lidhje me vendimet për marrëdhënien e tyre të punës, bazuar në paragrafin 1 dhe 6 të nenit 49 dhe nënparagrafit 2 të paragrafit 3 të nenit 74 të LZP-së që përfshijnë: (i) përzgjedhjen, (ii) vazhdimin e mandatin dhe (iii) shkarkimin e tyre si pasojë e procedurave disiplinore, do të duhet t’i drejtohen drejtpërdrejtë gjykatës kompetente me padi për të hapur konflikt administrativ. Rrjedhimisht, kontestet në lidhje me vendimet për marrëdhënien e punës së tyre, respektivisht fillimin, vazhdimin dhe ndërprerjen e saj, do t’i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor. Sa i përket efektit juridik të këtyre vendimeve administrative në lidhje me marrëdhënien e punës së kategorisë në fjalë, Gjykata i referohet nënparagrafit 2 të paragrafit 1 të nenit 144 (Ekzekutueshmëria e aktit) të LPPA-së, i cili përcakton se: “1. Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: [...] 1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa; [...]”. Në rastin konkret, ligjvënësi nuk e ka paraparë mjetin juridik të ankesës në organin administrativ të shkallës së dytë, respektivisht në KPMSHCK, rrjedhimisht, vendimet e tilla bëhen të ekzekutueshme dhe mund të sfidohen vetëm me padi në procedurën e konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente, e cila padi nuk ka efekt pezullues.
176. Në këtë drejtim, Gjykata merr parasysh edhe parimet dhe dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin në fuqi për procedurën e administrative gjyqësore, respektivisht, Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Konfliktet Administrative), ku përcaktohen afatet dhe procedura e vendimmarrjes për këtë lloj procedure, e cila mund të sfidohet edhe në shkallën gjyqësore të dytë përmes “ankesës” dhe të tretë përmes “rishikimit të jashtëzakonshëm gjyqësor”, para se aktgjykimi i shkallës së parë për zgjidhjen e padisë të marrë formë të prerë. Në këtë pikë, Gjykata rikujton se deri në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, vendimi administrativ në lidhje me marrëdhënien e punës të nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues është i ekzekutueshëm.

177. Gjykata po ashtu, për efekt saktësimi dhe sqarimi, thekson se një ligj i ri për konfliktet administrative, përkatësisht Ligji Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative, është miratuar nga Kuvendi dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 10 janar 2023, por do të hyjë në fuqi 1 (një) vit pas këtij publikimi. Ai nenin 98 (Mjetet e Jashtëzakonshme) të tij parasheh disa ndryshime në kuptim të përdorimit të mjeteve juridike të jashtëzakonshme, me ç'rast ka paraparë përdorimin e mjeteve juridike të jashtëzakonshme, *mutatis mutandis* me procedurën kontestimore, përveç kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, e cila nuk do të lejohet.
178. Në anën tjetër, ligjvënësi në nenin 9 të Ligjit të kontestuar me të cilin ndryshon përmbajtjen e nenit 21 (Vendimi i Këshillit) të Ligjit bazik, ka paraparë që vendimet e KPMSHCK-së janë vendime administrative të cilat bëhen të ekzekutueshme brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve prej ditës kur kalon afati për të parashtruar padi në konflikt administrativ, çka nënkupton se vendimet në lidhje me marrëdhënien e punës së kategoritë e tjera të nëpunësve civilë (përveç atyre të nivelit të lartë drejtues) në rast të sfidimit të tyre në proces gjyqësor përmes konfliktit administrativ, bëhen të ekzekutueshme vetëm pasi që procedura gjyqësore të ketë epilog me vendim të formës së prerë në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për konfliktet administrative, përkatësisht nenit 66 (pa titull) të tij, i cili përcakton se: *“Vendimet e gjykatës mund të ekzekutohen atëherë kur bëhen të plotfuqishme dhe të ekzekutueshme”*.
179. Nga kjo rezulton se nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues në raport me kategoritë e tjera të nëpunësve të shërbimit civil janë vënë në pozitë të pabarabartë dhe bartin barrë të ndryshme në përdorimin e mjetit juridik në lidhje me zgjidhjen e kontesteve përkitazi me marrëdhënien e tyre të punës sepse përballen me pritje të të ndryshme për një vendim të ekzekutueshëm në lidhje me marrëdhënien e punës, çka e bën këtë *“dallim në trajtim”* jo proporcional në përdorimin e mjeteve juridike, të *“përcaktuara me ligj”*.
180. Thënë këtë, Gjykata vlerëson se ndryshimi i mjetit juridik, respektivisht ankesës vetëm për një kategori të shërbimit civil dhe jo për kategoritë e tjera, nuk është proporcional sepse: (i) nuk merr parasysh konsistencën e rregullimit të këtij mjeti juridik për të gjitha kategoritë e shërbimit civil si në ligjet e mëparshme në përputhje me kompetencën kushtetuese të KPMSHCK-së për mbikëqyrjen e shërbimit civil; si dhe (ii) vë barrë të ndryshme në përdorimin e mjetit juridik në lidhje me zgjidhjen e kontesteve përkitazi me marrëdhënien e tyre të punës në kontekst të efektit juridik të tyre juridik, përkatësisht pritjes së pabarabartë për ekzekutueshmërinë e tyre. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se kategoria e nëpunësve civilë të nivelit të lartë është pjesë e shërbimit civil dhe përderisa kjo kategori nuk përjashtohet shprehimisht nga shërbimi civil, atëherë nuk mund të rregullim tjetër që krijon ndarje në mes të kategorive sa i përket gëzimit të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës dhe që nuk janë në pajtim me kompetencat kushtetuese të KPMSHCK-së për mbikëqyrjen e shërbimit civil.
181. Prandaj, Gjykata konstaton se nenet 2, 7 dhe 8 (pa tituj) të Ligjit Nr. 08/L-180 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilët plotësojnë dhe ndryshojnë nenet 6 (Funksionet e Këshillit), 16 (Shqyrtimi i ankesave) dhe 19 (Procedura e mbikëqyrjes së përzgjedhjes së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues) të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit] në ndërlidhje me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] si dhe me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.

B. Përkitazi me pretendimet që ndërlidhen me nenin 6 të Ligjit të kontestuar, i cili plotëson dhe ndryshon paragrafin 3 të nenit 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit bazik

a. Thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe komenteve të palëve kundërshtare dhe të interesuara

182. Gjykata në vijim do të përmbledhë thelbin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës që ndërlidhen me heqjen e imunitetit për vendimmarrje të anëtarëve të KPMSHCK-së. Në këtë drejtim Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës KO232/23 pretendojnë se neni 6 i Ligjit të kontestuar, i cili plotëson dhe ndryshon nenin 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit bazik, e që ka të bëjë me heqjen e imunitetit për vendimmarrje për Kryetarin dhe anëtarët e KPMSHCK-së, drejtpërdrejt cenon pavarësinë e këtij të fundit dhe cenon të drejtat e palëve. Sipas tyre, kjo është në kundërshtim me nenet 101 [Shërbimi Civil] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.
183. Në këtë kontekst, parashtruesit theksojnë se imuniteti për vendimmarrje të cilin e gëzojnë Kryetari dhe anëtarët e KPMSHCK-së përmes Ligjit bazik, edhe sipas praktikës së vet Gjykatës është tërësisht i *“vlefshëm dhe si i tillë është i karakterit funksional”* duke theksuar ndër të tjera se KPMSHCK-ja gëzon prerogativat e një gjykate në *“kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*. Sipas tyre, heqja e imunitetit për vendimmarrje për anëtarët e KPMSHCK-së *“drejtpërdrejt cenon pavarësinë e këtij institucioni dhe të drejtat e palëve”*.
184. Parashtruesit theksojnë se me ndryshimet e propozuara përmes Ligjit të kontestuar e që parashihet që anëtarët e KPMSHCK-së do të bartin edhe përgjegjësi civile, do të krijohet pasiguri juridike dhe do të krijohet klimë për politizimin e këtij institucioni.
185. Në fund, lidhur me këtë pretendim specifik parashtruesit e kërkesës KO232/23 theksojnë se *“zhveshja e të drejtës në imunitet të anëtarëve të këshillit në bazë të ligjit të kontestuar, paraqet cenim flagrant edhe të vet karakterit institucional dhe rolit e përgjegjësive kushtetuese që ka ky institucion”*.
186. Sa i përket parashtruesve të kërkesës KO233/23, ata së pari theksojnë se çështja e imunitetit për vendimmarrje për Kryetarin dhe anëtarët e KPMSHCK-së është e përfunduar me rastin e Gjykatës, përkatësisht Aktgjykimin KO171/18.
187. Sipas tyre *“shumica parlamentare në vazhdimësi ka goditur Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Shumica aktuale parlamentare me urdhra nga ekzekutivi, që në fillim të marrjes së mandatit kishin shkarkuar të parët anëtarët e KPMSHCK-së, të cilët janë kthyer në punë me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese [...] Në vazhden e këtyre goditjeve është edhe pakësimi i kompetencave kushtetuese të KPMSHCK-së si dhe heqja e imunitetit funksional”*.
188. Tutje, parashtruesit e kërkesës KO233/23, pretendojnë se heqja e imunitetit për vendimmarrje për anëtarët e KPMSHCK-së *“cenon në bërthamë pavarësinë e këtij institucioni”*.
189. KPMSHCK-ja në komentet e tyre dorëzuar në Gjykatë më 14 nëntor 2023, duke mbështetur argumentet e parashtruara nga parashtruesit thekson se *“Imuniteti funksional për kryetarin dhe anëtarët e Këshillit ekziston për shkak se Këshilli kualifikohet si institucion “kuazi gjyqësor”, përkatësisht si tribunal përkitazi me zgjidhjen e kontesteve që burojnë nga shërbimi civil. Rrjedhimisht, Këshilli i Pavarur gëzon prerogativat e një “gjykate”, pikërisht për shkak të pavarësisë nga ekzekutivi*

dhe legjislativi dhe kualifikohet si institucion që ka juridiksion të plotë që të nxjerr vendime të detyrueshme, në lidhje me konfliktet në mes të shërbyesve civil ose kandidatëve për shërbyes civil në njëri anë, dhe institucioneve që kanë të punësuar nëpunësit civil, në anën tjetër (shih Aktgjykimin në rastin nr. KO171/18, paragrafi 165 si dhe rastin nr. KO127/21, paragrafi 86)”.

190. Më tej, KPMSHCK-ja shton se neni 3 i Ligjit të kontestuar përmes së cilës dispozitë hiqet imuniteti për vendimmarrje për Kryetarin dhe anëtarët e këtij të fundit, cenon pavarësinë në ushtrimin e mandatit kushtetues, dhe si e tillë kjo dispozitë nuk është në pajtueshmëri me nenin 101 të Kushtetutës. Në mbështetje të këtij pretendimi KPMSHCK-ja gjithashtu thirret në Aktgjykimet KO171/18 dhe KO127/21 të Gjykatës.
191. Në anën tjetër, Kryeministri përmes komenteve të dorëzuara në Gjykatë më 15 nëntor 2023, thekson se KPMSHCK është organ administrativ jo gjyqësor në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së, duke argumentuar më tej se anëtarët e tij nuk janë gjyqtarë dhe nuk gëzojnë imunitet për vendimmarrje të garantuar me Kushtetutë për gjyqtarët. Në komentet e tij Kryeministri thekson se *“Në këtë pikë duhet vërejtur që vetëm gjyqtarët, deputetët dhe anëtarët e Qeverisë, sipas fjalës së Kushtetutës, gëzojnë imunitetin funksional. Edhe në Vendimin KO171/18 Gjykata pohon se anëtarët e KPMSHCK nuk janë gjyqtarë e as pjesë e një institucioni gjyqësor në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së, andaj as nuk gëzojnë imunitetin e dhënë me automatizëm sipas detyrës”.*
192. Në ndërlidhje me këtë, Kryeministri thekson se çështja e imunitetit për vendimmarrje është kategori ligjore dhe mund të caktohet me ligje të veçanta, si dhe rrjedhimisht, bie nën kategorizimin ligjor. Sipas tij, është në duart e ligjvënësit që të propozojë apo jo imunitetin për vendimmarrje përmes ligjit të veçantë, çka e bën heqjen e imunitetit për vendimmarrje kategori jo kushtetuese.
193. Marrë parasysh ato që u thanë më lart, respektivisht pretendimet e parashtruesve të kërkesës, argumentet e palëve tjera të reflektuara më lart si dhe rrethanat që ngërthen rasti, Gjykata thekson se lidhur me këtë pretendim specifik është e rëndësishme që së pari të shtjellojë parimet e përgjithshme lidhur me (i) aplikueshmërinë e nenit 142 të Kushtetutës; (ii) parimet e përgjithshme të vendosura nga Gjykata në rastin e KO171/18, si dhe rastit KO127/21;

Sa i përket aplikueshmërisë së nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës

194. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesit e kërkesës, ndër të tjera, i referohen nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, për të mbështetur argumentet e tyre, kundër heqjes së imunitetit për Kryetarin dhe anëtarët e KPMSHCK-së, ndryshime këto që parashihen me Ligjin e kontestuar. Më tej parashtruesit e kërkesës përgjatë elaborimit të argumenteve të tyre kundër ndryshimeve që parasheh Ligji i kontestuar, respektivisht heqjen e imunitetit për Kryetarin dhe anëtarët e KPMSHCK-së, këtë të fundit e kualifikojnë si Agjenci të Pavarur.
195. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton Aktgjykimin e saj KO171/18, ku përmes tij, Gjykata, ndër të tjera, theksoi se Kapitulli XII [Institucionet e Pavarura] i Kushtetutës rregullon në mënyrë të veçantë institucionet e pavarura si në vijim: (i) Avokatin e Popullit (nenet 132-135 të Kushtetutës); (ii) Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës (nenet 136-138 të Kushtetutës); (iii) Komisionin Qendror i Zgjedhjeve (neni 139 i Kushtetutës); (iv) Bankën Qendrore të Kosovës (neni 140 i Kushtetutës); dhe (v) Komisionin e Pavarur të Medieve (neni 141 i Kushtetutës). Po ashtu, neni 142 [Agjencitë e Pavarura] i Kushtetutës, në kuadër të të njëjtit kapitull, përcakton mundësinë e krijimit të Agjencive të Pavarura nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Sipas këtij neni, këto agjenci, (i)

funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës; dhe (ii) secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligjin përkatës.

196. Përveç kësaj, Kushtetuta ka themeluar edhe disa institucione tjera, ndër të tjera, Gjykatën Kushtetuese në kapitullin VIII të saj, si dhe KPMSHCK-në në nenin 101 të saj. Në Aktgjykimin e saj në rastin KO171/18, dhe të gjitha sqarimet e dhëna në të, Gjykata konstatoi që KPMSHCK-ja nuk mund të kategorizohet si institucion i pavarur kushtetues sipas Kapitullit XII të Kushtetutës dhe as si agjenci e pavarur në bazë të nenit 142 të Kushtetutës, por si institucion i pavarur i themeluar me paragrafin 2 të nenit 101 të Kapitullit VI të Kushtetutës, për qëllim të sigurimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil në Republikën e Kosovës (shih rastin KO171/18, paragrafët 155-159).
197. Sipas sqarimeve të dhëna në praktikën gjyqësore të Gjykatës, dhe të elaboruar në këtë Aktgjykim, përderisa themelimi i agjencive të pavarura në bazë të nenit 142 të Kushtetutës është kompetencë e Kuvendit, dhe i cili përmes ligjeve përkatëse rregullon edhe themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre, Kuvendi nuk ka të njëjtën kompetencë përkitazi me institucionet e themeluara përmes dispozitave kushtetuese, në rastin konkret KPMSHCK-në, sepse themelimi, funksionimi dhe kompetencat e tij, për aq sa janë të rregulluara me Kushtetutë, nuk mund të ndryshohen nga Kuvendi, përpos përmes amendamenteve kushtetuese.
198. Gjykata marrë parasysh të lartcekurat rithekson se për dallim nga Agjencitë e Pavarura të cilat bazuar në nenin 142 të Kushtetutës themelohen nga Kuvendi, KPMSHCK-ja është institucion i cili është i themeluar përmes nenit 101 të Kushtetutës, dhe si i tillë pavarësia institucionale, e cila i është atribuar, tejkalon atë të garantuar për Agjencitë e Pavarura përmes nenit 142 të Kushtetutës.
199. Për pasojë, Gjykata nuk do të lëshohet më tej në pretendimin e parashtruesve që ndërlidhet me nenin 142 të Kushtetutës. Më tej, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës në kuadër të fushëveprimit të nenit 101 të Kushtetutës.
200. Në vazhdim, Gjykata do të shqyrtojë pretendimin e parashtruesve lidhur me shkeljen e nenit 101 të Kushtetutës, që ndërlidhet me heqjen e imunitetit për Kryetarin dhe anëtarët e KPMSHCK-së, duke (i) aplikuar parimet e përgjithshme të vendosura nga Gjykata lidhur me çështjen e imunitetit të anëtarëve të KPMSHCK-së në rastet e Gjykatës KO171/18 dhe KI127/21; dhe më pas (ii) të aplikojë të njëjtat në rastin konkret.

b. Parimet e përgjithshme të vendosura nga Gjykata lidhur me çështjen e imunitetit të anëtarëve të KPMSHCK-së në rastet e Gjykatës KO171/18 dhe KI127/21

201. Gjykata rikujton se përmes ndryshimeve të cilat parashihen me Ligjin e kontestuar, Kryetari dhe anëtarët e KPMSHCK-së lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore, nuk do të gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi.
202. Gjykata në këtë kontekst rikujton se paragrafi 3 i nenit 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit bazik, që ndërlidhet me çështjen e imunitetit për vendimmarrje të anëtarëve të KPMSHCK-së, është vlerësuar nga Gjykata përmes Aktgjykimin në rastin

- KO171/18, dhe pas shqyrtimit të praktikave përkatëse gjyqësore por edhe raporteve relevante të Komisionit të Venecias, është vlerësuar “*në pajtueshmëri me Kushtetutën*”.
203. Në adresim të këtij pretendimi, Gjykata rikujton Aktgjykimin e saj në rastin KO171/18, ku kishte vlerësuar imunitetin për vendimmarrje për anëtarët KPMSHCK-së të paraparë me Ligjin bazik, duke analizuar fillimisht nëse: (i) imuniteti ndjek një qëllim legjitim, dhe (ii) është proporcional në kuptim të asaj që ankuesit pranë KPMSHCK-së, “*kanë alternativë të arsyeshme të mbrojnë në mënyrë efektive të drejtat e tyre sipas vendimeve të Këshillit*”.
 204. Në këtë drejtim, duke marrë parasysh se sipas paragrafit 3 të nenit 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit bazik, anëtarëve të KPMSHCK-së u ofrohet imunitet funksional lidhur me vendimmarrjen në kuadër të ushtrimit të funksioneve të tyre kushtetuese dhe ligjore, duke garantuar se të njëjtit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi sa i përket vendimmarrjes. Gjykata në rastin e saj KO171/18, respektivisht paragrafi 242, vlerësoi se “[...] *imuniteti funksional që u garantohet anëtarëve të Këshillit sipas Ligjit të kontestuar është i limituar dhe ata nuk kanë mbrojtje të posaçme për veprimet jashtë atij fushëveprimit të tyre si anëtarë të Këshillit, apo nëse ata akuzohen për vepra penale, që nuk ndërlidhen thjesht me faktin që ata kanë ushtruar funksionet e tyre që ndërlidhen me pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre. Ata gjithashtu nuk kanë imunitet as nga arrestimi*”.
 205. Më tej, Gjykata në rastin e saj KO171/18, shtoi se “*Ligji i kontestuar nuk parasheh imunitet tjetër për anëtarët e Këshillit, përveç imunitetit funksional që u sqarua më lart, e që ka të bëjë me paprekshmëri për veprimet jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si anëtarë të Këshillit. Andaj, në cilësinë e tyre si qytetarë të rëndomtë, anëtarët e Këshillit trajtohen njëllor si të gjithë qytetarët e tjerë*”.
 206. Gjykata në rastin KO171/18, në fund theksoi se “*duke pasur parasysh imunitetin e limituar që u garantohet anëtarëve të Këshillit përmes nenit 11, paragrafi 3 të Ligjit të kontestuar, si dhe faktin që ndaj vendimeve të Këshillit palët kanë të drejtë të hapin konflikt administrativ, Gjykata vlerëson se masa e përdorur është proporcionale me qëllimin që dëshirohet të arrihet pasi palët e interesuara kanë mundësi të mbrojnë në mënyrë efektive të drejtat e tyre ndaj vendimeve të Këshillit duke hapur konflikt administrativ*”.
 207. Rrjedhimisht, si konstatim, në rastin KO171/18, Gjykata vlerësoi se qëllimi i imunitetit për vendimmarrje është që anëtarët e KPMSHCK-së të jenë të lirë të ushtrojnë funksionet e tyre me pavarësi dhe pa frikën e pasojave për kryerjen e funksioneve të tyre, prandaj imuniteti për vendimmarrje i shërben këtij qëllimi dhe Gjykata përmes aktgjykimit të saj të lartpërmendur, konsideroi se i njëjti është legjitim dhe i domosdoshëm për qëllime të nenit 101 të Kushtetutës në kuadër të funksioneve dhe kompetencave të KPMSHCK-së.
 208. Gjithashtu, në këtë kontekst, Gjykata rikujton edhe Aktgjykimin KO127/21, ku përgjatë elaborimit të pretendimit të parashtruesve lidhur me Vendimin e Kuvendit për shkarkimin e anëtarëve të KPMSHCK-së, që ndërlidhej me procesin e vendimmarrjes theksoi si në vijim, “*Gjykata duke u bazuar në pavarësinë e Këshillit të Pavarur, natyrën e vendimeve që Këshilli i Pavarur nxjerr dhe në imunitetin funksional që anëtarët e Këshillit të Pavarur gëzojnë, konsideron se të njëjtit nuk mund të thirren në përgjegjësi për mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre, sepse kjo do cenonte pavarësinë e tyre në ushtrimin e kompetencave si anëtarë të Këshillit të Pavarur, siç garantohet me parimet e mishëruara në paragrafin 2 të nenit 101 të*

Kushtetutës [...] Gjykata rikujton se një anëtar i Këshillit të Pavarur, Kuvendi nuk mund t'ia kontrollojë arsyeshmërinë e vendimmarrjes meqenëse ato janë të mbrojtura me parimin e pavarësisë së vendimmarrjes së Këshillit të Pavarur, vendimmarrje kjo e ndërlidhur me "sigurimin e respektimit të parimeve dhe rregullave të shërbimit civil" sipas paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës, dhe e mbrojtur përmes imunitetit nga shkarkimi sipas paragrafit 3 të nenit 11 të Ligjit për KPMSHCK-në".

c. Vlerësimi i Gjykatës

209. Në aplikimin e këtyre parimeve, Gjykata fillimisht i referohet edhe një herë nenit 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit bazik, i cili përcakton si në vijim:

Neni 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit)

*"1. Anëtarët e Këshillit emërohen për mandat shtatë (7) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes për mandat tjetër;
2. Anëtar i Këshillit nuk ka të drejtë që gjatë mandatit të tij të ushtrojë ndonjë funksion tjetër shtetëror, të jetë anëtar i partisë politike apo të marr pjesë në aktivitete politike.
3. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi."*

210. Gjykata gjithashtu rikujton edhe përmbajtjen e nenit 6 të Ligjit të kontestuar, i cili ndryshon dhe plotëson nenin 11 të lartpërmendur të Ligjit bazik, duke përcaktuar si në vijim:

Neni 6 (pa titull)

"Nenin 11 i ligjit bazik, paragrafi 3. fshihet nga teksti i ligjit.

211. Nga përmbajtja e Ligjit të kontestuar Gjykata vëren se përmes largimit të paragrafit 3 të nenit 11 të Ligjit bazik për KPMSHCK-në, Kryetari dhe anëtarët e KPMSHCK-së, më nuk do të gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi lidhur me vendimmarrjen e tyre në kuadër të ushtrimit të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të KPMSHCK-së.
212. Në rrethanat e rastit konkret, ligjvënësi përmes ndryshimit të propozuar, i heq të drejtën në imunitet funksional Kryetarit dhe anëtarëve të KPMSHCK-së, në lidhje me vendimmarrjen e tyre.
213. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës në thelb pretendojnë se përmes Ligjit të kontestuar heqja e imunitetit për vendimmarrje për anëtarët e KPMSHCK-së nuk është në përputhshmëri me nenin 101 [Shërbimi Civil], duke argumentuar se në këtë mënyrë cenohet thelbi i pavarësisë në vendimmarrje të vet institucionit të KPMSHCK-në.
214. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton përmbajtjen e nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës, i cili specifikon si në vijim:

*"1. Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht.
2. Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës."*

215. Në kontekst të të lartcekurave, Gjykata rikujton parimet e përgjithshme që burojnë nga paragrafi 2 i nenit 101 të Kushtetutës dhe se bazuar në po të njëjtin, KPMSHCK është organ i pavarur, i cili duhet të sigurojë respektimin e rregullave dhe parimeve të shërbimit civil, respektimin e të cilave e bën përmes vendimmarrjes në rastet e parashtruara pranë tij, që nënkupton pavarësinë individuale të anëtarëve të KPMSHCK-së në shqyrtimin e rasteve konkrete.
216. Siç ka sqaruar edhe në Aktgjykimin e saj KO171/18, dhe siç është elaboruar edhe tek parimet e përgjithshme, çështja e imunitetit për vendimmarrje për anëtarët e KPMSHCK-së nuk rregullohet në mënyrë specifike me nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës, i cili e përcakton KPMSHCK-në si një institucion që mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil.
217. Megjithatë siç është sqaruar në Aktgjykimin e lartpërmendur, praktika e dhënies së imunitetit përmes ligjit edhe pse Kushtetuta nuk e ka paraparë në mënyrë shprehimore një gjë të tillë, është e njohur edhe në vendet e tjera dhe dhënia e imunitetit në lidhje me disa institucione shtetërore është inkurajuar edhe nga Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit, i njohur si “Komisioni i Venecias”. Komisioni i Venecias në “Përmbledhjen e Komisionit të Venecias në lidhje me Institucionin e Avokatit të Popullit” ka vlerësuar ligjet e shteteve të ndryshme të cilat kanë paraparë imunitet funksional për Avokatin e Popullit, zëvendësit e tij por edhe për stafin mbështetës të institucionit të Avokatit të Popullit (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO171/18, paragrafi 231).
218. Tutje, në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO171/18, si dhe të gjitha sqarimet e dhëna në të, konstatimin se anëtarët e KPMSHCK-së nuk mund të konsiderohen “*gjuqtarë*” dhe respektivisht nuk mund të gëzojnë imunitet për vendimmarrje që gëzojnë gjuqtarët në bazë të nenit 107 të Kushtetutës, megjithatë Gjykata përgjatë vlerësimit nëse dhënia e imunitetit për vendimmarrje për anëtarët e KPMSHCK-së cenon ndonjë nga të drejtat e parapara me Kushtetutë vlerësoi se “*qëllimi i imunitetit është që anëtarët e Këshillit të jenë të lirë të ushtrojnë funksionet e tyre me pavarësi dhe pa frikën e pasojave për kryerjen e funksioneve të tyre, andaj imuniteti i shërben këtij qëllimi dhe Gjykata konsideron se është legjitim*”. Qëllimi i imunitetit për anëtarët e KPMSHCK-së në lidhje me vendimmarrjen e tyre, i shërben realizimit të pavarur të funksionimit të KPMSHCK-së për qëllime të nenit 101 të Kushtetutës.
219. Çështja e imunitetit për vendimmarrje për anëtarët e KPMSHCK-së se është imunitet funksional, ashtu si është sqaruar nga Gjykata edhe në rastin KO98/11, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 20 shtatorit 2011, në lidhje me imunitetin e Presidentit, deputetëve dhe anëtarëve të Qeverisë, nënkupton se anëtarët e KPMSHCK-së lirohen nga përgjegjësia për çfarëdo natyre mbi pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre si anëtarë të KPMSHCK-së dhe veprimet e tjera të ndërmarra gjatë kohës që janë duke kryer detyrat e tyre. Ky lloj imuniteti vazhdon edhe pasi mandati i tyre të mbarojë dhe ka kohëzgjatje të pakufizuar. Ata nuk do të jenë të detyruar t’i përgjigjen askujt apo ndonjë gjykatë për veprime dhe vendime të tilla (shih rastin KO98/11, cituar më lart, paragrafi 54).
220. Gjykata më tej rikujton edhe përmbajtjen e nenit 15 të Ligjit bazik për KPMSHCK-në, i cili numëron në mënyrë taksative, arsyet se kur një anëtar i KPMSHCK-së mund t’i ndërpritet mandati, duke përcaktuar shprehimisht se: “1. *Kuvendi i Kosovës me shumicë të votave mund të shkarkojë anëtarin e Këshillit për shkak të arsyeve në vijim: 1.1. për shkelje të dispozitave të këtij ligji; 1.2. kur kryen veprimtari, që krijon konflikt të interesit dhe përkundër paralajmërimit nga organi kompetent nuk e eliminon konfliktin e interesit sipas ligjit përkatës; 1.3. në rastet e kryerjes së detyrave në*

papajtueshmëri me funksionin e tij; 1.4. mungon pa arsye në punë mbi pesë (5) ditë për arsyet që nuk parashihen me ligj”.

221. Nga përmbajtja e vet nenit 15 të Ligjit bazik për KPMSHCK-në, ku renditen të gjitha rrethanat se kur një anëtari të KPMSHCK-së mund t'i ndërpritet mandati, është shumë e qartë se Ligji bazik nuk e parashih mundësinë e shkarkimit të një anëtari të KPMSHCK-së, për mendimin e shprehur gjatë ushtrimit të funksioneve të tij të parapara me Kushtetutë dhe ligjin e aplikueshëm.
222. Duke u rikthyer në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se qëllimi i imunitetit është që anëtarët e KPMSHCK-së të jenë të lirë të ushtrojnë funksionet e tyre përgjatë sigurimit dhe respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil pa frikën e pasojave për kryerjen e funksioneve të tyre, prandaj imuniteti në lidhje me vendimmarrjen e tyre i shërben këtij qëllimi dhe Gjykata konsideron se është legjitim.
223. Në dritë të asaj që u tha më lart, bazuar në praktikën e lartpërmendur të Gjykatës, anëtarët e KPMSHCK-së gëzojnë pavarësi në vendimmarrjen e tyre në *“sigurimin respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil”*, siç përcakton paragrafit 2 i nenit 101 të Kushtetutës; (ii) kjo pavarësi është me tej e interpretuar dhe përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës në rastin KO171/18, dhe KO127/21, raste këto të cilat e kanë trajtuar pikërisht çështjen e imunitetit për vendimmarrje për anëtarët e KPMSHCK-së, i cili anëtarëve të tij u atribuon imunitet lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të KPMSHCK-së, nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi, i cili ua mundëson që të jenë të lirë të ushtrojnë funksionet e tyre me pavarësi dhe pa frikën e pasojave për kryerjen e funksioneve të tyre në lidhje me *“pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre”*; (iii) përderisa Kuvendi ka kompetencë kushtetuese të mbikëqyrë KPMSHCK-në, duke përfshirë mundësinë e ndërprerjes së mandatit të anëtarëve të tij në rastet e përcaktuara në nenin 15 të Ligjit bazik për KPMSHCK-në, anëtarët e KPMSHCK-së nuk mund të shkarkohen vetëm për vendimmarrje sepse përkitazi me të njëjtën kanë imunitet nga shkarkimi, siç është përcaktuar në vet ligjin që e ka miratuar Kuvendi. Për më tepër që, bazuar në po të njëjtin ligj, ligjshmëria e vendimeve të KPMSHCK-së i nënshtrohet kontrollit të pushtetit gjyqësor dhe jo atij legjislativ.
224. Nga si më sipër, marrë parasysh formulimin e (i) paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës; (ii) praktikën gjyqësore të Gjykatës të sqaruar më lart; dhe (iii) leximin e përbashkët të nenit 15, dhe paragrafit 3 të nenit 11 të Ligjit bazik për KPMSHCK-në, përkatësisht mundësinë e ndërprerjes së mandatit të anëtarit të KPMSHCK-së nga Kuvendi dhe imunitetin për vendimmarrje, të cilin ua ka përcaktuar i njëjti përkitazi me shkarkimin lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të KPMSHCK-së, Gjykata thekson se anëtari i KPMSHCK-së nuk mund të shkarkohet për arsye të vendimmarrjes, përkatësisht mënyrës së votimit gjatë shqyrtimit të rasteve konkrete. Ligjshmëria e vendimmarrjes së tillë në fakt dhe siç është sqaruar më lart, i takon pushtetit gjyqësor, përmes procedurës së konfliktit administrativ siç është përcaktuar në nenin 22 të Ligjit për KPMSHCK-në.
225. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu thekson edhe praktikën e saj, ku e kualifikoi KPMSHCK-në si institucion *“kuazi gjyqësor”*, përkatësisht si tribunal përkitazi me zgjidhjen e kontesteve që burojnë nga shërbimi civil, andaj, pavarësia në vendimmarrje e anëtarëve të KPMSHCK-së, dhe pikërisht imuniteti funksional është vegël që e siguron pavarësinë në vendimmarrje për anëtarët e KPMSHCK-së.

226. Gjykata duke u bazuar në parimet e lartcekura përkitazi me vendimmarrjen e anëtarëve të KPMSHCK, e që ngërthejnë (i) pavarësinë në vendimmarrje për Kryetarin dhe anëtarët e KPMSHCK-së; (ii) natyrën e vendimeve që ky i fundit nxjerr; (iii) praktikën e Gjykatës, e cila kualifikoi KPMSHCK-në si institucion “kuazi gjyqësor”, përkatësisht si tribunal përkitazi me zgjidhjen e kontesteve që burojnë nga shërbimi civil; si dhe (iii) imunitetin funksional që anëtarët e këtij të fundit gëzojnë përmes Ligjit bazik për KPMSHCK-në, konsideron se të anëtarët e KPMSHCK-së nuk mund të thirren në përgjegjësi për mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre, edhe nëse imuniteti nuk ju akordohet në mënyrë specifike me Ligj, sepse kjo do cenonte pavarësinë e tyre në ushtrimin e kompetencave si anëtarë të KPMSHCK-së, dhe në këtë mënyrë do të cenohej edhe vet parimi i sigurisë juridike, si një nga shtyllat kryesore të sundimit të ligjit i cili kërkon, në mes tjerash, që rregullat të jenë të qarta dhe të sakta, dhe të synojnë të sigurojnë që situatat dhe marrëdhëniet juridike të mbeten të parashikueshme.
227. Si konkludim, Gjykata thekson se çështja e imunitetit për anëtarët e KPMSHCK-së në lidhje me vendimmarrjen e tyre, edhe pse nuk është e garantuar në mënyrë specifike me nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës, i cili ka për qëllim të sigurimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil në Republikën e Kosovës dhe e njëjta i është akorduar anëtarëve të KPMSHCK-së përmes Ligjit bazik, i cili është vlerësuar nga Gjykata në rastin KO171/18 dhe është konsideruar në pajtim me Kushtetutën, dhe për më tepër në rastin KO127/21 Gjykata ka vlerësuar se shkarkimi i anëtarëve të KPMSHCK-së nuk është në përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës. Andaj, duke u bazuar edhe në praktikën e saj të cituar më lart, Gjykata konstaton se çështja e imunitetit, në rastin konkret heqja e imunitetit për anëtarët e KPMSHCK-së në lidhje me vendimmarrjen e tyre, përmes nenit 6 të Ligjit Nr. 08/L-180 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili fshin paragrafin 3 të nenit 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është në përputhje me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.

C. Përkitazi me pretendimet e parashtruesve që ndërlidhen me nenet 9, 10 dhe 11 të Ligjit të kontestuar, të cilat ndryshojnë dhe plotësojnë nenin 21 (Vendimi i Këshillit), paragrafin 2 të nenit 22 (inicimi i konfliktit administrativ), si dhe paragrafin 1 të nenit 23 (Procedura në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit) të Ligjit bazik të KPMSHCK-së

228. Gjykata se pari rikujton pretendimet e parashtruesve që ndërlidhen me nenet 9, 10 dhe 11 të Ligjit të kontestuar të cilët plotësojnë dhe ndryshojnë nenin 21 (Vendimi i Këshillit), paragrafin 2 të nenit 22 (inicimi i konfliktit administrativ), si dhe paragrafin 1 të nenit 23 (Procedura në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit) të Ligjit bazik të KPMSHCK-së të Ligjit bazik të KPMSHCK-së, duke rikujtuar thelbin e këtij pretendimi e që ka të bëjë me faktin se përmes ndryshimeve të propozuara, vendimet e KPMSHCK-së bëhen joefektive, në të gjitha rastet kur iniciohet konflikt administrativ ndaj vendimit përkatës të KPMSHC-së në gjykatën kompetente, duke cenuar në këtë mënyrë sigurinë juridike.

a. Thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe komenteve të palëve kundërshtare dhe të interesuara

229. Gjykata së pari përmbledhë thelbin e pretendimeve të parashtruesve në rastin KO232/23.

230. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës theksojnë se Ligji i kontestuar përfundimisht e bën joefektiv vendimin e KPMSHCK-së në rastet kur iniciohet konflikt administrativ ndaj vendimit përkatës në gjykatën kompetente, dhe në këtë mënyrë cenon në thelb parimin e sigurisë juridike dhe parimin e gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, sepse inicimi i konfliktit administrativ në bazë të ligjit kontestues e ndalon ekzekutimin e vendimit të KPMSHCK-së. Parashtruesit shtojnë se *“Aktualisht, në procedurën administrative Këshilli vepron si shkallë e dytë. Në secilin rast kur merret një vendim nga institucioni në procedurën administrative të shkallës së parë, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshill. Në bazë të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative [neni 130] parashtrimi i ankesës e pezullon zbatimin e vendimit të shkallës së parë. Sipas Ligjit, vendimi i Këshillit konsiderohet i formës së prerë dhe është vendim i zbatueshëm. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit përjashtimisht nëse Gjykata vlerëson se në një rast specifik kjo duhet të ndodhë dhe vendosë masë të përkohshme”*.
231. Parashtruesit e kërkesës shtojnë se përmes Ligjit të kontestuar, në rastet kur iniciohet konflikt administrativ në gjykatat e rregullta, vendimet e KPMSHCK-së do të pezullohen dhe të njëjtat nuk do të zbatohen deri në një vendim përfundimtar të gjykatave të rregullta.
232. Të njëjtit po ashtu theksojnë se: *“Kjo zgjidhje ligjore është në kundërshtim me aspektet konceptuale në mes të procedurës administrative dhe procedurës gjyqësore. Këto dy procedura, janë procedura të ndryshme dhe të ndara. Procedura administrative, e cila përfundon në shkallë të dytë brenda institucioneve administrative, rregullohet me ligj tjetër nga konflikti administrativ që zhvillohet në gjykatë. Për këtë arsye, ndërlidhja e zbatueshmerisë së vendimit të Këshillit me vendimin e gjykatës, përderisa gjykata nuk ka shqiptuar mase të përkohshme, është përzierje e dallimeve bazë në mes të procedurës administrative dhe asaj gjyqësore”*. Parashtruesit në ndërlidhje me këtë shtojnë se roli i KPMSHCK-së si organ administrativ për mbrojtjen e të drejtave gjyqësore ka për synim zgjidhjen e juridike të çështjeve dhe ankesave brenda administratës si dhe ngritjen e efikasitetit në trajtimin e këtyre rasteve. Sipas tyre *“Pezullimi ex-lege i vendimit të këshillit deri në nxjerrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë praktikisht paraqet përjashtim të këshillit nga roli i tij kushtetues dhe pamundëson zgjidhjen e ankesave brenda procedurës administrative. Ky nen, që rregullon formën dhe mënyrat e themelimit të Agjencive të Pavarura, përcakton katër parime bazë që duhet të shoqërojnë themelimin dhe funksionimin e Agjencive të Pavarura. Së pari, Kuvendi i Kosovës është autoriteti kushtetues i cili mban tagrin e themelimit të Agjencive të Pavarura. Për themelimin e tyre, neni në fjalë përcakton që Kuvendi duhet të nxjerrë ligjet përkatëse, që rregullojnë, ndër të tjera, funksionimin, dhe fushëveprimin ligjor të tyre. Së dyti, Kushtetuta përcakton që Agjencive të Pavarura duhet t’u garantohet që ushtrimi i funksionit të tyre ligjor të realizohet pa ndikim dhe në mënyrë të pavarur nga çdo udhëzim apo ndërhyrje e organeve tjera shtetërore, përfshirë organin që e ka themeluar. Së treti, për garantimin e pavarësisë së tyre, neni 142 përcakton që Agjencitë e Pavarura duhet të posedojnë buxhetin e tyre të veçantë, dhe të administrojnë me këtë të fundit në mënyrë të pavarur, dhe, parimi i fundit kushtetues i cili duhet të shoqërojë themelimin e Agjencive të Pavarura, lidhet me garancionin kushtetues që organet tjera shtetërore të ruajnë pavarësinë, të bashkëpunojnë dhe t’u përgjigjen kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre kushtetuese dhe ligjore”*.
233. Parashtruesit e kërkesës në rastin KO233/23, në ndërlidhje me këtë pretendim fillimisht para Gjykatës theksojnë se Gjykata në disa raste të saj, ka konstatuar se vendimet e KPMSHCK-së, janë vendime *“përfundimtare, të detyrueshme dhe të ekzekutueshme”*. Parashtruesit thirren në një numër të rasteve të Gjykatës, duke

përfshirë edhe raste individuale ku objekt shqyrtimi kanë qenë vendimet e KPMSHCK-së.

234. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se me LPPA, parashtrimi i ankesës në KPMSHCK pezullon zbatimin e vendimit të institucionit përkatës, dhe se vendimet e KPMSHCK-së konsiderohen si vendime të formës së prerë.
235. Tutje, shtojnë se: *“ndërlidhja e zbatueshmërisë së vendimit të KPMSHCK me vendimin e gjykatës, përderisa gjykata nuk ka shqiptuar masë të përkohshme, është përzierje e dallimeve bazë në mes të procedurës administrative dhe asaj gjyqësore, dhe e njëjta është në kundërshtim me nenin 31”*.
236. Krejt në fund, në ndërlidhje me këtë pretendim parashtruesit e kërkesës KO233/23 shprehin se moszbatimi i vendimeve të KPMSHCK-së, nëse i njëjti atakohet në Gjykatë *“[...] e godet në thelb autoritetin institucional të Këshillit, si institucion kuazi gjyqësor, dhe i njëjti pa këtë funksion nuk do të kishte fare rol në strukturën e institucioneve të pavarura, dhe si i tillë nuk do të duhej të ekzistonte fare”*.
237. KPMSHCK-ja në komentet e saj, sa i përket këtij pretendimi, thekson se *“palëve në procedurë iu mundësohet mbrojtja e drejtave të tyre të pretenduara përmes parashtrimit të kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, me kushtin që ekzekutimi i vendimit do t'i sillte dëm paditësit i cili vështirë do të riparohej, shtyrja e ekzekutimit nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja e ekzekutimit do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar”*. Sipas KPMSHCK-së, *“neni 7 i ligjit të kontestuar përmes të cilit është përcaktuar se në rastet kur inicohet konflikt administrativ ndaj vendimit të Këshillit në gjykatën kompetente ekzekutimi i vendimit për rastin bëhet vetëm kur ka vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente, nuk është në pajtueshmëri me frymën e nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, pasi që palëve të interesit në procedurë të konfliktit administrativ mund të jenë nëpunësit civil apo kandidatët për pranim në Shërbimin Civil, do t'iu pamundësohet shfrytëzimi i mjeteve juridike sipas kuadrit ligjor të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore, ngase dispozitat e këtyre dy ligjeve nuk kanë trajtuar dhe as rregulluar çështjen e pezullimit sipas parimit ex lege të aktit administrativ përfundimtar, sikurse janë edhe vendimet e Këshillit, përmes të cilave nëpunësve civil apo kandidatëve për pranim në shërbimin civil mund t'iu njihet apo konfirmohet ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e punës sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin civil dhe për rrjedhojë në frymën e nenit 49.1 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Kosovës*.
238. Kryeministri, në anën tjetër në komentet e tij, argumenton se KPMSHCK nuk është agjenci e pavarur e Kuvendit të Republikës së Kosovës në kuadër të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Kryeministri thekson se pasi që burimi i kompetencave të KPMSHCK-së është Kuvendi, duke u thirrur në Komentarin e Kushtetutës, kompetencat e Qeverisë nuk mund të kufizohen nga pushteti gjyqësor dhe ai legjislativ. Rrjedhimisht, sipas tij, në asnjë rrethanë nga KPMSHCK.
239. Në kontekst të efektit përfundimtar të vendimit të KPMSHCK-së, Kryeministri konsideron se zgjidhja që ofron Ligji i kontestuar edhe në aspektin e trajtimit të vendimit si përfundimtar, është zgjidhje përfundimtare. Kjo sepse sipas tij, përderisa ligji në fuqi e parasheh se vendimi i KPMSHCK-së është përfundimtar, kjo edhe zbatohet në praktikë. Prandaj, i njëjti konstaton se përderisa një gjë e tillë parashihet me ligj, rregullimi i këtillë nuk ka si të bëhet normë.

240. Kryeministri në komentet e tij, gjithashtu thekson se: “E drejta e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore është e rëndësishë edhe më të madhe në kontekst të procedurave (Sharxhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë, 2018, § 92). Përmes ushtrimit të ankesës në gjykatën më të lartë administrative të shtetit, ankuesi kërkon zhvendosjen e efektit të vendimit paraprak që përkthehet në mbrojtjen efektive të të drejtave të ankuesit (Hornsby v. Greece, 1997, § 41; Kyrtatos v. Greece, 2003, §§ 31-32; and with regard to judgments of a constitutional court, see, mutatis mutandis, Xero Flor w Polsce sp. z o.o. v. Poland, 2021, §§ 282-283) ”.
241. Sa i përket parimit të sigurisë juridike, Kryeministri potencon se “Në përgjithësi, siguria juridike presupozon respektimin e parimeve të res judicata dhe finalitetit apo efektit përfundimtar të aktgjykimit (Guðmundur Andri Ástráðsson v Iceland [GC], 2020, § 238 and below). Së fundmi, e drejta e gjykimit të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ kërkon që lënda “të dëgjohet nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm”. Pavarësia e gjyqësorit është kusht sine qua non për një gjykim të drejtë sipas nenit 6 KEDNJ, (Grezeda v. Poland [GC], 2022, §301) kurse pavarësia e gjyqësorit është parakusht i sundimit të ligjit. Gjykatësit nuk mund të ruajnë sundimin e ligjit dhe t’i japin efekt të drejtave të Konventës përderisa ligjet nacionale i privojnë nga garancat e KEDNJ. Rrjedhimisht, përderisa Ligji për KPMSHCK obligon zbatimin e vendimeve të KPMSHCK-së edhe atëherë kur inicohet konflikti administrativ, i njëjti privon palët nga të dëgjuarit e lëndës së tyre nga një gjyqësor i pavarur dhe i paanshëm, i specializuar në çështjet administrative (referencë ndaj Gjykatës për Çështjet Administrative), sipas definimit të nenit 6 KEDNJ. Andaj, parashtruesi i kërkesës përmes argumenteve të paraqitura privon gjykatën nga të zbatuarit e nenit 6 të KEDNJ-së dhe avokuar për mungesën e gjykimit të drejtë e të paanshëm sipas KEDNJ-së”.

b. Parimet e përgjithshme lidhur me zbatimin e vendimeve të KPMSHCK-së

242. Në lidhje me statusin juridik të KPMSHCK-së, Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore të konsoliduar tashmë në një numër të konsiderueshëm rastesh, ku kishte konstatuar se KPMSHCK-ja është institucion i pavarur i themeluar me ligj, në pajtim me Kushtetutën, përkatësisht me paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës. Gjykata më tej në praktikën e saj gjyqësore kishte konstatuar se të gjitha obligimet që dalin nga ky institucion lidhur me çështjet që janë nën juridiksionin e këtij institucioni prodhojnë efekte juridike për institucionet e tjera përkatëse, ku statusi i të punësuarve është i rregulluar me Ligjin bazik për KPMSHCK-në.
243. Gjykata në praktikën e saj gjithashtu kishte theksuar se vendimi i këtij institucioni paraqet vendim administrativ të formës së prerë dhe si i tillë duhet të përmbahet nga gjykata kompetente, sipas propozimit për përmbahim nga kreditori në kuptim të realizimit të së drejtës së fituar në procedurë administrative (shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI33/16, cituar më lart, paragrafi 56; KI50/12, cituar më lart, paragrafi 36; dhe KI129/11, cituar më lart, paragrafi 42).
244. Në kontekst të asaj që u tha më lart, duke rikujtuar edhe përmbajtjen e arsytimit në rastin KI33/16, Gjykata rikujton se përmes këtij të fundit kishte deklaruar se KPMSHCK-ja gëzon prerogativat e një gjykate në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së dhe se “gjykata” kategorizohet në kuptimin substancial të termit nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë vendosja e çështjeve brenda kompetencave të saj në bazë të rregullave të së drejtës dhe pas procedurave të kryera në mënyrë të paraparë [...]”, duke përcaktuar se vendimet e KPMSHCK-së janë “përfundimtare, të detyrueshme dhe të ekzekutueshme” dhe se KPMSHCK-ja nga pikëpamja e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së është i pavarur ngase (i) është i pavarur prej ekzekutivit dhe (ii) ka juridiksion të plotë për të vendosur për çështjet që vendosen para

tyre ashtu siç kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, rastin KI33/16, *Minire Zeka*, cituar më lart, paragrafi 59. Në lidhje me pavarësinë e një “tribunali të pavarur” shih rastin KO12/17, parashtrues *Avokati i Popullit*, Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese, i 9 majit 2017, paragrafi 75).

c. Vlerësimi i Gjykatës

245. Në aplikimin e këtyre parimeve, me qëllim të adresimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës Gjykata i referohet edhe një herë nenit 9 të Ligjit të kontestuar, i cili plotëson dhe ndryshon nenin 21 (Vendimi i Këshillit) të Ligjit bazik, që përcakton si në vijim:

Neni 9 (pa titull)

“Neni 21 i ligjit bazik riformulohet në tërësi si në vijim:

1. Vendimi i Këshillit është vendim administrativ dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës.

2. Zbatimi i vendimit duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditësh pas përfundimit të afatit për ankesë në gjykatën kompetente të përcaktuar me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ, përveç kur vendimi kontestohet në gjykatën kompetente.

3. Moszbatimi i vendimit të Këshillit në afatin e përcaktuar në rastet kur asnjëra palë nuk e ka kontestuar në gjykatën kompetente, apo pas vendimit përfundimtar të gjykatës kompetente, paraqet shkelje të dispozitave të këtij ligji.”

246. Gjykata po ashtu vë në dukje përmbajtjen e nenit 21 (Vendimi i Këshillit) të Ligjit bazik si në vijim:

Neni 21 (Vendimi i Këshillit)

“1. Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës.

2. Zbatimi i vendimit duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Këshillit.

3. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit, paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës.”

247. Nga përmbajtja e nenit 9 të Ligjit të kontestuar, Gjykata vëren se i njëjti ndryshon tërësisht përmbajtjen e nenit 21 të Ligjit bazik për KPMSHCK-në.

248. Për më tepër Gjykata rikujton edhe përmbajtjen e nenit 10 të Ligjit të kontestuar, i cili ndryshon paragrafin 2 të nenin 22 të Ligjit bazik për KPMSHCK-në, dhe i cili përcakton si në vijim:

Neni 10 (pa titull)

“Paragrafi 2. i nenit 22 i ligjit bazik riformulohet si në vijim:

2. Në rastet kur iniicohet konflikt administrativ ndaj vendimit të Këshillit në gjykatë kompetente, ekzekutimi i vendimit për rastin bëhet vetëm kur ka vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente.”

249. Gjykata rikujton përmbajtjen e paragrafit 2 të nenit 22 i cili specifikon:

**Neni 22
(Inicimi i konfliktit administrative)**

“1. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ.

2. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.”

250. Në vazhdim Gjykata rikujton edhe përmbajtjen e nenit 11 të Ligjit të kontestuar, i cili ndryshon paragrafin 1 të nenit 23 të Ligjit bazik për KPMSHCK-në, dhe i cili përcakton se

**Neni 11
(pa titull)**

“Paragrafi 1 i neni 23 të ligjit bazik riformulohet si në vijim, kurse paragrafët 5. dhe 6. fshihen:

1. Nëse personi përgjegjës i institucionit nuk e zbaton vendimin e Këshillit brenda afati të paraparë me nenin 21 të këtij Ligji, në rastet kur asnjëra palë nuk e ka kontestuar vendimin e Këshillit në gjykatën kompetente, Kryetari i Këshillit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur ka kaluar afati për zbatim, në të gjitha rastet duhet të njoftojë me shkrim Kryetarin e Kuvendit, Komisionin përkatës për administratë publike dhe eprorin e drejtpërdrejtë të personit përgjegjës për zbatim.”

251. Paragrafi 1 i nenit 23 të Ligjit bazik të KPMSHCK-së i ndryshuar sipas nenit 11 të Ligjit të kontestuar, në përmbajtjen e tij thekson:

**Neni 23
(Procedura në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit)**

“1. Nëse personi përgjegjës i institucionit nuk e zbaton vendimin e Këshillit brenda afatit të paraparë me nenin 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur ka kaluar afati për zbatim, në të gjitha rastet duhet të njoftojë me shkrim Kryetarin e Kuvendit, Komisionin përkatës për administratë publike dhe eprorin e drejtpërdrejtë.

252. Nga përmbajtja e neneve të reflektuara në lart, të Ligjit të kontestuar respektivisht neneve 9, 10 dhe 11 të tij, vendimet e KPMSHCK-së nuk paraqesin më vendime të formës së prerë, dhe se zbatimi i tyre i menjëhershëm ndodhë vetëm kur i njëjti nuk atakohet në gjykatën kompetente.

253. Tutje, sipas asaj që parasheh neni 9, 10 dhe 11 të Ligjit të kontestuar, në rastet kur Vendimi i KPMSHCK-së goditet në gjykatën kompetente, i njëjti pezullohet deri në një vendim përfundimtar nga gjykata kompetente.

254. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se përmes Ligjit të kontestuar, respektivisht ndryshimeve që Ligji i kontestuar parasheh, duke iu hequr *“efektin e ekzekutueshmërisë”* vendimeve të KPMSHCK-së, e cila sipas tyre, nuk është në përputhshmëri me nenin 101 [Shërbimi Civil] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] për shkak se cenon pavarësinë e vet institucionit të KPMSHCK-së.
255. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës theksojnë se përmes këtyre ndryshimeve ligjore, përmes të cilave ata pretendojnë se *“është përzierje e dallimeve bazë në mes të procedurës administrative dhe asaj gjyqësore”* duke pretenduar se në këtë mënyrë shkelet neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës sepse sipas tyre vet Kushtetuta i ka ndarë mjetet juridike për palët në procedurë administrative dhe në atë gjyqësore.
256. Tutje, parashtruesit shtojnë se KPMSHCK si organ përfundimtar në procedurë administrative, ndër të tjera, ka për synim ngritjen e efikasitetit në trajtimin e kontesteve të punës, dhe se pezullimi i vendimit të KPMSHCK-së në rastet kur njëra palë i drejtohet gjykatës kompetente, praktikisht paraqet *“përjashtimin”* e KPMSHCK-së nga roli i saj kushtetues, dhe në këtë mënyrë nëpunësve civilë u shkelen të drejtat e tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] duke shkaktuar vonesa në zgjidhjen e rasteve.
257. Së pari, përgjatë adresimit të pretendimit të parashtruesve të kërkesës përkitazi me cenimin e nenit 101 të Kushtetutës, Gjykata rithekson se kompetenca e mbikëqyrjes së respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil është kompetencë e KPMSHCK-së, e përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës dhe se praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese është tejet e konsoliduar në kontekst të pavarësisë së këtij institucioni dhe funksioneve të tij, duke përfshirë por mos u kufizuar përmes Aktgjykimeve në rastet e lartcekura të Gjykatës: KO171/18 dhe KO127/21.
258. Gjykata rikujton se bazuar në nenin 101 të Kushtetutës dhe Ligji bazik për KPMSHCK-në, KPMSHCK është përcaktuar si institucion i pavarur kushtetues që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil. Bazuar në Ligjin bazik për KPMSHCK-në, ky i fundit siguron: (i) mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil; (ii) shqyrtimin dhe marrjen e vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil; (iii) mbikëqyrjen dhe procedurën e përzgjedhjes dhe vendosjen nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil; dhe (iv) monitorimin e institucioneve të administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civilë, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Për më tepër, bazuar në nenin 7 (Kompetencat e Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK, Këshilli, ndër të tjera, ka të drejtë, (i) të vizitojë çdo institucion që ka të punësuar nëpunës civilë; (ii) të ketë qasje dhe të kontrollojë dosjet dhe çdo dokument lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil; (iii) të intervistojë çdo nëpunës civil, i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit; (iv) të kërkojë dhe marrë nga institucionet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij; dhe (v) të nxjerrë vendime, udhëzime, qëndrime dhe rekomandime.
259. Në këtë kontekst, Gjykata nënvizon se parimet e lartcekura, që burojnë nga praktika e Gjykatës, që përcaktojnë natyrën *“kuazi gjyqësore”* të vet KPMSHCK-së, përkatësisht të tribunalit përkitazi me zgjidhjen e kontesteve që burojnë nga shërbimi civil, dhe si institucion që ka juridiksion të plotë që të nxjerr vendime të detyrueshme, në lidhje me konfliktet në mes të nëpunësve civilë ose kandidatëve për nëpunës civilë.

260. Siç është elaboruar më lart edhe tek parimet e përgjithshme, lidhur me zbatueshmërinë e vendimeve të KPMSHCK-së, Gjykata në praktikën e saj kishte theksuar se një vendim i KPMSHCK-së prodhon efekte juridike për palët dhe për këtë arsye, një vendim i tillë është përfundimtar administrativ dhe i përmbarueshëm (shih, rastet e Gjykatës, KI04/12, parashtrues *Esat Kelmendi*, Aktgjykimi i 20 korrikut 2012 dhe KI74/12, parashtruese *Besa Qirezi*, Aktgjykim i 4 prillit 2015 dhe referencat e cituara aty).
261. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore, përveç kompetencës lëndore të KPMSHCK-së për të zgjidhur mosmarrëveshjet e punës për nëpunësit civilë paraqet detyrim ligjor për institucionet e përkatëse për të adresuar dhe zbatuar vendimet e KPMSHCK-së.
262. Gjykata më tej thekson se, mbi bazën e pikës 1.4 të paragrafit 1 të nenit 26 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, Gjykata Supreme “*përcakton qëndrimet parimore, nxjerr mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës*”. Gjykata Supreme, duke u bazuar në praktikën e Gjykatës që kishin trajtuar çështjen e vendimeve të KPMSHCK-së, në mbledhjen e saj të mbajtur me 23 janar 2012, kishte konstatuar se vendimet e KPMSHCK-së, paraqesin titull përmbarimor.
263. Më tej, Gjykata thekson se norma kushtetuese, respektivisht paragrafi 2 i nenit 101 të Kushtetutës, nuk i parasheh shprehimisht efektet juridike të vendimit të KPMSHCK-së, ndonëse e parasheh këtë institucion si organ të pavarur që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil në Kosovë, si dhe bazuar në praktikën e vetë Gjykatës rezulton se ky organ ka natyrë “*kuazi gjyqësore*” dhe se në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës përbën “*tribunal*”.
264. Në këtë aspekt, Gjykata rithekson praktikën e saj gjyqësore dhe të GJEDNJ-së, ku konsideron se përmbarimi i një vendimi të marrë nga një gjykatë duhet shikuar si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë, e garantuar me dispozitat e lartpërmendura kushtetuese (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Hornsby kundër Greqisë](#), nr. 18357/91, Aktgjykimi i 19 marsit 1997, paragrafi 40, si dhe rastin e Gjykatës, KI33/16, cituar më lart, paragrafi 66).
265. Bazuar në këtë parim, Gjykata vë në dukje se efekti juridik i vendimeve të KPMSHCK-së në kuadër të procedurës administrative hyn në kuadër të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.
266. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet edhe parimeve të procedurës së përgjithshme administrative, siç janë parimi i efikasitetit dhe ai i efektit juridik “*përfundimtar*” apo “*ekzekutueshmërisë*” të tij pas përfundimit të kësaj procedure, të përcaktuara ndër të tjera në paragrafin 2 të nenit 10 (Parimi i jo formalitetit dhe efikasitetit të procedurës administrative) të LPPA-së, i cili parasheh se “*2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën [...]*”, si dhe paragrafin 2 të nenit 144 (Ekzekutueshmëria e aktit administrative) të LPPA-së, i cili parasheh se: “*2. Akti i zgjidhjes së ankesës që ndryshon një akt administrativ të ankimmuar, bëhet i ekzekutueshëm me njoftimin e palës*”.
267. Gjykata rithekson se ndryshimet të cilat parashihen me nenin 10 të Ligjit të kontestuar, i cili ndryshon dhe plotëson paragrafin 2 të nenit 22 (Inicimi i konfliktit administrativ) të Ligjit bazik, duke përcaktuar se vendimet e KPMSHCK-së nuk paraqesin më vendime të ekzekutueshme, dhe se zbatimi i tyre i menjëhershëm ndodhë vetëm kur i njëjti nuk atakohet në gjykatën kompetente. Gjykata merr parasysh se hapja e konfliktit administrativ përmes padisë shfrytëzohet nga shumica e palëve pas marrjes së një vendimi në procedurë administrative. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se procedura e

konfliktit administrativ sipas Ligjit për konfliktet administrative, përfundon me vendim të formës së prerë, i cili bëhet i ekzekutueshëm pas shterjes së mjeteve juridike të cekura në këtë Aktgjykimi, në rast të përdorimit të tyre. Nga kjo rezulton se nëpunësit civilë të cilëve iu zgjidhet ankesa ndaj aktit administrativ në lidhje me marrëdhënien e tyre të punës nga ana e KPMSHCK-së, mbeten pa mundësinë e ekzekutimit të këtij vendimi, një periudhë kohore deri sa të mbarojë procedura e konfliktit administrativ me vendim të formës së prerë, pavarësisht parimeve të lartcekura të së drejtës së procedurës administrative, përkatësisht parimit të shpejtësisë dhe ekzekutueshmërisë së aktit administrativ në këtë lloj procedure. Në frymën e asaj që u tha më lart, Gjykata konsideron se kjo cenon në thelb esencën e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

268. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se nenet 9, 10 1 dhe 11 (pa tituj) të Ligjit Nr. 08/L-180 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili ndryshon dhe plotëson nenin 21 (Vendimi i Këshillit), paragrafin 2 të nenit 22 (inicimi i konfliktit administrativ), si dhe paragrafi 1 të nenit 23 (Procedura në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit) të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Efektet e Aktgjykimit

269. Në fund, Gjykata rikujton se kërkesa e parashtruesve të kërkesës është parashtruar në Gjykatë bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës. Kjo kategori e kërkesave ka efekt suspenziv sepse bazuar në nenin 43 (Afati) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ligji i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje vetëm pas vendimmarrjes së Gjykatës dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës për rastin e kontestuar.
270. Gjykata në vijim vë në dukje se në praktikën gjyqësore të Gjykatës përkitazi me kategorinë e kërkesave të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, në rast të konstatimit që dispozita të caktuara të ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën, Gjykata (i) ka shpallur të pavlefshme vetëm dispozitat e vlerësuara në kundërshtim me Kushtetutën, ndërsa pjesën tjetër të ligjit e ka dërguar te Presidenti për shpallje në pajtim me modalitetet e Aktgjykimit të Gjykatës, siç është rasti me Aktgjykimet e Gjykatës në rastin KO01/17; rastin KO108/13, me parashtrues: *Albulena Haxhiu dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës* lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-209 për Amnisti apo edhe rastin KO 216/22, me parashtrues *Isak Shabani dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë* dhe KO 220/22; [KO79/23](#); ose (ii) në rast të vlerësimit që dispozitat e shpallura në kundërshtim me Kushtetutën janë të rëndësishme thelbësore për ligjin në fjalë dhe për pasojë, shpallja apo hyrja në fuqi e tij, do ta bënte të njëjtin të pazbatueshëm, ka shfuqizuar ligjin përkatës në tërësinë e tij, siç është rasti me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO43/19 me parashtrues *Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë (30) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 13 qershorit 2019 lidhur me Ligjin për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë; në rastet KO100/22 dhe KO101/22,; dhe KO173/22, parashtrues *Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, (cituar më lart) lidhur me Ligjin Nr. 08/L-179 për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg.
271. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata ka konstatuar se: (i) nenet 2, 7, 8 (pa tituj) të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit], dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] në lidhje me paragrafin 2 të nenit 101

[Shërbimi Civil] të Kushtetutës; (ii) neni 6 (pa titull) i Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës; si dhe (iii) nenet 9, 10 dhe 11 (pa tituj) të Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës. Për pasojë, Gjykata ka shpallur të pavlefshme dhe ka shfuqizuar nenet 2, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 (pa tituj) të Ligjit Nr. 08/L-180 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

272. Në anën tjetër, Gjykata rikujton se përmbajtja e neneve të tjera të Ligjit të kontestuar, respektivisht, neneve 3, 4 dhe 5, ka të bëjë me ndryshimin e dispozitave përkatëse të Ligjit bazik në lidhje (i) me numrin dhe përbërjen e anëtarëve të KPMSHCK-së, (ii) kriteret për emërimin e anëtarëve të tij; si dhe (iii) ndryshimin e procedurës për emërimin e anëtarëve të këtij institucioni. Pasi që nenet e lartcekura të Ligjit të kontestuar (i) nuk janë vlerësuar nga Gjykata si kundërkushtetuese; (ii) të njëjtat nuk kanë ndërlidhje dhe nuk kanë ndërvarësi me nenet e shfuqizuara të tij si më lart, dhe rrjedhimisht mund të zbatohen në mënyrë të pavarur dhe të pa afektuar nga dispozitat e shpallura si në kundërshtim me Kushtetutën, si dhe duke pasur parasysh (iii) natyrën e Ligjit të kontestuar si ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik për KPMSHCK-së, Gjykata konsideron se nenet 1, 3, 4, 5 (pa tituj) dhe 12 (Hyrja në fuqi) të tij, mund të zbatohen të pavarura nga nenet 2, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, dhe rrjedhimisht ka vendosur që Ligji i kontestuar i dërgohet për shpallje Presidentit të Republikës së Kosovës, pa nenet 2, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të po këtij ligji.

Kërkesa për masë të përkohshme

273. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kanë kërkuar nga Gjykata që të caktojë masë të përkohshme, me qëllim të parandalimit të zbatimit të Ligjit të kontestuar, deri në sjelljen e vendimit përfundimtar lidhur me kërkesat në fjalë.
274. Gjykata, në këtë kontekst, thekson se paragrafi 2 i nenit 43 [Afati] i Ligjit e përcakton efektin pezullues të hyrjes në fuqi të ligjeve të cilat kontestohen në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton se *“Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendim i tillë mund t’i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”*.
275. Bazuar në dispozitën e sipërpërmendur, më 31 tetor 2023, Gjykata ka kërkuar nga Presidentja, Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Kuvendit të marrin parasysh kushtet e përcaktuara me paragrafin 2 të nenit 43 të Ligjit.
276. Prandaj, duke marrë parasysh se në bazë të paragrafit 2 të nenit 43 të Ligjit, Ligji i kontestuar, bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, nuk mund të dekretohet, të hyjë në fuqi, apo të prodhojë efekte juridike para se Gjykata ta sjellë vendimin, si dhe në përputhje me nenin 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit dhe rregullin 47 (Efekti suspensiv i kërkesave) të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme është pa objekt të shqyrtimit dhe, si e tillë refuzohet (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e Gjykatës në rastet KO100/22 dhe KO101/22, me parashtrues *Abelard Tahiri dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë dhe KO101/22, me parashtrues Arben Gashi dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, (cituar më lart), paragrafi 411, Aktgjykimin në rastet KO216/22 dhe KO222/22, me parashtrues *Isak Shabani dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë dhe KO220/22, me parashtrues Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, (cituar më lart) paragrafi 405) dhe Aktgjykimin në rastin KO173/22, me parashtrues *Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, (cituar më lart), paragrafi 228).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 113 (5) dhe 116 (2) të Kushtetutës, nenet 20, 27 dhe 42 të Ligjit dhe në bazë të rregullave 45, 48 (1) (a) dhe 72 të Rregullores së punës, më 21 qershor 2024:

VENDOS

- I. TA SHPALLË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, njëzëri, se nenet 2, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 08/L-180 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] në ndërlidhje me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të njëjtat shpallen të pavlefshme;
- III. TË KONSTATOJË, me shtatë (7) vota për dhe dy (2) kundër, se neni 6 i Ligjit Nr. 08/L-180 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe i njëjti shpallet i pavlefshëm;
- IV. TË KONSTATOJË, njëzëri, se nenet 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 08/L-180 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të njëjtit shpallën të pavlefshëm;
- V. TË SHPALLË, njëzëri, që në bazë të nenit 43 (Afati) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-180 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i dërgohet për shpallje Presidentit të Republikës së Kosovës, pa nenet 2, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11;
- VI. TA REFUZOJË, njëzëri, kërkesën për masën e përkohshme;
- VII. TUA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VIII. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani